

PUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
Nr. 6657 Regj.

6657
Tiranë, 05/10/1994

V E N D I M

MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISË
"PËRPARIMI" sh.a.

Sot, datë 5/10/1994, unë Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë,
Marjane Desh, mora në shqyrtim kërkesën e kerkuesit Mihal
Delijorgji, Administrator i shoqerisë "Përparimi" sh.a. i cili kërkon
regjistrimin e asaj shoqerie ne Regjistrin Tregëtar Tiranë. Nga material

K O N S T A T O V A:

Se më datë 28/12/1994 ne Gjirokaster është themeluar shoqeria tre-
getare "Përparimi" sh.a me ortakë themelues Mihal Delijorgji, Spiridhon
Simandiris dhe Konstandinos Vllahojanis. Kryetar i Keshillit Drejtues
është Mihal Delijorgji. Objekti i aktivitetit të shoqerisë është tregëti
e përgjithshme, importe dhe eksporte, transporte nderkombetare.
Kohezgjatja e shoqerisë është 50 vjet, dhe selia e saj është ne fshatin
Dhuvjan të Gjirokaster.

Shoqeria me Nr.1216 akti dhe Nr.1216 vendimi është regjistruar
edhe në Gjykatën e Rrethit Gjirokaster.

Në këto kushte kërkesa e paraqitur nga kerkuesi Mihal Delijorgji
është e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PËR KETO ARESYE:

Bazuar ne Ligjin Nr. 7632 datë 4.11.1992 dhe të Ligjit Nr.7638, 19.11.
1992 dhe Ligjit Nr.7667 datë 28/1/1993

V E N D O S A:

Të regjistroj pranë regjistrin tregëtar Tiranë, shoqerinë "Përparimi"
sh.a. me ortakë themelues Mihal Delijorgji, Spiridhon Simandiris dhe
Konstandinos Vllahojanis. Për Drejtimin e shoqerisë si Kryetar i Keshi-
llit Drejtues është Mihal Delijorgji. Kohezgjatja e shoqerisë është 50
vjet nga dita e aprovimit të statutit. Objekti i aktivitetit është: Tre-
geti e përgjithshme, importe dhe eksporte , transporte nderkombetare.
Selia e shoqerisë është ne Dhuvjan të Gjirokastres. Kapitali i shoqerisë
është 24.000.000 dhrami ose 9.000.000 lekë.

Kunder ketij Vendimi mund të bëhet ankim në shkallë të dytë.

G J Y Q T A R E

(Marjane Desh)
Deshe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
Nr. 6657 i Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 03.02. 2004, unë Dr. M. C. C., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit, Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "PËRPARIMI" Sh.a., mbi depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, datë 16.01.2004.

KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare "PËRPARIMI" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin 6657, datë 05.10.1994 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Kërkuari, Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "PËRPARIMI" Sh.a kërkon depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, datë 16.01.2004, me anën e të cilit është vendosur zgjerimi i objektit të shoqërisë në këtë mënyrë:

- *Grumbullimi, mbledhja, shit-blerja, përpunimi dhe import-eksporti i skrapit.*

Kjo do të ndihmojë në zhvillimin dhe rritjen e treguesve ekonomikë të shoqërisë. Ky vendim është marrë në përputhje me aktet e themelimit të shoqërisë dhe të legjislacionit tregtar në fuqi.

Si rrjedhojë e këtij ndryshim në objekt, është paraqitur dhe ndryshimi përkatës i dispozitës së statutit si më poshtë vijon:

Neni 4 i Statutit me këtë përmbajtje

Neni 4

Qëllimi i shoqërisë është:

1) Tregtimi i mallrave dhe produkteve nga Shqipëria jashtë shtetit dhe e kundërta. 2) Tregtimi i çdo produkti, materialeve ndërtimi, produkteve industriale, ilaçeve dhe çdo lloj produkti që lejohet nga ana e ligjeve shqiptare. 3) Kodifikimi i çdo lënde të parë të përpunuar apo jo e përpunuar për prodhimin e produkteve si p.sh. në mënyrën treguese prodhimi i produkteve prej druri dhe alumini nëpërmjet lëndëve të para të importuara apo jo, prodhimi i gëlqeres, të skeletëve metalik të gatshëm, të blloqeve të betonit dhe të çdo lloji materiali ndërtimi. 4) Ndërtimi, riparimi apo rikonstruksioni dhe tregtimi i tuneleve, ndërtesave, apatramenteve, zyrave, dyqaneve, monumenteve si dhe ndërtesave të veçanta për përdorim shtetëror, kishtar apo turistik. 5) Kryerja e tregtisë së përgjithshme jashtë

shtetit për llogari të shoqërisë dhe për llogari të të tretëve dhe përfaqësimi në Shqipëri i zyrave të vendeve të tjera, si dhe blerja dhe shitja e aksioneve të Shoqërive që funksionojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.

Për arritjen e qëllimeve të mësipërme shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo shoqëri të ligjshme të çfarëdo lloj forme në Shqipëri dhe jashtë shtetit, që ka qëllime ndërvarese, si dhe të marrë pjesë në shoqëri të tjera të çfarëdolloj forme ligjore, qofshin në vend dhe të tillë që kanë qëllime të njëjta.

4.1 Investime në prodhimin e llamarinës së valëzuar, prodhim të rrjeteve të telit, prodhim të gozhdëve, prodhim të profileve të hekurit, si dhe përpunim të hekurit nëpërmjet drejtimit, prerjes dhe kryerjes së proceseve të tjera.

Ndryshon në këtë mënyrë:

Neni 4

Qëllimi i shoqërisë është:

- Tregtimi i mallrave dhe produkteve nga Shqipëria jashtë shtetit dhe e kundërta;
- Tregtimi i çdo produkti, materialeve ndërtimi, produkteve industriale, ilaçeve dhe çdo lloj produkti që lejohet nga ana e ligjeve shqiptare;
- Kodifikimi i çdo lënde të parë të përpunuar apo jo e përpunuar për prodhimin e produkteve si p.sh. në mënyrën treguese prodhimi i produkteve prej druri dhe alumini nëpërmjet lëndëve të para të importuara apo jo, prodhimi i gëlqeres, të skeletëve metalik të gatshëm, të blloqeve të betonit dhe të çdo lloji materiali ndërtimi;
- Ndërtimi, riparimi apo rikonstruksioni dhe tregtimi i tuneleve, ndërtesave, apatramenteve, zyrave, dyqaneve, monumenteve si dhe ndërtesave të veçanta për përdorim shtetëror, kishtar apo turistik;
- Kryerja e tregtisë së përgjithshme jashtë shtetit për llogari të shoqërisë dhe për llogari të të tretëve dhe përfaqësimi në Shqipëri i zyrave të vendeve të tjera, si dhe blerja dhe shitja e aksioneve të Shoqërive që funksionojnë në Shqipëri dhe jashtë saj;
- Investime në prodhimin e llamarinës së valëzuar, prodhim të rrjeteve të telit, prodhim të gozhdëve, prodhim të profileve të hekurit, si dhe përpunim të hekurit nëpërmjet drejtimit, prerjes dhe kryerjes së proceseve të tjera.
- *Grumbullimi, mbledhja, shit-blerja, përpunimi dhe import-eksporti i skrapit.*

Për arritjen e qëllimeve të mësipërme shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo shoqëri të ligjshme të çfarëdo lloj forme në Shqipëri dhe jashtë shtetit, që ka qëllime ndërvarese, si dhe të marrë pjesë në shoqëri të tjera të çfarëdolloj forme ligjore, qofshin në vend dhe të tillë që kanë qëllime të njëjta.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur, për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të shoqërisë “PËRPARIMI” sh.a., datë 16.01.2004, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE


Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 “Për Rregjistrin Tregtar”,

V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, datë 16.01.2004.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrin Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kollonën përkatëse

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE

Dr. Fa Copo


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 6657/1.

6612

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Tirane, me 25.5 1999

Une Abdurrahman Kucoku, gjyqtare ne Gjykatën e Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Mihal Delijorgji, drejtor i Shoqerise Tregtare "PERPARMI" Sha, te regjistruar ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin Nr.6657, date 5.10.1994 dhe :

KONSTATOVA

Me vendimin e dates 18.5.1999, asambleja e jashtezakonshme e aksionereve te shoqerise tregtare "PERPARIMI" Sha, ka vendosur plotesimin e statutit te shoqerise, duke shtuar pas nenit (4), i cili ben fjale per veprimtarine e shoqerise, nenin (4.1) me kete permbajtje:

Investime ne prodhimin e llamarines se valezuar, prodhim te rrjetave te telit, prodhim te gozhdeve, prodhim te profileve te hekurit. si dhe perpunim te hekurit nepermjet drejtimit, prerjes dhe kryerjes se procesveve te tjera

Ne baze te nenit 33 te ligjit Nr 7667, date 28.1.1993, kerkesa çmohet e drejte, e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar. Per kete aresye:

VENDOSA

Pranimin e kerkeses se paraqitur nga Z. Mihal Delijorgji.


Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit date 18.5.1999 te asamblese se jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise tregtare "PERPARMI" sha, qe vendosi vendosur plotesimin e statutit te shoqerise, duke shtuar pas nenit (4), i cili ben fjale per veprimtarine e shoqerise, nenin (4.1) me kete permbajtje:

Investime ne prodhimin e llamarines se valezuar, prodhim te rrjetave te telit, prodhim te gozhdeve, prodhim te profileve te hekurit. si dhe perpunim te hekurit nepermjet drejtimit, prerjes dhe kryerjes se procesveve te tjera

Urdherimin e zyres se regjistrit tregtar te beje ndryshimet ne kolonen 4.5, germa C.

Ndarjen me vize te kuqe te ndryshimeve perkatese.

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR.338-12 66 54/2

2507

V E N D I M

I

Gjyqtarit te vetem

Ne Tirane sot me date 25-12-1999, une gjyqtarja N. Daga ne Gjykatën e rrethit Tirane, mbasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga ana e kerkuesit Mihal Delijorgji, ne cilesine e Kryetarit te Keshillit Drejtues te Shoqerise "Perparimi" sha", se bashku me materialet perkatese, i cili kerkon depozitimin si me poshte,

K O N S T A T O V A

Ne zbatim te vendimit te Asamblese se ortakeve te Shoqerise "Perparimi" sha Nr.1, date 20.7.1999 eshte vendosur te:

1. Miratohet ndryshimi i selise se Shoqerise "Perparimi" sha nga fshati Dhuvjan Gjirokaster ne qytetin e Durres, Rr" "Ad. 2.3" "Rr. 2.3.45" autentifikuar fllorak

2. Te behen ndryshimet perkatese ne Aktin e themelimit dhe Statutin e Shoqerise, si dhe te paraqitet kerkesa ne Gjykatën e rrethit Tirane.

3. Ngarkohet zoti Mihal Delijorgji ne cilesine e Kryetarit te Keshillit Drejtues te Shoqerise, te beje veprimet perkatese prane Gjykates se shkalles se pare Tirane, duke paraqitur kerkesen.

Ne Aktet e paraqitura prej kerkuesit rezulton se dokumentacioni eshte i plote dhe i rregullt.

P E R K E T O A R E S Y E

Ne mbeshtetje te kerkesave te Ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe 7667 date 28.3.1993,

V E N D O S A

- Depozitimin ne zyren e rregjistrimit tegetar te Gjykates se rrethit Tirane te dokumentacionit te shoqerise "Perparimi" sha.

- Ne fletet perkatese te rregjistrimit te behen shenimet ne kolonat..... dhe....., me Nr. rendor....., te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

N. Daga

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 6657/3 rregj.

V E N D I M

I GJYQITARIT TE VETEM

Sot me daten 21. 01 2000, une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit, Tirane Shirila Cops mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Z. Mihal Delijorgji, perfaqesues i Shoqerise "Perparimi" Sh.a, per pasqyrimin ne rregjistrin tregtar te transferimit te aksioneve te zoteruara, ne Shoqeri, nga aksioneret Spiridhon Simandiris dhe Kostandinos Vllahojanis ne favor te Z. Kristo Delijorgji dhe depozitimin e vendimit perkates te aksionereve dhe kontrates se dhurimit te aksioneve dhe,

K O N S T A T O V A:

Se ne date 7.12.1999 eshte bere Mbledhja e Aksionereve te Shoqerise "Perparimi" Sh.a, me perfaqesim te plote te te gjithë aksionereve te saj dhe eshte aprovuar unanimitisht prej tyre transferimi i aksioneve te mbajtura ne shoqeri nga Aksioneret: (1) Spiridhon Simandiris, (2) Kostandinos Vllahojanis ne favor te Z. Kristo Delijorgji. Ne vijim te kesaj mbledhjeje eshte bere dhe Kontrata e Dhurimit me Nr.5673 Rep dhe Nr. 444 Kol, date 7.12.1999 me dhurues (1) Spiridhon Simandiris ,(2) Kostandinos Vllahojanis dhe pranues dhurimi Zt. Kristo Delijorgji. Ne baze te ketij akti noterial Kristo Delijorgji behet pronar i 130 aksioneve te mbajtura nga dhuruesit e siperpermendur ne shoqerine "Perparimi" Sh.a. Ne kete menyre zoterimi i aksioneve te kesaj shoqerie paraqitet:

1. Mihal Delijorgji zoterues i 110 aksioneve dhe
2. Kristo Delijorgji zoterues i 130 aksioneve

P E R K E T O A R S Y E

Si gjyqtare e vetme ne baze te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare " dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per Rregjistrin Tregtar "

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses se mesiperme.
- Depozitimn ne Rregjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Aksionereve te dates 7.12.1999 per miratimin e transferimit te aksioneve te aksionereve te Shoqerise "Perparimi" Sh.a, (1) Spiridhon Simandiris, (2) Kostandinos Vllahojanis ne favor te Z. Kristo Delijorgji dhe te Kontrates respektive te Dhurimit me Nr.5673 Rep dhe Nr. 444 Kol, date 7.12.1999, sipas te cilave aksionet e Shoqerise "Perparimi" Sh.a aktualisht zoterohen:
 - a) Mihal Delijorgji 110 aksione dhe
 - b) Kristo Delijorgji 130 aksione
- Urdherimin e Zyres se Rregjistrit Tregtar te beje pasqyrimin ne Rregjister te ketyre ndryshimeve.
- Ndarjen me vize te kuqe per ndryshimet e bera.

U shpall sot me daten 21.01.2000

GJYQTARE

Imila Capo


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 6657/4 rregj.

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 28.04. 2000, une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit, Tirane Imula Cafa, mora ne shqyrtim kerkesen e shoqerise "Perparimi" Sh.a, paraqitur nga Z. Mihal Delijorgji, per pasqyrimin ne rregjistrin tregtar te transferimit te aksioneve te aksionereve Mihal Delijorgji dhe Kristo Delijorgji ne favor te Shoqerise "Felmont Trading Limited" dhe depozitimin perkatesisht te vendimit te ortakeve dhe kontrates se shitjes, dhe

K O N S T A T O V A:

Me date 17.03. 2000 eshte mbajtur Mbledhja e Zakonshme e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Perparimi" Sh.a me kete rend dite:

1. Transferimi i 122 aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise ne favor te shoqerise "Felmont Trading Limited", nder te cilat 110 aksione te mbajtura nga Mihal Delijorgji dhe 12 aksione te mbajtura nga Kristo Delijorgji.
2. Cmimi i shitjes se aksioneve.
3. Te ndryshme.

Mihal Delijorgji ne cilesine e Drejtorit te shoqerise pasi konstatoi se ne kete mbledhje perfaqesohej tere kapitali themeltar i shoqerise e konsideroi mbledhjen te thirrur ne menyre te vlefshme e te rregullt dhe parashtroi:

1. Propozimin per transferimin e 122 aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise ne favor te shoqerise "Felmont Trading Limited". Keto 122 aksione do te transferohen nepermjet shitjes respektive te 110 aksioneve te mbajtura nga Mihal Delijorgji dhe 12 aksioneve te mbajtura nga Kristo Delijorgji.

Me realizimin e kesaj shitjeje:

- (i) Z. Mihal Delijorgji duke shitur te gjitha aksionet e mbajtura prej tij humbet cilesine e aksionerit te Shoqerise "Perparimi" Sh.a dhe mbetet vetem ne rolin e Drejtorit te saj;
- (ii) Shoqeria "Felmont Trading Limited" behet zoteruese e 51% te kapitalit themeltar te Shoqerise "Perparimi" Sh.a

Pas nje diskutimi te hollesishem te keasj pike te rendit te dites me votim te tere kapitalit themeltar u aprovua:

- Transferimi i 122 aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise ne favor te Shoqerise “Felmont Trading Limited” e cila behet zoteruese e 51% te kapitalit aksioner te “Perparimi”Sh.a.

2. Propozimin qe cmimi i shitjes se aksioneve te jete 100.000 Dhrhmi/aksion dhe cmimi total per 122 aksione 12.200.000 Dhrhmi.

Me votim te tere kapitalit themeltar u aprovua.

- Cmimi i shitjes se aksioneve te jete 100.000 Dhrhmi/aksion dhe cmimi total per 122 aksione 12.200.000 Dhrhmi.

3. Se me aprovimet e mesiperme struktura e zoterimit te e kapitalit themeltar te shoqerise “Perparimi” Sh.a rezulton : “Felmont Trading Limited” 51% dhe Kristo Delijorgji 49%.

Me votim te tere kapitalit aksioner u aprovua:

- Struktura e re aksionere e shoqerise “Perparimi” Sh.a si vijon:

(i) “Felmont Trading Limited” 51% ,dhe

(ii) Kristo Delijorgji 49%.

PER KETO ARSYE

Si gjyqtare e vetme ne baze te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 “ Per Shoqerite Tregtare “ dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 “ Per Rregjistrin Tregtar “

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses se mesiperme.

- Depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te:

1. *Vendimit te Asamblese se Aksionereve te dates 17.03.2000* ne baze te se cilit vendoset:

(i) Transferimi i 122 aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise (nga te cilat 110 aksione te aksionerit Mihal Delijorgji dhe 12 aksione te aksionerit Kristo Delijorgji) ne favor te Shoqerise “Felmont Trading Limited” e cila behet zoteruese e 51% te kapitalit themeltar te “Perparimi”Sh.a;

(ii) Dalja e aksionerit Mihal Delijorgji nga shoqeria si rezultat i shitjes nga ana e tij e te gjithë aksioneve te zoteruara prej tij dhe mbetja e tij vetem ne cilesine e Drejtorit te kesaj Shoqerie;

(iii) Struktura e re e zoterimit te kapitalit themeltar: Shoqeria “Felmont Trading Limited” 51% dhe Kristo Delijorgji 49%.

2. *Kontrates respektive te Shitjes me Nr. 1270 Rep dhe Nr. 139 Kol, date 17.03.2000, sipas te ciles 122 aksionet e kapitalit themeltar te Shoqerise "Perparimi" Sh.a i shiten Shoqerise "Felmont Trading Limited".*

- Urdherimin e Zyres se Rregjistrir Tregtar te beje pasqyrimin ne Rregjister te ketyre ndryshimeve.

- Ndarjen me vize te kuqe per ndryshimet e bera.

U shpall sot me daten 28.04.2000

GJYQTARE

Luvisla Cepo


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
TIRANË
Nr. 6657/10 Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot më datën 28.12.09 unë A. Cocq, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., mbi depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të kësaj shoqërie dt. 25.06.2004.

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "Përparimi" sh.a., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin 6657, dt.05.10.1994 dhe ushtron aktivitetet e saj në përputhje me aktet e themelimit.

Kërkuari, Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., kërkon:

- Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, dt. 25.06.2004, me anë të të cilit është vendosur, zmadhimi I kapitalit të shoqërisë me fitimet e realizuara dhe me rezervat deri në 31.12.2003, në përputhje me llogaritë e fitimeve dhe të rezervave të pasqyruara në bilancet kontabël, si dhe në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes së aksionerëve në kapitalin themeltar ku:

~Shoqëria "Felmont Trading Ltd", zotëron 51% të aksioneve;

~Z. Kristo Delijorgji, zotëron 49% të aksioneve.

-Miratimin e Znj. Leze Abazi si eksperte kontabël, me Liçencë me Nr.24, dt. 11.02.2000, për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për shtesën e kapitalit të shoqërisë për fitimet e realizuara dhe rezervat deri në 31.12.2003.

Në bazë të Ligjit Nr. 7638, dt.28.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit Nr. 7667, dt. 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", kërkesa çmohet e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar. Për këto arsye:

VENDOSA

1.Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Z. Mihal Delijorgji.

2. Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Vendimit dt. 25.06.2004, të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., që vendosi zmadhimin e kapitalit me fitimet e realizuara dhe rezervat deri në 31.12.2003, në përputhje me llogaritë e fitimeve dhe rezervave të pasqyruara në bilancin kontabël.

3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kolonën përkatëse.

GJYQTARE

Ariene Coc



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr. 6657/6 i Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot më datën 25.01.05, unë B. Luma, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., mbi depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të kësaj shoqërie dt. 14.01.2005.

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "Përparimi" sh.a., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin 6657, dt.05.10.1994 dhe ushtron aktivitetet e saj në përputhje me aktet e themelimit.

Kërkuarisi, Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., kërkon:

- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, dt. 14.01.2005, me anë të të cilit është vendosur, miratimi I raportit të ekspertit kontabel, ku përcaktohet zmadhimi I kapitalit të shoqërisë me fitimet e realizuara dhe me rezervat e krijuara deri në 31.12.2003, në përputhje me llogaritë e fitimeve dhe të rezervave të pasqyruara në bilancet kontabël, si dhe pa e ndryshuar përqindjen e pjesëmarrjes së aksionerëve në kapitalin themeltar ku:

~Shoqëria "Felmont Trading Ltd", zotëron 51% të aksioneve;

~Z. Kristo Delijorgji, zotëron 49% të aksioneve.

Në përputhje me raportin e ekspertit kontabel, zmadhimi I kapitalit do të bëhet në masën 156.862.500 lekë, pra nga 9.000.000 lekë, do të bëhet 165.862.500 lekë ose e shprehur në aksione numri I aksioneve do të rritet me 4.183 aksione, pra nga 240 aksione do të bëhen 4423 aksione.

Në bazë të Ligjit Nr. 7638, dt.28.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit Nr. 7667, dt. 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", kërkesa çmohet e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar. Për këto arsye:


VENDOSA

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Z. Mihal Delijorgji.

2. Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Vendimit dt. 14.01.2005, të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., që vendosi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me 156.862.500 lekë, pra kapitali themeltar I shoqërisë bëhet nga 9.000.000 lekë në 165.862.500 lekë.

3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kolonën përkatëse.

GJYQTAR

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Meirina Zefexhi", with a stylized flourish underneath.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
TIRANË**

Nr. 667/7 i Vendimit

**VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM**

Sot më datën 28.06.05, unë M. Muz, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., mbi depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të kësaj shoqërie dt. 24.06.2005.

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "Përparimi" sh.a., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin 6657, dt.05.10.1994 dhe ushtron aktivitetet e saj në përputhje me aktet e themelimit.

Kërkuari, Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., kërkon:

1. Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, dt. 24.06.2005, me anë të të cilit është vendosur, zmadhimi i kapitalit të shoqërisë me fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri në 31.12.2004, në përputhje me llogaritë e fitimeve dhe rezervave të pasqyruara në bilancet kontabël, duke ruajtur të pandryshuar përqindjen e pjesëmarrjes së aksionerëve në kapitalin themeltar ku:

- ~Shoqëria "Felmont Trading Ltd", zotëron 51% të aksioneve;
- ~Z. Kristo DELIJORGJI, zotëron 49% të aksioneve.

2. Miratimin e Znj. Leze Abazi si eksperte kontabël, me Liçencë me Nr.24, dt. 11.02.2000, për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për shtesën e kapitalit të shoqërisë për fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri në 31.12.2004.

Në bazë të Ligjit Nr. 7638, dt.28.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit Nr. 7667, dt. 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", kërkesa çmohet e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar. Për këto arsye:


VENDOSA

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Z. Mihal Delijorgji.

2. Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Vendimit dt. 24.06.2005, të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., që vendosi zmadhimin e kapitalit me fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri në 31.12.2004, në përputhje me llogaritë e fitimeve dhe të rezervave të pasqyruara në bilancin kontabël.

3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kolonën përkatëse.

GJYQTAR



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 6657/8 Vendimi

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot më datën 02-11-05, unë [Signature], gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., mbi depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të kësaj shoqërie dt. 25.07.2005.

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "Përparimi" sh.a., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin 6657, dt.05.10.1994 dhe ushtron aktivitetet e saj në përputhje me aktet e themelimit.

Kërkuari, Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., kërkon:

Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, dt. 25.07.2005, me anë të të cilit është vendosur, miratimi i raportit të ekspertit kontabel, ku përcaktohet zmadhimi i kapitalit të shoqërisë me fitimet e realizuara dhe me rezervat e krijuara deri në 31.12.2004, në përputhje me llogaritë e fitimeve dhe të rezervave të pasqyruara në bilancet kontabël, si dhe pa e ndryshuar përqindjen e pjesëmarrjes së aksionerëve në kapitalin themeltar ku:

~Shoqëria "Felmont Trading Ltd", zotëron 51% të aksioneve;

~Z. Kristo Delijorgji, zotëron 49% të aksioneve.


Në përputhje me raportin e ekspertit kontabel, zmadhimi i kapitalit do të bëhet në masën 24.958.932 lekë – 21.432 lekë (që nuk plotësojnë masën e një aksioni), konkretisht rritja e kapitalit do të bëhet me 24.937.500 lekë, pra nga 165.862.500 lekë, do të bëhet 190.800.000 lekë ose e shprehur në aksione numri i aksioneve do të rritet me 665 aksione, pra nga 4423 aksione do të bëhen 5088 aksione.

Në bazë të Ligjit Nr. 7638, dt.28.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit Nr. 7667, dt. 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", kërkesa çmohet e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar. Për këto arsye:

VENDOSA

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Z. Mihal Delijorgji.
2. Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Vendimit dt. 25.07.2005, të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë tregtare "Përparimi" sh.a., që vendosi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me 24.937.500 lekë, pra kapitali themeltar i shoqërisë bëhet nga 165.862.500 lekë në 190.800.000 lekë.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kolonën përkatëse.

GJYQTAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. _____ i Vendimit

6657/9

VENDIM
I
GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 26/5/2006, unë R. Prap, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit, Z. Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "PËRPARIMI" Sh.a., mbi depozitimin e vendimit të Asamblesë së Aksionerëve, datë 03.03.2006,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare "PËRPARIMI" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 6657, datë 05.10.1994 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Kërkuarit, Z. Mihal Delijorgji, me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë tregtare "PËRPARIMI" Sh.a., kërkon depozitimin e vendimit të Asamblesë së Aksionerëve, datë 03.03.2006, me anën e të cilit është vendosur miratimi i transferimit me anë të shitjes të 51% të aksioneve që aksioneri, Shoqëria Tregtare "FELMONT TRADE LIMITED" zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë "PËRPARIMI" Sh.a. Shitja e pjesës prej 51% të aksioneve do të bëhet në favor të Shoqërisë të së drejtës së Qipros "FELTEX HOLDINGS LIMITED".

Pas realizimit të shitjes, Shitësi Shoqëria Tregtare "FELMONT TRADE LIMITED" humbet pronësinë e tij mbi kapitalin themeltar të shoqërisë, ndërsa Shoqëria "FELTEX HOLDINGS LIMITED" bëhet pronare e 51% të kapitalit themeltar të Shoqërisë "PËRPARIMI" Sh.a., duke fituar njëkohësisht dhe cilësinë e aksionerit të saj.

Kështu, konform ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe statutit të shoqërisë është përpiluar para noteres Neriman Marika, kontrata e shit – blerjes së aksioneve, e datës 03.03.2006, me nr. 1032 Rep. dhe nr. 108 Kol.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve, datë 03.03.2006, të shoqërisë "PËRPARIMI" sh.a., është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

- 1- Pranimin e kërkesës.
- 2- Depozitimin e vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë “PËRPARIMI” Sh.a., datë 03.03.2006, për miratimin e shitjes së aksioneve të shoqërisë.
Depozitimin e kontratës së shit-blerjes së aksioneve të shoqërisë “PËRPARIMI” Sh.a., e datës 03.03.2006, me nr. 1032 Rep. dhe nr. 108 Kol., të përpiluar para noteres Neriman Marika.
- 3- Urdhërohet Zyra e Regjistrimit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kollonën përkatëse

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE
Deputet Bogdan
7/10/06

AKT - THEMBELAR

I

SHOQERISE ANONIME PERPARIMI (SH. A. A) , PER TREGTIMIN E

PERGJITHESHME SHQIPTARO - GREKE , IMPORT - EKSPORT dhe TRANSPORT

Ne Tirane sot, me daten 5.10.1994 (nentedhjete ekater), ne te neshkruarët :

1. MIHAL DELIJORGJ, i biri i Pandeliut , i datl . 1966, lindur ne Terjat , fshati Gjirokaster, banues ne Gjirokaster.

2. SPIRIDHON SIMANDIRIS, i biri i Efstatihu, i datl. 1927, lindur ne Pire, te Athines dhe banues ne Kalithea te Athine.

3. KOSTANDINOS VLLAHOJANIS, i biri i Athanasit, i datl. 1930, lindur dhe banues Iljupoli Athine, me cilesine e ortakëve me vullnet te lire dhe te plote, vendosen te krijojne Shoqerine Anonime , Shqiptare Greke " PERPARIMI SHA " , me qender ne Dhuvjan Gjirokaster.

H Y R J E

Ne kuptim te ketij akti themelues ortakët, MIHAL DELIJORGJI, SPIRIDHON SIMANDIRIS, KOSTANDINOS VLLAHOJANIS, jane themelues te Shoqerise Anonime " PERPARIMI SHA " .

Qellimi i ketij akti themelues eshte krijimi i Shoqerise " PERPARIMI SHA " , me qender ne DHUVJAN GJIROKASTER., dhe me shtrirje ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise .

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj , neperputhje me aktin e themelimit ,statutin e saj, me ligjen Nr. 7512 date 10.8.1991 ,Kodin Tregtar, (Ligjin Nr. 7636 date 19.11.1992) , dhe aktet tjera ligjore te legjislacionit shqiptar.

O B J E K T I

Objekti i Shoqerise Anonine " PERPARIMI SHA " do te jete :

1. Tregti te pergjitheshme per import -eksport dhe transport internacional.

AFATI I VEPRIMTARISE

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete 50 vjete, por ky afat mun te shkurtohet apo te zgjatet , me vendimin e Asambles se Pergjitheshme , te shumices prej 2/3 te aksionereve .

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i Shoqerise " PERPARIMI SHA " do te jete 24 (njetee kater) lilion dhrami, i cili ndahet ne aksione ne vl prej 100 (njetinde mije) selilla .

Shoqeria drejtohet nga Keshilli drektues i cili perbehet prej tre antare. Per cdo mbledhje mbahet proces verbal i mbledhjes se qerres dhe neneshkruhet nga te gjithe pjesmarresit.

Shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetërore, si dhe sigurimet shoqërore etj.

JURIDIKSIONI

Shoqëria "PERPARIMI SHA", me qendër në Dhuvjan Gjirokastrë. të gjitha mosmarrëveshjet me personat juridikë e fizikë, vendas a të huaj, sidhe me organet shtetërore zgjidhen me mirkuptim, në të kundërt zgjidhja e tyre bëhet nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

ORTAKET :

1. MIHAL DELIJORGJI
2. SPIRIDHON SIMANDIRIS
3. KOSTANDINOS VILAHJANIS

REPUBLIKA E FSHQËRISË
NOTERLATIRANË

Nr. 3254 Rep
K. 1896 Kol

VERTETIM

Sot, me datën 5.10.1994 (nëntëdhjetë e katër), u parqiten personalisht në zyrën e Noterise Tiranë para mëjës Noteres, ortakët :
1. MIHAL DELIJORGJI, SPIRIDHON SIMANDIRIS, KOSTANDINOS VILAHJANIS
madhor me shtetësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e tyre u sigurova nga letërnjoftimet përkatëse, të cilat deklaruan se sipër është një akt themelimi i bërë me vullnetin e lirë dhe të plotë të tyre jashtë kësaj zyreje e nënshkruan atë rregullisht dhe une Notëria e vertetoj konform ligjes.

NOTERE



Shpirt Polaj

AVOKAT

VASIL HANXHANI ~~KRIJIM~~ SHOQERIE ANONIME ME EMERTIMIN "PERPARIMI" SH.A.
TREGJETI E PERGJITHESHME, TRANSPORT

Kapitali: 24.000.000 dhrahmi.

Ne Gjirokaster, sot me *date* 28.12.1993., dite ne
zyren e avokatise, u paraqiten: 1) Mihal Delijorgji, i biri i Pandeliut, b
nues ne Terihat te Gjirokastres, shtetas shqiptar, me numer pashaporti
542972, 2) Spiridhon Simandiris, i biri i Efstratiut, banues ne Kalithea
te Athines, Asllanogllu 62 me numer leternjofitimi A 240691, 3) Konstand
nos Vllahojanis, i biri i Athanasiut, banues ne Iliupoli te Athines, Fil
toh Llaon 17, me numer leternjofitimi TH 239868/67, 4)
bija e Jeorjiut, banues ne Athine, Shqathu 108, me numer leternjofitimi
H 556324/91, qe te tre te fundit shtetas greke, te cilet i njoh persona
lisht, qe dine shkrim e kendim, dhe kerkuan nga ana ime redaktimin e ke
tij statuti, nepermjet te cilit deklaruan, pranuan dhe rane dakort sa
jon:

Kontraktonjesit kr jojne Shoqerine Anonime me emertimin "PERPARIMI", shoqeri tregatera, transportuese SH.A., me seli ne fshatin Dhuvjan te Gjirokastres, me kapital 24.000.000 dhrahmi dhe me kushtet e meposhtme.

Neni 1

Krijohet Shoqeria Anonime me emertimin "PERPARIMI", shoqeri tregtare, transporti SH.A., me emertimin dallues "PERPARIMI SH.A.". Ne maredhenjet me te tjeret shoqeria do te perdore emertimin dallues "PERPARIMI S.A."

Neni 2

Selia e shoqerise caktohet ne fshatin Dhuvjan te Gjirokastres. Shoqeria, me vendim te Keshillit Administrativ, mund te hapi filjale, zyra dhe amvjente depozitimi ne vende te ndryshme te Shqiperise dhe jashte shtetit dhe te ngarkoje perfaqesimin e saj tek perfaqesues, duke percaktuar kushtet e funksionimit te filjaleve, te zyrave dhe te amvjenteve te depozitimit si dhe fuqine drejtuese tek te gjitha personat qe do t'i drejtojne keto, sikunder edhe tek perfaqesuesit e saj.

Neni 3

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet per 50 (pesedhjet) vjet, dhe fillon qe nga momenti i aprovimit te ketij statuti. Afati i shoqerise mund te zgjatet ose te shkurtohet me vendim te Asamblese se Pergjitheshme te shumices prej 2/3, te aksionereve.

Neni 4

Qellimi i shoqerise eshte: 1) transportimi i mallrave dhe produkte

12/6

ve nga Shqiperia jashte shtetit dhe e kunderta. 2) Tregetimi i çdo lloji produkti, materialeve ndertimi, produkteve industriale, ilace dhe te lloj produkti qe lejohet tregetimi nga ana e ligjeve shqiptare. 3) Mbrojtja e difikimi i çdo lende te pare, e perpunuar apo jo e perpunuar per prodhimin e produkteve, si p.sh ne menyre treguese prodhimi i produkteve inerte prej druri apo alumini, nepermjet lendeve te para te importuara apo jo, prodhimi i gelqeres, te skeleteve metalike te gateshme, te bbloqeve betonit dhe te çdo lloji tjeter materiali ndertimi. 4) Ndertimi, riparimi apo rikonstruksioni dhe tregetimi i truajve, ndertesave, apartamenteve, zyrrave, dyqaneve, monumenteve si dhe ndertesave te vecanta per perdorim shteteror, kishetar apo turistik. 5) Kryerja e tregetise se pergjithshme jashte shtetit per llogari te shoqerise apo per llogari te te treteve dhe perfaqesimi ne Shqiperi zyrrave te vendeve te tjera, si dhe blerja dhe shitja e aksioneve te shoqerive qe funksionojne ne Shqiperi dhe jashte saj.

Per arrijtjen e qellimeve te mesiperme shoqeria mund te bashkepunojte me çdo shoqeri te ligjeshme te çfaredo lloj forme ne Shqiperi dhe jashte shtetit, qe ka qellime ndervarrese, si dhe te marre pjese ne shoqeri te tjera te çfaredo lloj forme ligjore qofshin ne vend dhe jashte tij qe kane ose jo qellime te njejta.

Neni 5

Kapitali pjesemarrës caktohet ne shumen prej 24.000.000 dhrahm dhe ndahet ne ~~240 aksione~~ 240 aksione te emertuara me nje vlerë prej 100.000 dhrahmi secili aksion, dhe ky kapital eshte depozituar ne arken e shoqerise. Aksionet e shoqerise jane anonime dhe transferohen lirshem nepermjet xhirimit dhe dorezimit te titujvet. Aksionet priten nga libri dopjo i shoqerise, numerohen, vulesen dhe firmosen nga te gjithe anetaret e Keshillit Drejtues. Aksionet e shoqerise jane te pandashke dhe nuk njihet perveç se nje person per çdo aksion. Aksioneret e shoqerise pergjigjen vetem per depozitim dhe kontributit te tyre dhe gezojne pretendimin per pjesen qe ndahet çdo vit dhe ne rast shkrirje te shoqerise gezojne te drjten e pjesemarrjes gjate ndarrjes se produktit te likuidimit. Pronesia ne titullin e aksioneve presupozon se i zoti i aksioneve pranon kete statut. Per te gjitha maredhenjet e ortakeve me shoqer ne kompetente jane vetem Gjykatat ku shoqeria ka seline e saj kur keto maredhenje rrjedhin nga cilesia e tyre si aksionere. Shoqeris i ndalohet te krijojte aksione te veta, por lejohet qe aksionet te grumbullohen edhe vetem tek nje person. Çdo aksion jep te drejten e nje vote. Çdo ortak gezon aq vota sa jane dhe aksionet e tij.

Neni 6

Gjate pesevjeçarit të pare pas krijimit të shoqërisë, Këshilli Drejtues ka të drejtë, me vendim të tij që mirret me shumicën e 2/3 të anëtarëve të tij, të shtojë kapitalin pjesëmarrës duke prerë aksione të reja deri në nivelin e kapitalit fillestar të depozituar. Asambleja e Përgjithshme me vendim të saj, që mirret me shumicë absolute, mund të vendosë shtimin pa kufi të kapitalit të shoqërisë në çdo moment duke prerë aksione të reja. Në çdo rast kur kemi të bëjmë me rritje të kapitalit, që nuk bëhet me kontribut në natyrë, i jipet të drejtë me propozim gjithë kapitalit të ri brenda dy muajve nga momenti i marrjes së vendimit për shtimin e kapitalit, tek pjesëmarrësit e shoqërisë sipas pjesëmarrjes së tyre. Pas kalimit të këtij afati shoqëria mund të disponojë lirisht aksionet. Ortaket informohen për marrjen e këtij vendimi duke ngjitur lajmerimin në zyrat e shoqërisë apo dyqanet e saj, në Kolegjin e Avokateve të Gjirokastrës dhe duke e botuar në gazetën zyrtare të Qeverisë. Këshilli Drejtues pas miratimit të këtij statuti duhet patjetër brenda dy muajve të verifikojë dhe të vertetojë depozitim e kapitalit.

KESHILLI DREJTUES

Neni 7

Shoqëria drejtohet nga Këshilli Drejtues, që përbehet nga 3-7 anëtarë. Këshilli Drejtues fillon nga puna ditën e zgjedhjes së tij dhe zgjat deri në zgjedhjet e reja që bëhen në mbledhjen e gjashtë vjetore të Asamblese së Përgjithshme. Këshilltarët mund të rizgjidhen pa asnjë kufizim. Në rast se për çdo arsye krijohet vend bosh të një keshilltari anëtarët e tjerë që kanë mbetur dhe që janë të pakten 3, zgjedhin vet zëvendësin provizor. Kjo zgjedhje i kalon për miratim Asamblese së Përgjithshme. Veprimet e keshilltareve që zgjidhen në këtë mënyrë konsiderohen të mireqena, edhe sikur të mos miratohen ata nga Asambleja e Përgjithshme. Mos pjesëmarrja në Këshillin Drejtues të kujt do keshilltari për një periudhë mbi 6 muaj, konsiderohet si dorëheqje. Këshilli Drejtues gjatë mbledhjes së tij të parë zgjedh nga gjiri i keshilltareve me shumicë absolute Kryetarin, Keshilltarin Drejtues dhe Sekretarin. Kur mungon Kryetari, drejtimin e kryen Keshilltari Drejtues. Cilësite e mesipërme mund t'i takojnë dhe të njëjtit person. Kryetari i K.D. përfaqëson shoqërinë në emër të aksionareve, para çdo personi të tretë dhe çdo organi shtetëror, deri dhe tek çdo gjykatë. Gjithashtu, Kryetari thërret mbledhjet e K.D., i paraqet organit shtetëror mbikqyres proces verbalin dhe komunikatat e K.D., kur kjo kërkohet nga Statuti ose nga ligja, kujdeset për zbatimin e vendimeve të K.D. dhe mbikqyr gjithë ecimin e

puneve te shoqerise. Keshilltarit Drejtues mund t'i ngarkohen disa ose te gjitha kompetencat e Kryetarit te K.D. Çdo keshilltar gëzon te drejten e nje vote dhe mund te perfaqësoje me te drejte vote dhe ketem njtjeter keshilltar, ne rast se ka mandat me shkrim. K.D. mblidhet ne seline e shoqerise rregullisht nje here ne muaj dhe ben mbledhje te jashtezakoneshme ne çfaredo moment. K.D. vepron ne quorum kur jane prezedhe perfaqesohen gjysma plus nje e keshilltareve, por kurre nuk duhet jene me pak se tre anetaret e tij pjesemarres. Vendimet e K.D. miren shumice absolute, ne rast se nuk percaktohet ndryshe ne statut.

Neni 8

Per mbledhjet e K.D. mbahet libri i proces verbaleve qe firmos nga te gjitha anetaret e tij. Ne kete liber shkruhet çdo mendim i kuto keshilltari qe merr pjese ne mbledhjen e K.D. Pjese nga libri i proces verbaleve te K.D. vertetohen nge Kryetari ose N/Kryetari i K.D. o nga Keshilltari Drejtues dhe paraqiten para çdo Gjykate dhe autoritetve.

Neni 9

Keshillit Drejtues i takon drejtimi dhe administrimi i pergjithshem i çeshtjeve qe i takojne shoqerise dhe kryerja e te gjitha veprimeve qe kane lidhje me qellimin e shoqerise, me perjashtim te atyre vndimeve dhe veprimeve, te cilat ne baze te statutit ose te ligjit jane ne kompetence te Asamblese se Pergjitheshme;

2. Keshilli Drejtues, brenda kompetencave te mesiperme, i takojne:

a) Kujdeset per zbatimin e detyrimeve qe burojne nga Statuti dhe nga ligja si dhe nga vendimet e Asamblese se Pergjitheshme;

b) Cakton depozitimin e kapitalit ne dispozicion dhe rezerve shoqerise.

c) Percakton kushtet e pergjitheshme te kembimeve te shoqerise.

ç) Cakton personat, me firmat e te cileve shoqeria angazhohet me tjeret, deri dhe tek caktimi i autorizuesit dhe mandatdhenesit.

d) Miraton Rregulloren e brendeshme te domozdoshme dhe zgjidh te gjitha çeshtjet qe rrjedhin nga kontratat e shoqerise me personelin.

dh) Emeron dhe pushon avokatet, çdo lloj personeli, perfaqesuesit shoqerise dhe cakton detyrat, kompetencat dhe shperblimin e tyre.

e) Vendos krijimin dhe shkrirjen e filjaleve dhe zyrave te shoqerise ne vendin qe ka seline shoqeria dhe jashte shtetit.

f) Vendos pjesemarrjen e shoqerise ne nje shoqeri tjeter, greke a vendase, ne baze te kushteve dhe te kapitalit pjesemarres qe do te vendose.

g) Per llogari te shoqerise ushtron te gjitha kompetencat e autorizimit te pergjitheshem dhe ngrë, vazhdon apo anullon gjyqet e shoqerise.

rise para te gjitha gjykatave, ose paracitet shoqeria si padites, ose padites, ose edhe per qdo rast tjeter pjesemarrrese ne gjyq, duke patu mundesine te therrase arbitrame apo pajtime, te heqe konfiskime, hiqte dhe parashenimet, te heqe dore nga privilegje dhe te drejta, te ushtroje te gjitha mjetet ligjore te zakoneshme dhe te jashtezakoneshme te heqe dore nga qdo mjeti ligjor apo betimi si padites apo deshmita te ndermarre qdo akt procedural, te terheqe dhe te jape te holla, dokumenta dhe te leshoje autorizime me kompetencat e mesiperme apo me kompetenca me te kufizuara.

h) Harton gjendjen vjetore ekonomike te shoqerise, qe i paraqite Asamblese se Pergjitheshme, propozon destinimin e fitimeve dhe pjeseve qe do te ndahen, perpilon raportin ne lidhje me Statistikat Vjetore Ekonomike si dhe raportet per qeshtjet e pergjitheshme te rendit te ditese mbledhjeve te Asamblese.

i) Therret mbledhjet e zakoneshme dhe te jashtezakoneshme te Asamblese se Pergjitheshme dhe perpilon rendin e dites per keto mbledhje.

j) Krijon maredhenje shkembimi me Bankat dhe qdo Institucion Kredhesh per hapjen e llogarive dhe marrjen e kredive te qdo forme, per dritimin dhe terheqjen e te hollave, marrjen e huave, rregullimin e imorteteve dhe eksporteve dhe ne pergjithesi per kryerjen e qdo shkembimi dhe bashkepunimi me Banka dhe Institucione Krediti. Pret dhe hedh ne qarkullim, firmos, pranon qeqe xhirimi, kambiale ne forme urdheri, qek bankopolic ngarkesa dhe qdo lloj dokumenti me vlere.

3. Keshilli Drejtues mund t'i ngarkoje te gjitha ose nje pjese te kompetencave te tij tek nje ose me shume anetare te tij, ose tek nepunes te shoqerise, ose tek persona te trete, qe veprojne se bashku apo veq e veq, duke percaktuar kompetencat dhe kushtet e ushtrimit te ketyre kompetencave.

Neni 10

1. Qdo anetar i Keshillit Drejtues pergjigjet para shoqerise per fajet qe ben gjate drejtimit te qeshtjeve te shoqerise. Ne veqanti pergjigjet ne rast se Bilanci permban pasaktesi ose tregues te rreme, qe fshehin gjendjen reale te shoqerise.

2. Kjo pergjegjesi nuk ka fuqi ne rast se verifikon se i ngarkohet kjo pergjegjesi nje anetari te denje te familjes. Kjo nuk ka fuqi per te gjithe ata qe ushtroan detyrat e keshilltarit drejtues, te cilet kane detyrime ne qdo mbikqyrje. Gjithashtu, kjo pergjegjesi nuk ka fuqi per veprim apo mungesa qe bazohen ne vendime te ligjeshme te Asamblese se Pergjitheshme.

3. Qdo anetar i Keshillit Drejtues eshte i detyruar te ruaj fshtehesine e te dhenave te ndermarrjes, te cilat i njeh si rezultat i te qenurit keshilltar i saj.

4. Pretendimet e mesiperme ushtrohen ne baze te dispozitave t ligjeve ne fuqi dhe i neneshtrohen parashkimit trevjeçar, perderisa çeshtja ka te beje per nje dem me ane mashtrimi per nje dhjetvjeçar

5. Shoqeria mund te heqe dore nga pretendimet e saj persa i tak demshperblimit ose te bie ne mareveshje pas kalimit te nje dyvjeçari qe nga momenti i lindjes se pretendimit ne fjale dhe vetem kur mirre aprovimi i Asamblese se Pergjitheshme dhe nuk kundershtohet nga nje pakice qe perfaqeson 1/4 e kapitalit te shoqerise pjesemarrese ne As mble.

6. Pas miratimit te gjendjeve ekonomike vjetore, Asambleja e Pergjitheshme vendos me votim te veçante dhe me emer per shkarkimin e anetareve te Keshillit Drejtues nga çdo pergjegjesi demshperbilimi. Ne procesin e votimit per shkarkimin e anetareve te Keshillit Drejt kane te drejte te marrin pjese te gjithë anetaret e tij dhe nepunë e shoqerise vetem me aksionet e te cileve jane te zote.

Neni 11

1. Asnje shperblim ose demshperblim nuk i caktohet anetarit te Keshillit Drejtues pa miratimin me pare nga mbledhja e zakoneshme e Asamblese se Pergjitheshme. Si perjashtim pa vendimin e Asamblese se Pergjitheshme anetaret e Keshillit Drejtues kane te drejte, ne baze te ketij statuti, marrin si shpenzime paraqitjeje dhe demshperblyese per çdo mbledhje te Keshillit Drejtues, me te cilen morren pjese personalisht ose me perfaqesues dhjete mije (10.000) dhrahmi.

2. Dispozitat e paragrafit te mepareshem nuk zbatohen per shper blimet e sherbimit qe i behen shoqerise ne baze te baze te maredhenje te veçanta punesimi ose mandatdhenese.

ASAMBLEJA E PERGJITHESHME

Neni 12

Asambleja e Pergjitheshme e ortakeve eshte organi me i larte i Shoqerise dhe ka te drejte te vendose per çdo çeshtje qe i takon sho qerise. Vendimet e saj jane te detyrueshme si per ortaket qe i mirato jne ashtu dhe per ata qe nuk i miratojne, qofshin edhe perfaqesuesit e tyre dhe çdo tjeter personi, per huadhenesit, trashegimtare etj.

Neni 13

1. Asambleja e Pergjitheshme e ortakeve, e thirrur nga Keshilli Drejtues, mblidhet rregullisht ne seline e shoqerise te pakten nje here ne vit, brenda gjashtemuajorit te pare pas perfundimit te vitit te mepar shem financiar.

2. Brenda njezet diteve pas Asamblese se Pergjitheshme duhet te raqitet ne Ministrine e Tregetise kopje e proces verbaleve te mbledhjes dhe kur kemi te bejme me mbledhje te zakoneshme te Asamblese, nje kopje e gjendjes ekonomike te miratuar.

 - (c) nga cilido anetar ose anetare qe gjenden personalisht ose me perfaqesues me autorizim dhe qe perfaqesojne te pakten nje te dhjeten e numrit te pergjithshem te anetareve qe kane te drejte te votojne ne asamble, ose
 - (d) nga nje anetar ose anetare qe zoterojne aksione te shoqerise dhe kane te drejten e votes ne asamble per te cilat u pagua shuma gjithsej e barabarte minimalisht nje te dhjeten e shumes se pergjithshme, qe u pagua per te gjitha aksionet qe i japin kete te drejte. Pervec rasteve ku per kete qellim do te kerkohet votim i fshehte, deklarimi i kryetarit se nje votim u krye me ngritjen e duarve (njezeri ose me shumice konkrete) ose se i mohohet dhe rregjistrimi perkates ne librin e Proçesverbaleve te Shoqerise, perbejne deshmi te padiskutueshme te ngjarjes, pa kerkuar çdo deshmi tjeter si per numrin ashtu dhe te perqindjes qe votuan pro ose kunder ketij vendimi. Kerkesa per realizimin e votimit te fshehte mund te anulohet.
65. Me perjashtim te parashikimeve te Rregullit 68 ne rast se do te kerkohet berja e votimit te fshehte normal, ky do te behet me menyren qe percakton kryetari dhe rezultati i tij do te konsiderohet si vendim i asamblese gjate se ciles u kerkua berja e votimit te fshehte.

66. Ne rast barazimi te votave, pas votimit qe u be ose me ngritjen e duarve, ose me votim te fshehte, kryetari i asamblese nuk ka te drejte per here te dyte ose te drejte vote "fitues / veto".
67. Votimi i fshehte i kerkuar per zgjedhjen e kryetarit ose per anullim te asamblese, behet pa anullim. Votimi i fshehte qe nevojitet te behet per çfaredolloj problemi tjeter realizohet ne kohen qe cakton çdo here Kryetari asamblese, dhe per çdo pune tjeter perveç asaj qe u kerkua berja e votimit te fshehte mund te vazhdohet para se te kalohet ne berjen e votimit te fshehte.

VOTA E ANETAREVE

68. Me respektimin e te drejtave dhe te kufizimeve, qe çdo here shoqerojne cilendo klase ose klasa aksionesh, çdo anetar veçmas qe ndodhet personalisht ne votimet qe behen me ngritjen e duarve, ka te drejten e nje vote. Ne votimet e fshehta ka te drejten e nje vote per çdo aksion qe zoteron.
69. Ne rastin kur nje aksion zoterohet bashkarisht nga me shume se nje person, behet e pranueshme vota e atij me te vjetrit, ku ai voton personalisht ose me perfaqesues me autorizim, me rezultat qe votat e te tjereve te menjahohen. Per kete qellim vjetersia caktohet ne baze te renditjes se emrave qe tregohen ne Amzen e Anetareve.
70. Nje anetar, i cili menderisht eshte i paaftë ose per te cilin do te mundej te nxirrej vendim gjykate per perfaqesim ligjor per kete person, mund te votoje ose gjate votimit qe behet me ngritjen e duarve, ose gjate votimit te fshehte, nepermjet administratorit te pasurise se tij, te keshiltareve te tij, te avokatit (receiver), te kujdestarit (curator bonis), ose te personit tjeter me cilesine analoge qe caktohet nga kjo gjykate. Keta persona mund te votojne kur parashikohet votimi i fshehte edhe me perfaqesues te autorizuar.
71. Asnje person nuk ka te drejte te votoje ne cilendo asamble te pergjithshme,perveç ne se ka paguar te gjitha shumat per te cilat u thirr te paguaje ne lidhje me aksionet e Shoqerise qe zoteron ose çdo shume tjeter,qe duhet te paguaje nga ai qe ka lidhje me keto aksione.
72. Ne lidhje me te drejten e votes te kujtdo, nuk mund te kete kundërshtim, perveçse vetem ne asamble, ose ne asamblene qe behet pas anulimit, gjate se ciles jepet ose ofrohet vota qe ka lidhje me kundërshtimin qe u be dhe vote e cila nuk mohohet ne kete asamble, konsiderohet e sigurt per te gjitha qellimet. Cilido kundërshtim i tille qe behet ne kohen e duhur i kalohet Kryetarit ta asamblese, vendimi i te cilit eshte perfundimtar.



73. Ne rast votimi te fshehte anetaret mund te votojne ose vete, ose nepermjet perfaqesuesve te tyre te autorizuar.
74. Shkresa per caktimin e perfaqesuesit te autorizuar mban firmen e anetarit qe e cakton ose te perfaqesuesit te tij qe eshte i autorizuar sipas rregullave me shkrim, ose ne rast se ai qe e cakton eshte person juridik, vulen e personit te mesiperme ose firmen e autoritetit ose te perfaqesuesit te tij qe eshte i autorizuar per kete. Perfaqesuesi i autorizuar nuk eshte e domosdoshme qe te jete anetar i Shoqerise.
75. Dokumenti per caktimin e perfaqesuesit te autorizuar, si dhe autorizimi ose ndoshta ndonje dokument i autorizuar mbi bazen e te cilit u nenshkrua dokumenti i emerimit ose kopja e ketij autorizimi e legalizuar ligjerisht ose autorizim me shkrim duhet te depozitohen ne zyren e regjistruar te Shoqerise, ose ne çdo vend tjeter ne Qipro qe caktohet per kete qellim ne njoftimin ne te cilin therritet asambleja, ne çfaredo kohe para kohes se percaktuar per asamblene fillestare ose asamblene qe u be pas anulimit, sipas se ciles personi qe pershkruhet ne dokument ka ndermend te votoje ose ne rast votimi te fshehte ne çfaredo kohe para kohes se percaktuar per berjen e votimit te fshehte. Ne rast te çdo lloj shkeljeje nga urdheresat e mesiperme, dokumenti i percaktimit i perfaqesuesit te autorizuar nuk konsiderohet i sakte.
76. Dokumenti i caktimit te perfaqesuesit te autorizuar do te kete tipin pasues, ose tipin me te perafert sipas rrethanave:

“

SH.P.K. (LIMITED)

(Emri i Shoqerise)

Une / Ne..... nga....., anetar / anetare te Shoqerise se lartpermendur caktoj / caktojme si perfaqesuesin tim / tone te autorizuar.....nga ose ne rast se nuk ka mundesi ai, Z.....ngaper te votuar nga ana ime / jone gjate (vjetore ose speciale, sipas rastit) asamblese se pergjithshme te Shoqerise, e cila do te mbledhet me....., dhe ne cilendo asamble tjeter qe do te zhvillohet per shkak te anulimit.

U nenshkrua me.....
dita e muajit..... te vitit



77. Ne rastet ku qellimi i caktimit te perfaqesuesit te autorizuar eshte qe te jepet tek anetaret mundesia per te votuar pro ose kunder nje votimi, dokumenti i caktimit te perfaqesuesit te autorizuar do te kete tipin pasues ose tipin me te perafert sipas rrethanave:

“

SH.P.K. (LIMITED)

(Emri i Shoqerise)

Une / Ne..... nga....., anetar / anetare te Shoqerise se lartpermendur caktoj / caktojme si perfaqesuesin tim / tone te autorizuar..... nga..... ose ne rast se nuk ka mundesi ai, Z..... nga..... per te votuar nga ana ime / jone gjate (vjetore ose speciale, sipas rastit) asamblese se pergjithshme te Shoqerise, e cila do te mblidhet me....., dhe ne cilendo asamble tjeter qe do te zhvillohet per shkak te anullimit.

U nenshkrua me..... dita e muajit..... te vitit

Ky tip do te perdoret pro* / kunder votimit. Perfaqesuesi i autorizuar voton sipas vullnetit, pervec nese do t'i jepen udhezime te tjera.

* Anulloheni se nuk zbatohet ne kete rast.

78. Dokumenti i caktimit te perfaqesuesit te autorizuar konsiderohet se i jep atij kompetencen te kerkoje berjen e votimit te fshehte ose te marre pjese ne kerkesen qe depozitohet per kete qellim.
79. Vota qe u dha ne perputhje me kushtet e autorizimit konsiderohet e drejte edhe nese ndodh vdekja ose paaftesia mendore e anetarit qe ka dhene autorizimin, ose anullimi i autorizimit te perfaqesimit ose te autorizimit, ne baze te te cilit u nxorr dokumenti i autorizimit ose transferimi i aksionit per te cilin behej fjale ne dokumentin e autorizimit perderisa nuk u mor ne zyren e shoqerise njoftim me shkrim i ngjarjeve te mesiperme, para fillimit te asamblese ose te asamblese pas anullimit, gjate se ciles u be perdorimi i dokumentit te perfaqesimit.
80. Ne respektimin e urdheresave te Ligjit, vendimi me shkrim qe ka firmen e te gjitha anetareve, te cilet çdo here kane te drejte te marrin njoftimin per thirrjen e asamblese se pergjithshme per te marre pjese dhe te votojne ne to (ose ne rastin e personave juridike firmen e personave te tyre te autorizuar), eshte i pranueshem dhe ka te njejtat pasoja ligjore nese vendimi eshte votuar ne asamblene e Shoqerise



që u thërrit dhe u bë normalisht. Ky vendim ka mundësi të përbehet nga më shumë dokumenta të të njëjtit tip, ku secili nga ata mban firmën e njerit ose më shumë anëtarëve ose përfaqësuesve të tyre dhe në rastin e personave juridike anëtare të Shoqërisë, firmën e anëtarit të Këshillit Drejtues të tij, ose autoritetit tjetër të autorizuar ose të përfaqësuesit të autorizuar të caktuar prej tij.

PERSONA JURIDIKE QË VEPROJNË ME PËRFAQËSUES NË ASAMBLË

81. Cilindo person juridik, anëtar i Shoqërisë mundet pas një vendimi të Këshillit Drejtues ose organi tjetër drejtues të autorizojë sipas mendimit të tij cilindo person që të veprojë si përfaqësues i tij në cilindo asamble të Shoqërisë ose në çfarëdo klase të anëtarëve të Shoqërisë. Personi që autorizohet në këtë mënyrë ka të drejtë të veprojë në emër dhe për llogari të personit juridik, i cili përfaqëson atë kompetencë ku do të kishte mundësi të ushtronte personi juridik, nëse do të ishte anëtar i Shoqërisë si person fizik.

KESHILLI DREJTUES

82. Numri i anëtarëve të Këshillit Drejtues do të përcaktohet nga koha në kohë nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Numri i anëtarëve të Këshillit Drejtues do të jetë nga një e lart, nuk duhet gjithashtu të ketë kufi të sipërme për numrin e anëtarëve, përveç nëse Shoqëria vendos ndryshe pas Asamblese së Përgjithshme. Anëtarët e parë të Këshillit Drejtues të Shoqërisë duhet të caktohen me shkrim nga nënshkruesit e Aktit të Themelimit ose nga shumica e tyre dhe në këtë rast nuk është e nevojshme thirrja e cilesdo asambleje.
83. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues caktohet kurdoherë nga Shoqëria në Asamblenë e Përgjithshme. Ky shpërblim caktohet mbi bazën ditore. Për anëtarët e Këshillit Drejtues mundet gjithashtu të mbulohen të gjitha shpenzimet e levizjeve, hoteleve dhe të tjera të ngjashme me to, të cilat do të shpenzohen normalisht për paraqitjen e tyre në mbledhjet e Këshillit Drejtues ose të Këshilltarëve të tij, ose në Asambletë e Përgjithshme të Shoqërisë, ose për punë të Shoqërisë.
84. Domosdoshmëria për zotërim aksionesh nga anëtarët e Këshillit Drejtues mundet të caktohet nga Shoqëria në Asamblenë e Përgjithshme, dhe derisa të behet një gjë e tillë, një zotërim i tillë nuk është i domosdoshëm.
85. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Shoqërisë mund të jenë ose të behen anëtare të Këshillit Drejtues, ose të kenë pozita të tjera të larta, ose

te kene interesa te tjera ne cilendo shoqeri tjeter, themelimin e se ciles do ta nxiste Shoqeria ose tek e cila ajo ka interesa si aksioner,ose ne menyre tjeter,dhe nuk asnje detyrim te japin llogari ne Shoqeri per çeshtjen e shperblimit ose dobi te tjera qe perfitojne per shkak te kesaje cilesie ose te interesave qe kane ne shoqerine tjeter perveç nese Shoqeria e cakton ndryshe.

KOMPETENCA PER SIGURIM HUAJE

86. Keshilli Drejtues mund te ushtroje te gjitha kompetencat e Shoqerise per sigurimin e huave monetare. Per me shume mundet gjithashtu te ngarkoje ose te hipotekojë ndermarrjen, pasurine si edhe kapitalin e saj qe nuk është bere ende kerkesa per pagese ose pjese te tyre, te emetoje dëshmi per njohje borxhi dhe kapital aksionesh (debentures and debentures stock) dhe çertifikata te tjera borxhi qe perfaqesojne vlere monetare ose per sigurimin e çdo lloj borxhi, pergjegjesie ose detyrimi te Shoqerise ose te kujtdo personi te trete ose pavaresisht nga nje garanci e tille.

KOMPETENCAT DHE TE DREJTAT E ANETAREVE TE KESHILLIT DREJTUES

87. Punet e Shoqerise drejtohen nga Keshilli Drejtues, i cili mund te paguaje te gjitha shpenzimet qe behen per themelimin dhe rregjistrimin e Shoqerise, dhe te ushtroje te gjitha kompetencat e Shoqerise perveç atyre, te cilat ne baze te Ligjit ose te ketyre Rregullave, duhet te ushtrohen nga Shoqeria ne Asamblene e Pergjithshme, por me respektimin e ketyre Rregullave, te urdheresave te Ligjit dhe te rregullave te brendshme ne lidhje me to, te cilat nuk jane me kundërshtim me Rregullat ose urdheresat ashtu siç do te caktoje çdo here Shoqeria ne Asamblene e Pergjithshme, por ne asnje rast nuk mundet qe rregulli i brendshem i nxjerre nga Shoqeria ne Asamblene e Pergjithshme te konsiderojë te pavlefshem çdo lloj veprimi te meparshem te Keshillit Drejtues, i cili do te ishte i pavlefshem ne rast se nuk do te nxirrej ky rregull i brendshem.
88. Keshilli Drejtues mund te caktojë çdo here me dokument autorizues çdo lloj shoqerie, shtepi, person, ose organizate personash qe caktohet nga ai direkt ose indirekt per te vepruar si i perfaqesues ligjor i ose te autorizuar (attorneys) i / te Shoqerise. Keshilli Drejtues do te caktojë sipas gjykimit te vet, qellimet per te cilat behet ky perfaqesim ligjor, kompetencat duke perfshire dhe kompetencat dalluese, si edhe autorizimet qe kane perfaqesuesit ligjor qe caktohen ne kete menyre (por ne asnje rast keto autorizime te perfaqesimit ligjor nuk lejohet te tejkalojne kompetencat te citat ne baze te Rregullave jane ose mund te ushtrohen nga Keshilli



Drejtues), gjithashtu dhe intervalin kohor dhe kushtet për të cilat ky autorizim ligjor leshohet. Keshilli Drejtues mund të përfshijë në dokumentin ligjor të përfaqësimit sipas gjykimit të tij kushtet që kanë për qëllim mbrojtjen dhe lehtësimin e personave që zëvendësohen nga përfaqësuesit ligjor. Për më tepër, Keshilli Drejtues mund të autorizojë përfaqësuesin ligjor të tij që cakton në këto mënyrë, të transferojë të gjitha apo një pjesë të kompetencave që ka, duke përfshirë edhe kompetencat dalluese që autorizohen.

89. Shoqëria mund të ushtrojë kompetencat e saj që i jepen nga neni 36 i Ligjit, përsa i përket përdorimit të vules brenda vendit dhe këto kompetenca do t'i kalojnë Keshillit Drejtues.

90. Shoqëria mund të ushtrojë kompetencat që i japin nenet 114 deri 117 (duke i përfshirë të dy) të Ligjit, përsa i përket ruajtjes e rregjistrimit të Amzës të Anëtarësive (Dominion Register) jashtë selisë së tij. Keshilli Drejtues mundet (me respektimin e urdheresave të nënëve të mesipërme), të nxjerrë ose të ndryshojë rregulla sipas gjykimit të tij, që përforcojnë ruajtjen e cilesdo Amze të tillë.

91. 1) Çdo anëtar i Keshillit Drejtues, që ka një interes të çfaredoshëm direkt ose indirekt, në marrëveshje që mund të bëhet me Shoqërinë duhet të deklarojë natyrën e interesit të tij në mbledhjen e Keshillit Drejtues, në bazë të urdheresave të nenit 191 të Ligjit.

2) Anëtarët e Keshillit Drejtues mund të votojnë në lidhje me çfaredo lloj marrëveshje dhe nëse ka të ngjarë të kenë çfaredo lloj interesi në të, në rastin që do të votojnë, vota e tyre numërohet dhe prezenca e tyre merret parasysh për të parë nëse u formua apartia (numri minimal i domosdoshëm për të zhvilluar mbledhjen) në cilindo asamblë të Keshillit Drejtues, në të cilën do të mundësohej të paraqitej për studim cilado qoftë marrëveshje e tillë ose marrëveshje që parashikohet të bëhet.

3) Anëtarët e Keshillit Drejtues mund të zotërojnë çfaredo tjetër post ose pozicion drejtues në Shoqërinë që t'ju sjell fitim (përveç pozicionit të kontrollorit) shtesë për cilesinë e tyre si anëtarë të Keshillit Drejtues për kohën dhe me kushte të tilla (për sa i përket shpërblimit ose çfaredo gjeje tjetër) ashtu si do të vendoste Keshilli Drejtues në çdo rast. Cilesia e anëtarit të Keshillit Drejtues ose të anëtarit që pranohet nuk e pengon të lidhë marrëveshje me Shoqërinë ose përsa i përket përfitimit të çdo pozicioni tjetër drejtues që do t'i sillte të ardhura, ose si shites, blerës, e çdo gjeje tjetër. Marrëveshje të tilla që lidhen nga ose për llogari të Shoqërisë, nuk anulohen pavaresisht nga fakti se anëtar i Keshillit Drejtues ka interesa shtesë. Anëtarët e Keshillit Drejtues të cilët kanë nënshkruar marrëveshje me Shoqërinë ose kanë çdo lloj interesi siç përshkruhet më lart, nuk kanë asnjë detyrim kundrejt Shoqërisë për të treguar



LIRIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT DREJTUES

95. Vendi i cilitdo nga anetaret e Keshillit drejtues humbet kur ai :
- (a) humbet kete cilesi ne baze te nenit 176 te Ligjit ose
 - (b) shpallet falimentimi ose ben rregullime, ose vjen ne marreveshje me investuesit ne pergjithesi
 - (c) mohohet e drejta per t'u bere anetar i Keshillit Drejtues ne baze te urdhereses qe ka dale konform urdheresave te nenit 180 te Ligjit ose
 - (d) behet i paafte menderisht
 - (e) jep doreheqje nga pozicioni i tij me shkresen qe njofton Shoqerine.

EMERIMET SHITES PER KESHILLTARE DREJTUES DHE PUSHIMI I KESHILLTAREVE DREJTUES

96. Keshilli Drejtues ka kompetence ne çdo moment dhe nga koha ne kohe te emeroje çdo here cilindo person si anetar te tij, ose per plotesimin e nje vendi vakant, ose si anetare shtese per anetaret ekzistues te Keshillit Drejtues, me kushtin qe numri i pergjithshem i ketyre anetareve ne asnje rast te mos kaloje numrin e caktuar sipas ketyre Rregullave. Çdo anetar i Keshillit Drejtues qe emerohet ne kete menyre do te qendroje ne vendin e tij vetem deri ne asamblene e pergjithshme vjetore te ardhshme, ku ka te drejte te rizgjidhet.
97. Shoqeria mund te pushoje me vendim te zakonshem qe njoftohet veçanerisht, ne perputhje me nenin 136 te Ligjit, cilindo nga anetaret e Keshillit Drejtues para perfundimit te afatit te tij, pavaresisht nga sa perfshihen ne keto Rregulla, ose ne marreveshjen qe eshte bere midis Shoqerise dhe ketij anetari. Ky pushim nuk ndikon aspak per çdo lloj pretendimi per zhdëmtim, te cilin ky anetar mund ta kete per shkak te shkeljes se rregullave te çfaredo lloj marreveshjeje midis tij dhe Shoqerise.
98. Shoqeria mund ne çdo çast dhe nga koha ne kohe (pa cenuar kompetencat e Keshillit Drejtues sipas Rregullit 96) te emeroje me vendim te zakonshem cilindo person si anetar te Keshillit Drejtues dhe te percaktoje kohen per te cilen ky person do mbaje kete vend.



PROCEDURAT GJATE MBLEDHJEVE TE KESHILLIT DREJTUES

99. Keshilli Drejtues ka te drejte te mblidhet per te realizuar punet dhe te anulloje ose te rregulloje çeshtjet e mbledhjeve te tij sipas gjykimit te vet dhe per çeshtjet qe paraqiten gjate mbledhjeve me shumice votash. Thirrja per mbledhjen e Keshillit Drejtues mund te realizohet kurdohere qe do te kerkohet nga anetaret e Keshillit Drejtues ose nga sekretari qe ka per detyre ta beje pas kerkeses se ndonje anetari te Keshillit Drejtues. Per te gjitha anetaret e Keshillit Drejtues qe ndodh çdo here te mungojne nga Qiproja, te cilet do te komunikonin ne shoqeri adresen e tyre te regjistruar jashte Qipros, njoftimi do te jepet te pakten 96 ore para per thirrjen e ardhshme te mbledhjes se Keshillit Drejtues. Te gjitha mbledhjet e Keshillit Drejtues, si dhe ato te keshillave te tij thirren ne Qipro, ku gjendet administrata dhe kontrolli i shoqerise.
100. Keshilli Drejtues mund te percaktoje numrin minimal te domosdoshem per te zhvilluar punimet e tij dhe ne rast se nuk do ta caktoje, atehere dy nga anetaret e tij qe jane prezent ne nje mbledhje personalisht, ose me zevendes, perbejne kete numer.
101. Anetaret aktive te Keshillit Drejtues mund te ushtrojne te drejtat e tyre edhe ne rastin qe ngelet bosh vendi i kujdo nga anetaret e tij, por ne rastin qe numri qe caktohet nga, ose eshte sipas rregullave te Shoqerise i domosdoshem per te formuar numrin minimal, anetaret aktive ose ne analogji me rastin, anetari aktiv i Keshillit Drejtues, mund te veprojne si anetare, vetem me qellim qe numri i tyre te arrije numrin e percaktuar, ose me qellim te arrije numrin e caktuar, ose me qellim te realizohet thirrja e asamblese se pergjithshme te Shoqerise, por jo per çdo qellim tjeter te çfaredoshem.
102. Keshilli Drejtues mund te zgjedhe kryetarin e mbledhjeve te tij dhe te caktoje kohen ku do te kete funksion. Ne rastin qe nuk do te zgjidhej kryetari, ose ne rastin kur kryetari qe u zgjodh nuk paraqitet ne nje mbledhje, brenda 5 minutave nga koha e caktuar per thirrjen e mbledhjes, anetaret prezente te Keshillit Drejtues kane te drejte te zgjedhin nje prej tyre, per te drejtuar gjate mbledhjes.
103. Keshilli Drejtues mund te transferoje cilatdo nga kompetencat e veta ne keshill ose keshilla qe formohen nga nje ose me shume anetare te tij dhe emerohen nga Keshilli Drejtues sipas gjykimit te vet. Cilido qofte keshill i tille do te duhet te bjere dakort per kompetencat qe u transferuan tek ai per t'u ushtruar sipas rregullave qe ndoshta u vendosen per te nga Keshilli Drejtues, ne lidhje me kompetencat e tij, me ndertimin e tij, procedurat qe do ndiqen ne te, numrin minimal te domosdoshem (apartia) ose çfaredo gje tjeter.



104. Çdo keshill mund te zgjedhe kryetar per mbledhjet e tij. Ne rastin qe nuk do te zgjidhej kryetar me kete menyre ose kryetari i zgjedhur nuk paraqitet ne nje mbledhje brenda 5 minutave nga koha e thirrjes se mbledhjes, anetaret prezente mund te zgjedhin nje prej tyre per te drejtuar mbledhjen.
105. Me respektimin e Rregullave, qe ndoshta ka vendosur Keshilli Drejtues, çdo keshill mund te mblidhet dhe te anulloje mbledhjet e tij ashtu siç e gjen te drejte dhe te marre vendime per çeshtjet qe paraqiten me shumice votash te anetareve prezente.
106. Te gjitha veprimet qe behen nga cilado mbledhje e Keshillit Drejtues ose keshillit te tij, ose çdo person tjetër qe vepron me cilesine e anetarit te Keshillit Drejtues jane te vlefshme ligjerisht, madje edhe ne rast se me vone do te konstatohet se kishte ndonje difekt ne emerimin e nje anetari te tille, ose personit qe vepron siç pershkruhet me lart, ose keta anetare ose cilido prej tyre nuk kishin aftesite e domosdoshme per keto veprime. Keto veprime konsiderohen aq te sigurta njelloj sikurse nje person i tille te ishte emeruar normalisht dhe te kishte cilesite e caktuara per emerimin e tij si anetar i Keshillit Drejtues.
107. Vendimi me shkrim, leter e firmosur ose e legalizuar, teletekst, faksimile, telegram ose telegrame nepermjet kabllit nga çdo nje anetar i Keshillit Drejtues, ose zevendesi i tij eshte ligjerisht i pranueshem dhe ka te njetat pasoja ligjore njelloj sikur te ishte miratuar ne mbledhjen qe u thirr dhe u realizua normalisht nga Keshilli Drejtues. Ne rast se ky vendim eshte i pafirmosur, duhet te jete i perbere nga me shume se nje dokument, ku secili nga keta duhet te kete firmen e njerit ose me shume personave te mesiperm.

ZEVENDESIT E ANETAREVE TE KESHILLIT DREJTUES

108. (a) Secili nga anetaret e Keshillit Drejtues ka kompetence te caktoje çdo here nje anetar tjetër te Keshillit Drejtues ose cilindo person tjetër qe nuk eshte anetar i Keshillit Drejtues qe te veproje si zevendes i tij dhe mbi kete ka kompetence edhe per ta pushuar.
- (b) Zevendesi i nje anetari te Keshillit Drejtues i nenshtrohet nga te gjitha pikepamjet (perveç kompetences per emerimin dhe pagesen e nje zevendesi tjetër) rregullat qe kane edhe anetaret e tjere te Keshillit Drejtues dhe ka te drejte t'i dergohen te gjitha njoftimet persa i perket mbledhjeve te Keshillit Drejtues per te marre pjese, te kete te drejten e fjales dhe te votoje ne çdo mbledhje te tille ku do te marre pjese si anetar i Keshillit Drejtues dhe qe plotesohet prej tij.



- (c) Nje person mund te zevendesoje me shume se nje anetar te Keshillit Drejtues dhe per aq kohe qe vepron si zevendes per me shume se nje anetar ka te drejte te kete vote te vecante per secilin anetar te Keshillit Drejtues vecmas qe zevendeson dhe ne rastin kur eshte edhe anetar i Keshillit Drejtues ka te drejten e votes shtese te tij aq sa jane edhe anetaret qe zevendeson.
- (d) Emerimi ose pushimi i nje personi qe zevendeson nje anetaret e Keshillit Drejtues mund te behet me telegram, radiotelegram, ose me çfaredolloj menyre tjeter te miratuar nga Keshilli Drejtues. Telegrami ose radiotelegrami duhet te vertetohen sa me shpejt qe te jete e mundur me leter, por gjate kesaj kohe Shoqeria mund te veproje mbi bazen e ketij telegrami ose radiotelegrami.
- (e) Menjehere kur anetari i Keshillit Drejtues humbet cilesine e anetarit me menyre tjeter, ose per shkak te lenies bosh te vendit te tij ne mbledhjen e Shoqerise gjate se ciles rizgjidhet, personi qe emerohet nga ai siç percaktohet me siper nuk ka me asnje kompetence ose autorizim te veprojë si zevendes i anetarit te mesiperm.
- (f) Anetaret e Keshillit Drejtues nuk kane asnje pergjegjesi per veprimet dhe mungesat e zevendesve qe emerohen prej tyre.
- (g) Zevendesi i nje anetari te Keshillit Drejtues nuk merret aspak parasysh ne llogaritjen e numrit me te madh ose me te vogel te anetareve te Keshillit Drejtues qe lejohen çdo here, por merret parasysh ne rastet qe duhet te llogariten nese ka aparti ne nje mbledhje te Keshillit Drejtues ne te cilen ndodhet dhe ka te drejten e votes.

KESHILLTARI DREJTUES

109. Keshilli Drejtues ka te drejte te emeroje ne çdo kohe nje ose me shume nga anetaret e tij si keshilltare drejtues per nje periudhe dhe me kushte qe percaktohen gjithmone prej tij dhe sipas gjykimit te vet, ne menyren qe e konsideron te pershtateshme dhe me respektimin e çfaredolloj kushtesh e marreveshjeje qe u be per çdo rast specifik, mund te anulloje emerimin qe behet ne kete menyre. Anetarit te Keshillit Drejtues qe emerohet ne kete menyre nuk i lejohet per kete periudhe qe ka kete pozicion te jape doreheqje me vullnetin e tij me qellim rikthimi, as nuk merret parasysh gjate emerimit te anetareve te Keshillit Drejtues qe largohen me dëshiren e tyre me te drejte kthimi. Por, emerimi i tij do te perfundoje patjeter me te drejte ne rastin kur per çfaredolloj arsyeje do ta humbase cilesine si anetar i Keshillit Drejtues.


110. Keshilltari Drejtues ka te drejte te shperblehet (ose ne formen e pages, ose shperblimit, ose pjesemarrjes ne fitime, ose pjeserisht me njerin ose tjetren menyre) ashtu si do vendoste çdo here Keshilli Drejtues.
111. Keshilli Drejtues mund ti besojë dhe ti transferojë Keshilltarit Drejtues çfaredolloj kompetence qe ushtron ai duke theksuar keto kompetenca, kushtet dhe kufizimet qe caktohen sipas gjykimit te vet kurdohere. Kompetencat qe transferohen ne kete menyre mund te ushtrohen paralelisht me Keshillin Drejtues ose ekskluzivisht vetem nga Keshilltari Drejtues, me kushtin qe Keshilli Drejtues ka mundesi kurdohere ti anulloje, pezulloje ose te ndryshojë teresisht ose pjeserisht keto kompetenca qe transferohen ne kete menyre.

SEKRETARI

112. Sekretari emerohet nga Keshilli Drejtues i cili cakton njekohesisht sipas gjykimit te tij, afatin dhe shperblimin dhe kushtet e tjera qe do te realizohet ky emerim. Keshilli Drejtues mund te pushojë cilindo Sekretar qe emerohet ne kete menyre.
113. Asnje nuk mund te emerohet ose te kete pozicionin e Sekretarit perderisa ai eshte:
- (a) i vetmi anetar i Keshillit Drejtues te Shoqerise ose
 - (b) person juridik, i te cilit i vetmi anetar i Keshillit Drejtues eshte ne te njejten kohe dhe i vetmi anetar i Keshillit Drejtues te Shoqerise, ose,
 - (c) i vetmi anetar i Keshillit Drejtues te nje personi juridik, i cili eshte i vetmi anetar i Keshillit Drejtues te Shoqerise.
114. Ne rast se nje urdherese e Ligjit ose e ketyre Rregullave imponon ose autorizon qe nje veprim te kryhet nga nje anetar i Keshillit Drejtues dhe te Sekretarit ose keta persona, atehere kjo urdherese nuk konsiderohet se eshte plotesuar perderisa ky veprim i mesiperm behet nga i njejti person ose per te njejtin person, i cili kryen si detyrimet e anetarit te Keshillit Drejtues ashtu edhe te Sekretarit ose te zevendes sekretarit.

VULA


115. Keshilli Drejtues interesohet per ruajtjen e sigurt te vules, e cila perdoret vetem me autorizimin e Keshillit Drejtues ose Keshillit te tij qe eshte autorizuar per kete qellim nga Keshilli Drejtues. Çdo dokument qe do te vuloiset me kete vule, duhet te mbaje firmen e nje anetari te Keshillit Drejtues dhe si shtese te nenshkruhet nga Sekretari



ose nga nje anetar i dyte i Keshillit Drejtues ose nga nje person tjeter qe caktohet per kete qellim nga Keshilli Drejtues.

PJESSET (Dividentet) DHE KAPITALI REZERVE

116. Shoqeria ka te drejte te caktoje ne asamblene e pergjithshme pjeset, por asnje nga keto pjese nuk mund te tejkaloje pjesen qe propozon Keshilli Drejtues.
117. Keshilli Drejtues ka te drejte te paguaje çdo here tek anetaret pjese te ndermjetme, te cilat do t'i dukeshin atij te justifikuara nga fitimet e ndermarrjes.
118. Te gjitha pjeset do te paguhen nga fitimet dhe me asnje menyre tjeter.
119. Keshilli Drejtues mund, para se te propozoje çdo lloj pjese, te mbaje sipas gjykimit te vet disa shuma nga fitimet e shoqerise si reserve ose rezerva, per te cilat Keshilli Drejtues ka kompetencen e vet t'i perdore per çfaredollosj te fitimit per te cilin fitimet e shoqerise mund te perdoren ne menyre te pershtatshme dhe derisa te perdoren ne kete menyre Keshilli Drejtues ka kompetencen specifike per ti vene ne dispozicion te ndermarrjeve ose puneve te Shoqerise, ose t'i vendose ne investime ku nga koha ne kohe zgjedh Keshilli Drejtues sipas gjykimit te tij. Keshilli Drejtues mundet qe shitesat, t'i transferoje per nje perdorim tjeter pa i perfshire ne kapitalin reserve te Shoqerise, si fitime, qe nuk do t'i konsideronte te drejta per t'i shperndare.
120. Me ruajtjen e te drejtave te personave te cileve ndoshta i takon te zoterojne aksione qe iu sjellin te drejta specifike ne lidhje me pjesen, pjeset caktohen dhe paguhen ne varesi me shumate e paguara ose qe u garantuan si te paguara per aksionet, ne lidhje me te cilat paguhet pjesa, por ne rastin qe cilado shume paguhet dhe garantohet si e paguar per nje aksion te tille para se te behet thirrja qe ka lidhje me kete shume nuk llogaritet per qellimet e ketij Rregulli si shume e paguar per aksionin. Te gjitha pjeset qe ndahen dhe paguhen ne analogji me shumate te cilat u paguan ose u garantuan si te paguara per aksionet gjate çfaredollosj intervali kohor qe paguhet kjo pjese. Por, ne rastin kur nje aksion leshohet me kushtet qe percaktohen se pjesa mbi kete aksion eshte e paguar ne nje date specifike te caktuar, ky aksion fillon te sjelle pjese ne baze te ketyre kushteve.
121. Keshilli Drejtues mund te heqe nga te gjitha pjeset qe jane per t'ju paguar anetareve, cilendo shume (nese ekziston) qe duhet te paguhet menjehere nga kjo ne Shoqeri per shkak te thirrjeve ose me çdo menyre tjeter ne lidhje me aksionet qe zoteron ne Shoqeri.




122. Asambleja e pergjithshme qe cakton pjesen ose pjesen shtese (bonus) mund te vendose t'i derdhe ne teresi ose pjeserisht, me shperndarjen e elementeve te veçante aktive kryesisht aksionet e likujduara, letrat me vlere, letrave te borxhit (debentures or debenture stock) cilesdo shoqeri tjeter. Keshilli Drejtues zbaton kete vendim, dhe ne rast se del ndonje veshtiresi per kete shperndarje do ta zbushte ashtu siç e gjykon. Ne menyre me specifike mund te nxjerre çertifikata pjesore dhe te caktojë vleren per shperndarjen e ketyre elementeve te veçante aktive ose cilendo pjese te tyre dhe mund te marre vendim qe pagesat me leke ne dore tek cilido anetar do te behen mbi bazen e vleres qe percaktohet me kete menyre me qellim qe te rregullohen te drejtat e te gjitha pjeseve shtese, mund te kaloje elemente te tilla aktive tek keshilltaret (trustees) ashtu siç egjykon Keshilli Drejtues çdo here.
123. Pagesa e pjeseve, e perqindjeve te interesit, ose shumave te tjera monetare qe paguhet me leke ne dore ne lidhje me aksionet mund te behet me çek ose me urdher pagese (warrant) ose dergohet me poste ne adresen e rregjistruar te zoteruesit ose ne rastin kur zoteruesit e te njejtut aksion jane me shume se nje ne adresen e atij zoteruesi emri i te cilit eshte rregjistruar i pari ne librin e Amzes se anetaresise, ose tek personi dhe adresa te cilet do te percaktohen me shkrim nga zoteruesit. Keto çeke dhe urdher pagesa leshohen ne emrin e personit te cilit i dergohen. Ne rastin kur dy ose me shume persona kane aksione te perbashketa cilido nga keta zoterues mund te leshoje deftesa garancie te ligjshme per çdo lloj pjese, pjese shtese (bonus) ose shuma te tjera monetare qe paguhet ne lidhje me aksionet qe zoterojne bashkerisht.
124. Asnje pjese nuk sjell perqindje interesi ne dem te shoqerise.

LLOGARITE

125. Keshilli Drejtues do te kujdeset per mbajtjen e librave te pershtatshem te llogarise ne lidhje me:
- (a) Cilendo pjese monetare qe arketohet dhe shpenzohet nga Shoqeria si dhe çfare do çeshtje tjeter qe ka lidhje me arketimet dhe pagesat qe behen.
 - (b) Cilendo shitje – blerje mallrash nga Shoqeria.
 - (c) Aktivin dhe pasivin e shoqerise.

Librat qe mbahen, ne menyre qe te konsiderohen te pershtatshme, duhet te perfshijne te gjitha librat e llogarise qe jane te domosdoshem per te pasqyruar nje panorame te vertete e te drejte



te gjendjes se problemeve te Shoqerise dhe te tregojne kembimet e saj.

126. Librat e llogarise duhet te ruhen ne zyren qe eshte rregjistruar Shoqeria (seli) ose ne baze te nenit 141 (3) te Ligjit ne nje vend tjeter ose vende te tjera qe caktohet ose caktohen nga Keshilli Drejtues sipas gjykimit te tij dhe gjithashtu jane gjithmone te hapura per kontroll nga Keshilli Drejtues.
127. Keshilli Drejtues vendos çdo here deri ne çfare shkalle, ne cilen ore, ne cilat vende dhe ne çfare kushtesh e rregullash llogarite dhe librat e Shoqerise ose çdo gje tjeter prej tyre qofte, do te jene te hapura per kontroll nga anetaret e Shoqerise qe nuk jane anetare te Keshillit Drejtues. Asnje anetar (qe nuk ben pjese ne Keshillin Drejtues) nuk ka te gjitha te drejtat te kontrolloje çfaredo lloj llogarie, libri ose dokumenti te Shoqerise perveç shkalles qe do t'i jepet kjo e drejte nga Ligji ose ne rast se do te autorizohet per kete gje nga Keshilli Drejtues ose Shoqeria ne Asamblene e Pergjithshme.
128. Keshilli Drejtues kujdeset kurdohere ne baze te neneve 142, 144 dhe 151 te Ligjit te pergatiten dhe te paraqiten para Shoqerise ne asamblene e pergjithshme llogarit fitim-humbje (pasqyra e te ardhurave shpenzimeve), bilancet, llogarite e unifikuara (nese ekzistojne) dhe raportet qe pershkruhen ne nenet e mesiperme.
129. Kopja e çdo bilanci (i shoqeruar ne baze te ligjit me çdo dokument qe i bashkangjitet atij) i cili parashikohet te paraqitet para Shoqerise ne asamblene e pergjithshme, bashke me kopjen e raportit te kontrolloreve, dergohen te pakten 21 dite para dates se asamblese tek çdo nje nga anetaret e Shoqerise, tek çdo zoterues titujsh njohjeje borxhi te Shoqerise, si dhe te cilido person i regjistruar sipas Rregullit 37. Kuptohet se ky Rregull nuk percakton detyrimisht te dergohen kopje te dokumentave te mesiperme tek personat per te cilet adresa e tyre eshte e panjohur ne Shoqeri, ose ne me shume se nje person kur ata zoterojne bashkarisht aksione ose tituj njohjeje borxhi te Shoqerise.

KAPITALIZIMI I FITIMEVE

130. Shoqeria ne asamblene e pergjithshme mund, me rekomandimin e Keshillit Drejtues te vendose se eshte mire qe te kapitalizohet cilado pjese e shumes qe eshte e garantuar ne cilendo llogari te reserves se Shoqerise, ose eshte e garantuar ne llogarine fitim-humbje ose eshte ne dispozicion me nje menyre tjeter per qellime shperndarjeje dhe ne analogji te shkepuse kete shume per shperndarje tek anetaret, te cilet do te kishin te drejte per kete nese

do te ndahej me pjeset dhe me te njejtat analogji, me kushtin se kjo do te derdhet me leke ne dore dhe se do te perdoret ose per likujdimin, ose per likujdimin e shumave qe nga koha ne kohe jane te papaguara per aksionet qe zoterohen respektivisht nga keta anetare, ose per likujdimin e plote te aksioneve qe nuk jane emetuar ose te letrave te njohjes se borxhit te Shoqerise te cilat do te kalojne dhe do te shperndahen si dhenie huaje si te likujduara plotesisht te keta anetare dhe midis tyre ne analogji pjeserisht me njerin menyre dhe pjeserisht me tjetren dhe Keshilli Drejtues do te zbatoje kete vendim. Kuptohet se rezerva nga emetimi i aksioneve mbi shumen e plote, dhe rezerva per likujdimin e kapitalit mund qe per keto qellime te ketij Rregulli te jepet vetem per likujdimin e aksioneve qe nuk jane nxjerre dhe te cilat do te nxirren per anetaret e Shoqerise si aksione falas plotesisht te likujduara (bonus shares).

131. Ne rast se do te merret vendimi siç u tha me lart, Keshilli Drejtues kalon ne dispozicion dhe perdorim fitimet qe nuk u ndane per te cilat u vendos kapitalizimi me kete menyre, si dhe ndoshta kalimin e emetimit te aksioneve te likujduara ose te letrave te njohjes se borxhit. Keshilli Drejtues ne pergjithesi ben ate qe kerkohet per zbatimin e kesaj marreveshjeje dhe per kete qellim ka kompetencen e plote per te marre sipas gjykimit te vet te gjitha masat per nxjerrjen e certifikatave qe kane te drejte mbi nje pjese te aksioneve ose me pagese drejtpersedrejt ose me menyre tjeter per rastin e aksioneve ose te letrave te njohjes se borxhit qe duhet te ndahen ne pjese. Per me shume Keshilli Drejtues autorizon cilindo person per te lidhur, nga ana e te gjithe anetareve qe kane nje te drejte te tille, marreveshje me Shoqerine ne lidhje me kalimin tek ata respektivisht te çfaredolloj aksionesh shtese ose te letrave te njohjes se borxhit qe jane te garantuara (kredituara) si te likujduara ose cilatdo aksione shtese qofshin, ose letra me vlere, te cilat ndoshta i takojne gjate kapitalizimit ose ne çdo rast qe do te paraqitet, likujdimi nga ana e shoqerise per llogari te tyre, te shumave ose te cilesdo pjese te shumave qe ngelen pa paguar per keto nenaksione te tyre, me predispozicionin e analogjive respektive me fitimet e tyre per te cilat u vendos kapitalizimi. Marreveshja e cila behet ne baze te ketij autorizimi konsiderohet ligjerisht e sigurt dhe e lidhur per te gjithe keta anetare.

KONTROLLI I LLOGARIVE


132. Kontrolloret caktohen dhe detyrat e tyre rregullohen ne baze te neneve 153-156 (duke perfshire dhe keto dy nene) te Ligjit.



NJOFTIMET

133. Njoftimet jepen nga Shoqeria tek anetaret e saj ose personalisht ose me poste dhe dergohen tek ata ne adresen e regjistruar (ose nese nuk kane adrese te regjistruar ne Qipro) ne adresen ne Qipro qe keta anetare te Shoqerise do te caktojne. Ne rastin kur njoftimet dergohen me poste konsiderohen se u dorezuan, me kushtin se letra qe permban keto njoftime eshte postuar normalisht dhe mban adresen e sakte dhe shpenzimet e plota postare. Ne rastin e njoftimeve qe kane te bejne me thirrjen e asamblese konsiderohen se u dorezuan kur te kalojne 24 ore nga postimi i tyre dhe ne çdo rast tjeter ne kohen ne te cilen letra do te dorezohej ne kushte te qeta dhe me rrugen postare te zakonshme.
134. Persa i perket aksioneve qe zoterohen bashkarisht nga me shume se nje person, Shoqeria mund te jape njoftimet e saj tek zoteruesi i aksioneve, emri i te cilit eshte i pari ne Librin e Anetareve ne lidhje me aksionin.
135. Persa i perket personave qe fitojne te drejte mbi aksionin per shkak te vdekjes ose falimentimit te anetarit, Shoqeria mund t'i jape njoftimet me poste, me leter qe ka shpenzimet e nevojshme postare dhe drejtohet tek ata personalisht, ose me cilesine e tyre si perfaqesues te personit te vdekur, ose te avokatit (trustee) te falimentuesit, ose me çfaredolloj tjeter cilesie te ngjashme ne adresen e personave qe pretendojne kete te drejte qe iu dha per kete qellim ne Qipro, ose (derisa te jepet kjo adrese) ne çfaredolloj menyre tjeter qe do te mundej te jepej ne rastin qe nuk do te ndodhte vdekja ose falimentimi i anetarit.
136. Njoftimet qe i perkasin thirrjes se asamblese jepen me nje nga menytrat e parashikuara mesiper per:
- (a) te gjithe anetaret, perveç anetareve te cilet (meqenese nuk kane te regjistruar adresen ne Qipro) nuk njoftuan ne Shoqeri regjistrimin e adreses brenda Qipros per dorezimin e njoftimeve.
 - (b) cilindo person i cili ka prejardhje te zoterimit te aksionit, per shkak te cilesise se tij si person juridik, perfaqesuesi i nje anetari qe vdiq, ose avokatit (trustee) per falimentim, perderisa anetari nese nuk do te ndodhte vdekja ose falimentimi i tij do te kishte te drejte te merrte njoftimin per asamblene, dhe
 - (c) çdo here per kontrollorin e Shoqerise.

Asnje person tjeter nuk ka te drejte te marre njoftime per thirrjen e asamblese se pergjithshme.



SHPERNDARJA

137. Ne rast shperndarjeje te Shoqerise likujdatori mund me miratim te nje vendimi te veçante te Shoqerise dhe me sigurimin e cilitdo legalizim qe kerkohet nga Ligji te shperndaje midis anetareve ne leke ose ne natyre, plotesisht ose pjeserisht aktivet (mjetet) e Shoqerise (qofshin keta elemente aktive te se njejtës natyre ose jo) dhe per kete qellim do te percaktoje vleren llogjike te elementeve pasurore qe parashikohen te shperndahen, siç theksohet me lart si dhe menyren me te cilen keta elemente do te shperndahen midis anetareve ose ne klasa te ndryshme. Kuptohet se te gjitha çeshtjet e mesiperme ruhen, likujdatori mund te kaloje plotesisht ose pjeserisht aktivet te keshilltaret (trustees), mbi kete baze (trust) do te rekomandohet ne dobi te kontribuesve (contributories), ashtu siç do ta percaktoje likujdatori, por kuptohet se asnje nga anetaret nuk do te ridetyrohet te pranoje aksione ose dokumenta borxhi te ngarkuara me çfaredolloy detyrimesh.

ZHDEMTIMI

138. Çdo here anetaret e Keshillit Drejtues ose funksionaret e tjere te Shoqerise kane te drejte te marrin zhdemtime nga elementet aktive te Shoqerise per çfaredolloy demt qe ata sjellin ose pergjegjesi qe ata mund te kene nga zbatimi, ose per shkak te zbatimit te detyrave te tyre, duke perfshire dhe pergjegjesine qe vjen nga mbrojtja e çeshtjeve gjyqesore, civile ose penale, per te cilat nxirret vendimi pro atyre ose nga çlirimi i tyre nga çdo pergjegjesi ne lidhje me ankimin qe u be ne perputhje me kerkesat e nenit 383 te Ligjit, dhe nga kjo gjykata ka bere permiresime. Anetaret e Keshillit Drejtues ose funksionare te tjere te Shoqerise nuk kane asnje pergjegjesi per demet, demtimet ose aksidentet qe ndodhin ne Shoqeri gjate zbatimit ose per shkak te zbatimit te detyrave te tyre. Por, ky paragraf vlen vetem deri ne ata shkalle qe nuk bie ne kundërshtim me nenin 197 te Ligjit.

[Signature]

EMRAT, PERSHKRIMET DHE ADRESAT E TE NENSHKRUARVE

1. MEGASERVE CO. LIMITED

Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar
Evagoru 31
Lefkosia
Qipro

2. MEGALAW CO. LIMITED

Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar
Evagoru 31
Lefkosia
Qipro

U datua sot mete200.....

Deshmimtare te firmave te mesiperme:

HRISTOS PACALIDHIS,
Bulevardi Evagoru, 31,
K.P. 25617
Telefon.: 22677677
Lefkosia



Vertetohet se ky akt themelimi dhe
statuti i Shoqerise u redaktuan
nga mua.

(Firma)
HRISTOS PACALIDHIS
Avokat
Evagoru 31
Lefkosia

PERKTHYESI

Harito GRIBIZI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr...3157...Rep.

TIRANE, me : 23/ 3/2006

VERTETIM

Vertetohet se sot me daten 23.3.2006 , para meje noterit **Z.Agim XH.Robo** u paraqit Z.Harito Gribizi, i njohur personalisht prej meje, i cili me deklaroi se kete dokument : Akt i themelimit & Statuti i Shoqerise Aksionere Private Shpk "Feltex Holdings" e perktheu nga gjuha Greke ne gjuhen Shqipe besnikerisht me origjinalin bashkengjitur dhe firmosi rregullisht. Une noteri vertetoje rregullisht firmen e tij.

NOTER
Agim XH. ROBO




REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
N.6.5.21.... Rep.

VERTETIM

Sot, me daten 23.05.2006 (gjashte), u prezantua ne zyren noteriale, Rruga
Ismail Qemali, P. 27/1, Tirane, Z/Znj. Agim XH. BOBO, n. dokumenti
identifikimi 100, i cili me paraqiti originalin e dokumentit
100 - Helum Feltex Holohy, nga i cili behet nje
fotokopje dhe une noteri e vertetoj ate si te njejte me kete origjinal.

PULLE TAKSE



ΚΥΠΡΙΑΚΗ
REPUBLIC



ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑ
OF CYPRUS

HE 140713

MINISTRY OF COMMERCE, INDUSTRY AND TOURISM
DEPARTMENT OF REGISTRAR OF
COMPANIES AND OFFICIAL RECEIVER
NICOSIA

4 April, 2006

CERTIFICATE

FELTEX HOLDINGS LIMITED

It is hereby certified that, in accordance with the records kept by this Department,
the Registered Office of the above Company is situated at:

Evagorou, 31
P.C. 1066, Nicosia, Cyprus

For Registrar of Companies



REPUBLIKA E QIPROS

HE 140713

Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Turizmit
Departamenti i Regjistrimit të Shoqërive dhe të
Mbajtësi Zyrtar
Nicosia

8 Shkurt, 2006

VËRTETIM

FELTEX HOLDINGS LIMITED

Më anën e të cilit vërtetohet se, në përputhje me të dhënat e mbajtura nga ky Departament, selia e regjistruar e Shoqërisë së mësipërme, ndodhet në:

Evagorou, 31
P.C. 1066, Nicosia Qipro

Për Regjistrin e Shoqërive
(emër, mbiemër dhe firmë)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Notere Neriman Marika

Nr. 1049 rep.

Nr. - kol.

V Ë R T E T I M

Vertetoj se njesia bashkengjitur eshte perkthim besnik ne shqip i kopjes origjinale ne gjuhen angleze.

Originali i perket Vertetimit te dates 8.2.06 leshuar nga M.T.I.T te Rep. Qipros, per adresen e selise te shoqerise Feltex Holdings Limited.

Tirane me 09.03.06



Neriman Marika



HE 140713

MINISTRY OF COMMERCE, INDUSTRY AND TOURISM
DEPARTMENT OF REGISTRAR OF
COMPANIES AND OFFICIAL RECEIVER
NICOSIA

4 April, 2006

CERTIFICATE

FELTEX HOLDINGS LIMITED

It is hereby certified that, in accordance with the records kept by this Department the following are the Shareholders of the above Company :

Names and Addresses

Class (value)

No. of Shares

MEGASERVE CO. LIMITED

Evagorou, 31
P.C. 1066, Nicosia, Cyprus

ORDINARY (CYP 1,00)

500

MEGALAW CO. LIMITED

Evagorou, 31
P.C. 1066, Nicosia, Cyprus

ORDINARY (CYP 1,00)

500

[Signature]
L. CHRYSTAL
for Registrar of Companies

REPUBLIKA E QIPROS

HE 140713

Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Turizmit
Departamenti i Regjistrimit të Shoqërive dhe të
Mbajtësi Zyrtar
Nicosia

8 Shkurt, 2006

VËRTETIM

FELTEX HOLDINGS LIMITED

Më anën e të cilit vërtetohet se, në përputhje me të dhënat e mbajtura nga ky Departament, Shoqëria e mësipërme ka këta aksioner:

Emri dhe adresa	Klasa (Vlera)	Nr. i aksioneve
MEGASERVE CO. LIMITED Evagorou, 31 P.C. 1066, Nicosia Qipro	Të zakonshme (CYP 1,00)	500
MEGALAË CO. LIMITED Evagorou, 31 P.C. 1066, Nicosia Qipro	Të zakonshme (CYP 1,00)	500

Për Regjistrin e Shoqërive
(emër, mbiemër dhe firmë)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Notere Neriman Marika

Nr. 1051 rep.

Nr. - kol.

V Ë R T E T I M

Vertetoj se njesia bashkengjitur eshte perkthim besnik ne shqip i kopjes origjinale ne gjuhen angleze.

Originali i perket Vertetimit te dates 8.2.06 leshuar nga M.T.I.T te Rep. Qipros, per aksioneret e shoqerise Feltex Holdings Limited.

Tirane me 09.03.06

Neriman Marika





HE 140713

MINISTRY OF COMMERCE, INDUSTRY AND TOURISM
DEPARTMENT OF REGISTRAR OF
COMPANIES AND OFFICIAL RECEIVER
NICOSIA

4 April, 2006

CERTIFICATE

FELTEX HOLDINGS LIMITED

It is hereby certified that, in accordance with the records kept by this Department, the following are the Director and Secretary of the above Company:

Director

GEORGIA SOLONOS

Dimitri Liperti, 3
Kornos, P.C. 7640, Larnaca, Cyprus

Country of Nationality

Cyprus

Secretary

CHRISTOS PATSALIDES

Evagorou, 31
EVAGORAS BUILDING, 4th floor, Flat/Office 43
P.C. 1066, Nicosia, Cyprus

Country of Nationality

Cyprus

For Registrar of Companies




REPUBLIKA E QIPROS

HE 140713

Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Turizmit
Departamenti i Regjistrimit të Shoqërive dhe të
Mbajtësi Zyrtar
Nicosia

8 Shkurt, 2006



VËRTETIM

FELTEX HOLDINGS LIMITED

Më anën e të cilit vërtetohet se, në përputhje me të dhënat e mbajtura nga ky Departament, selia personat e mëposhtëm jënë Drejtori dhe Sekretari për Shoqërinë e mësipërme:

Drejtor

GEORGIA SOLONOS

Dimitri Liperti, 3
Kornos, P.C. 7640 Larnaca, Qipro

Shteti i Kombësisë

Qipro

Sekretar

CHRISTOS PATSALIDES

Evagorou, 31
Pallati Evagoras, kati i 4, Ap./Zyra 43
P.C. 1066, Nicosia Qipro

Shteti i Kombësisë

Qipro

Për Regjistrin e Shoqërive
(emër, mbiemër dhe firmë)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Notere Neriman Marika

Nr. 1050 rep.

Nr. _____ kol.

V Ë R T E T I M

Vertetoj se njesia bashkengjitur eshte perkthim besnik ne shqip i kopjes origjinale ne gjuhen angleze.

Origjinali i perket Vertetimit te dates 8.2.06 leshuar nga M.T.I.T te Rep. Qipros, per drejtorin dhe sekretarin e shoqerise Feltex Holdings Limited.

Tirane me 09.03.06

Neriman Marika



ΚΥΠΡΙΑΚΗ
REPUBLIC



ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑ
OF CYPRUS

HE 140713

**MINISTRY OF COMMERCE, INDUSTRY AND TOURISM
DEPARTMENT OF REGISTRAR OF
COMPANIES AND OFFICIAL RECEIVER
NICOSIA**

4 April, 2006

CERTIFICATE

FELTEX HOLDINGS LIMITED

It is hereby certified that, in accordance with the records kept by this Department, the above Company was registered on the 22 August, 2003 and is still on our Registry.

A handwritten signature in dark ink, appearing to read 'Constantinos', written over a faint circular stamp.

for Registrar of Companies



REPUBLIKA E QIPROS

HE 140713

Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Turizmit
Departamenti i Regjistrimit të Shoqërive dhe të
Mbajtësi Zyrtar
Nicosia

8 Shkurt, 2006

VËRTETIM

FELTEX HOLDINGS LIMITED

Më anën e të cilit vërtetohet se, në përputhje me të dhënat e mbajtura nga ky Departament, Shoqëria e mësipërme është regjistruar më datë 22 Gusht 2003 dhe vazhdon të jetë në Regjistrin tonë

Për Regjistrin e Shoqërive
(emër, mbiemër dhe firmë)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Notere Neriman Marika

Nr. 1048 rep.

Nr. - kol.


V Ë R T E T I M

Vertetoj se njesia bashkengjitur eshte perkthim besnik ne shqip i kopjes origjinale ne gjuhen angleze.

Originali i perket Vertetimit te dates 8.2.06 leshuar nga M.T.I.T te Rep. Qipros, ne lidhje me qenien te regjistruar te shoqerise Feltex Holdings Limited ne Regjistrin e Shoqerive.

Tirane me 09.03.06

Neriman Marika





HE 140713

HE 44

THE COMPANIES LAW, CAP. 113
Section 15(1)

CERTIFICATE OF INCORPORATION

IT IS HEREBY CERTIFIED that,


FELTEX HOLDINGS LIMITED

has this day been incorporated under the Companies Law, Cap. 113 as a Limited Liability Company.

Given under my hand in Nicosia on the 22nd of August, 2003

.....
Registrar of Companies

TRANSLATED TRUE COPY


for Registrar of Companies

4 April, 2006

REPUBLIKA E QIPROS

HE 140713

HE 44

LIGJI PËR SHOQËRITË, CAP. 113
Seksioni 15 (1)



VËRTETIM

REGJISTRIMI

Më anën e të cilit vërtetohet se,

FELTEX HOLDINGS LIMITED

Është regjistruar në këtë ditë, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë, Kap. 113, si një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Lëshuar prej meje në Nicosia, më datë 22 Gusht 2003.

Regjistruesi i Shoqërive

Përkthyer nga kopje origjinale
(emër, mbiemër, firma)

Për Regjistruesin e Shoqërive

4 Prill 2006

REPubLIKA E SHQIPERISE


NOTERIA TIRANE

N. 4230 Rep.

VERTETIM

Une i neneshkruari, Agim Xh. Robo, noter ne qytetin e Tiranes, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, vertetoj se kam perkthyer sa me siper nga anglishtja ne shqip njelloj me originalin.

Tirane, me 12.04.2006



**SHOQËRIA TREGTARE
PËRPARIMI SH.A.**

**VENDIM
I
ASAMBLESE SË AKSIONERËVE**

Sot, më datë 03.03.2006, pranë selisë së Shoqërisë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Aksionerëve, për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës të njoftuar rregullisht, si më poshtë vijon:

1. Miratimi i transferimit të aksioneve të shoqërisë në masën 51%;
2. Të ndryshme.

Në mbledhje janë të pranishëm të dy aksionerët e Shoqërisë, Shoqëria "FELMONT TRADE LIMITED", përfaqësuar sipas prokurës së datës 02 Shkurt 2006 nga Znj. Aikaterini Donta si dhe nga aksioneri Kristo Delijorgji, të cilët përfaqësojnë kapitalin aksioner në tërësinë e tij prej 100%. Mbledhja procedoi me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës, miratimin e transferimit të aksioneve të shoqërisë në masën 51% të kapitalit themeltar. Aksionet do të shiten nga aksioneri Shoqëria "FELMONT TRADE LIMITED", e cila si rrjedhim do të humbasë cilësinë e aksioneres së shoqërisë dhe do të blihen nga Shoqëria e të drejtës së qipros "FELTEX HOLDINGS LIMITED", e cila fiton të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja e këtyre aksioneve, duke fituar në të njëjtën kohë dhe cilësinë e aksioneres së shoqërisë.

Aksionerët e Shoqërisë, pas një diskutimi të rendit të ditës, me unanimitet vendosin të miratojnë shitjen e aksioneve të shoqërisë në masën 51% të cilat do të shiten nga aksionerja FELMONT TRADE LIMITED" dhe do të blihen nga shoqëria "FELTEX HOLDINGS LIMITED". Nga ana e palëve si më sipër do të lidhet kontrata përkatëse e shit-blerjes së aksioneve.



Asambleja e aksionerëve, pasi nuk ka pikë tjetër për të diskutuar, në mbështetje me aktet e themelimit dhe të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare",

VENDOSI:


- 1- Të miratojë transaksionin e shit-blerjes së aksioneve të shoqërisë në masën 51%, aksione që do të shiten nga Shoqëria "FELMONT TRADE LIMITED" dhe do të blihen nga shoqëria "FELTEX HOLDINGS LIMITED";
- 2- Të ngarkojë Drejtorin e Shoqërisë me depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

AKSIONERËT

FELMONT TRADE LIMITED
Përfaqësues me prokurë
AIKATERINI DONTA.
Aikaterini DONTA



Kristo DELIJORGJI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1033 Rep.

Nr. 109 Kol.



V Ë R T E T I M


Sot më datë 03/03/2006, para meje noteres Neriman MARIKA, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Znj. Aikaterini Donta, e bija e Anastasios, me rezidencë në Stamata Attika Greqi, Rruga 24 Trapezountos, me shtetësi greke, identiteti i të cilës sigurohet nga pasaporta me nr. B 582113 të lëshuar nga Republika e Greqisë më datë 04/10/2005 dhe Z. Kristo Delijorgji, i biri i Pandeliut, i datëlindjes 24.05.1972, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Durrës në adresën lagjia nr. 1, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me identitetin e të cilit u njoha nëpërmjet pasaportës me nr. Z0391275, të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noterja e vërtetova atë sipas ligjit.

Vendimi i mësipërm ju bë i njohur palëve në gjuhën angleze prej meje noteres.

N O T E R E

Neriman MARIKA

PROKURË
E
FELMONT TRADING SH.P.K.



MË ANË TË KËSAJ PROKURE TË LËSHUAR MË DATË 2 SHKURT 2006,
Nga
FELMONT TRADING SH.P.K.

Një shoqëri e themeluar dhe regjistruar në Republikën e Qipros, me numër regjistrimi Nr. 79955, me seli të regjistruar në adresën 31 Evagorou Ave, Pallati Evagoras, Apartamenti 41-42, e përfaqësuar nga Bordi i Drejtorëve, Drejtori i Vetëm Znj. Georgia Solonos, në praninë e Sekretarit Z. Christos Patsalides (më poshtë e quajtur Shoqëria), me anë të kësaj prokure, emëron dhe delegon:

1. Z. Artan Hajdari, avokat, mbajtës i licensës me nr. 745, me rezidencë në Tiranë, Shqipëri, Bl. Dëshmorët e Kombit, Tëin Toëers, Nr. 2, Ap. 9.1, me shtetësi shqiptare, identiteti i të cilit sigurohet nga pasaporta me nr. 0012166 lëshuar nga Republika e Shqipërisë;
 2. Znj. Eris Hysi, avokate, mbajtëse e licensës me nr. 1612, me rezidencë në Tiranë, Shqipëri, Bl. Dëshmorët e Kombit, Tëin Toëers, Nr. 2, Ap. 9.1, me shtetësi shqiptare, identiteti i të cilës sigurohet nga pasaporta me nr. Z 0777869 lëshuar nga Republika e Shqipërisë;
 3. Znj. Aikaterini Donta, e bija e Anastasios, me rezidencë në Stamata Attika Greqi, Rruga 24 Trapezountos, me shtetësi greke, identiteti i të cilës sigurohet nga pasaporta me nr. B 582113 të lëshuar nga Republika e Greqisë më datë 04/10/2005
- (më poshtë të quajtur si përfaqësues ose përfaqësuesit)

Për të vepruar së bashku ose secili veç e veç, si zëvendësues të ligjshëm dhe të vërtetë dhe përfaqësues të Shoqërisë, për të bërë në emër, në vend dhe për llogari të Shoqërisë të gjitha aktet dhe veprimet që mund të jenë të nevojshme, dhe në mënyrën që Shoqëria do të vepronte në Shqipëri, dhe më veçanërisht:

- 1- Të nënshkruajë dhe zbatoj "Kontratën e Shit-Blerjes së Kuotave" dhe dokumentat që kanë të bëjnë me transferimin nga ana e Shoqërisë në favor të shoqërisë së emërtuar "FELTEX HOLDING LIMITED", një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar rregullisht dhe që ekziston dhe funksionin vlefshëm sipas ligjeve të Qipros, të dymijë e pesëqind e nënëtdhejtë e pesë (2.595) aksioneve të regjistruara me të drejtë vote, me vlerë nominale të një aksioni prej tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind (37.500) lek secili, të cilët përfaqësojnë 51% të të gjithë kapitalit aksioner të shoqërisë të themeluar me emrin "PËRPARIMI SH.A.", në shoqëri e organizuar rregullisht sipas legjislacionit shqiptar (më poshtë referuar si "Përparimi"), duke përfshirë pa asnjë kufizim, të drejtën dhe autoritetin për të nënshkruar dhe zbatuar në emër të Shoqërisë Kontratën e Shit-Blerjes së Kuotave dhe çdo marrëveshje tjetër, emërim, marrje përsiëpr, instrument, veprim

ose çdo dokument tjetër që kërkohet në lidhje me këtë shitje nga ana e Shoqërisë, së bashku me çdo marrëveshje ose instrumenta të tjera që amendojnë, ndryshojnë, bëjnë anekse, ratifikojnë, konfirmojnë, zgjerojnë ose rinovojnë ndonjë nga dokumentat e përmendur, ose ndonjë term apo kusht në to, ose që pranojnë amendimin apo ndryshimin e një termi apo kushti në ndonjë prej dokumentave të referuar më sipër, duke përfshirë dhe marrëveshjet, instrumentat, veprimet ose dokumenta të tjera të cilat PËRFAQËSUESI mund ti konsiderojë të nevojshme apo të këshillueshme përsa i përket shitjes nga ana e Shoqërisë të aksioneve të zotëruara tek shoqëria Përparimi dhe/ose të nënshkruajë ose zbatojë çdo regjistrim të dokumentave të përmendura këtu ose në dokumentat e autorizuar që duhen zbatuar në emër të Shoqërisë si PËRFAQËSUES i shoqërisë, ose të gjitha bashkë, të cilat do të konsiderohen të përshtatshme nën diskrecionin absolut dhe lirë të tij.

- 2- Të paraqitet dhe të përfaqësojë Shoqërisë përpara çdo organi qeveritar, të lartë, gjyqësor ose autoriteteve locale, enteve publike, departamenteve qeveritare, shoqatave, personave juridik shtetëror ose privat, dhe në përgjithësi të veprojë për interesin më të mirë të Shoqërisë, brenda kufijve të përcaktuar në këtë Prokurë, me qëllim kryerjen dhe realizimin e të drejtave të veçanta të përcaktuara këtu dhe të kryejë çdo veprim të cilat lidhen me të drejtat e dhëna këtu dhe që synojnë përfundimin e tij, edhe pse ky veprim nuk është përmendur në mënyrë specifike dhe nuk është përfshirë në këtë Prokurë;

DHE AJO ME ANË TË KËSAJ PROKURE DEKLARON SE:

Shoqëria nëpërmjet kësaj miraton, ratifikon dhe konfirmon si të vlefshme dhe me forcë të plotë ligjore dhe të efektshme të gjitha veprimet që PËRFAQËSUESIT e përmendur kryejnë ose konsiderojnë që duhet të kryet sipas kësaj Prokure.

Vërtetoj se kjo PROKURË është ekzekutuar rregullisht në datën e mëposhtme.

(firmë)
Georgia Solonos
Drejtores

(firmë)
Christos Patsalides
Sekretare

Apostille
Konventa e Hages e 5 Tetorit 1961
1. Shteti i Qipros
Ky dokument publik
2. është nënshkruar nga Maria Voskou
3. i cili veprim në cilësinë e nënpunësit të distriktit
4. mban vulën dhe pullën e nënpunësit të distriktit
vërtetuar
5. në Nicosia
6. më datë 02.02.2006
7. nga D XENOPHONTOS
8. me nr. 15172/06
9. Pulla
10 Nënshkrimi

Sekretari i Përhershëm
Ministria e Rendit dhe Drejtësisë

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Notere Neriman Marika

Nr. 1047 rep.

Nr. _____ kol.

V Ë R T E T I M

Vertetoj se njesia bashkengjitur eshte perkthim besnik ne shqip i kopjes origjinale ne gjuhen angleze.

Originali i perket Prokures te dates 8.2.06 leshuar nga shoqeria Feltex Holdings Limited me ane te se ciles emerohen si perfaqesues te saj: Z.A.Hajdari, Znj.E.Hysi dhe Znj. Aikaterini Donta.

Tirane me 09.03.06

Neriman Marika



PROKURË

E

FELTEX HOLDINGS LIMITED

MË ANË TË KËSAJ PROKURE TË LËSHUAR MË DATË 2 SHKURT 2006,

Nga

FELTEX HOLDINGS LIMITED

Një shoqëri e themeluar dhe regjistruar në Republikën e Qipros, me numër regjistrimi Nr. 140713, me seli të regjistruar në adresën 31 Evagorou Ave, Pallati Evagoras, kati i 4, Nicosia Qipro, e përfaqësuar nga Bordi i Drejtorëve, Drejtori i Vetëm Znj. Georgia Solonos, në praninë e Sekretarit Z. Christos Patsalides (më poshtë e quajtur Shoqëria), me anë të kësaj prokure, emëron dhe delegon:

Znj. Aikaterini Donta, e bija e Anastasios, me rezidencë në Stamata Attika Greqi, Rruga 24 Trapezountos, me shtetësi greke, identiteti i të cilës sigurohet nga pasaporta me nr. B 582113 të lëshuar nga Republika e Greqisë më datë 04/10/2005 (më poshtë të quajtur si përfaqësuese)

si zëvendësuese të ligjshëm dhe të vërtetë dhe përfaqësuese të Shoqërisë, për të bërë në emër, në vend dhe për llogari të Shoqërisë të gjitha aktet dhe veprimet që mund të jenë të nevojshme, dhe në mënyrën që Shoqëria do të vepronte në Shqipëri, dhe më veçanërisht:

- 1- Të nënshkruajë dhe zbatoj "Kontratën e Shit-Blerjes së Kuotave" dhe dokumentat që kanë të bëjnë me blerjen nga Shoqëria dhe që shiten nga ana e shoqërisë së emërtuar "FELMONT TRADING SH.P.K.", një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar rregullisht dhe që ekziston dhe funksionin vlefshëm sipas ligjeve të Qipros, të dymijë e pesëqind e nënëtdhejtë e pesë (2.595) aksioneve të regjistruara me të drejtë vote, me vlerë nominale të një aksioni prej tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind (37.500) lek secili, të cilët përfaqësojnë 51% të të gjithë kapitalit aksioner të shoqërisë të themeluar me emrin "PËRPARIMI SH.A.", në shoqëri e organizuar rregullisht sipas legjislacionit shqiptar (më poshtë referuar si "Përparimi"), duke përfshirë pa asnjë kufizim, të drejtën dhe autoritetin për të nënshkruar dhe zbatuar në emër të Shoqërisë Kontratën e Shit-Blerjes së Kuotave dhe çdo marrëveshje tjetër, emërim, marrje përsiëpr, instrument, veprim ose çdo dokument tjetër që kërkohet në lidhje me këtë blerje nga ana e Shoqërisë, së bashku me çdo marrëveshje ose instrumenta të tjera që amendojnë, ndryshojnë, bëjnë anekse, ratifikojnë, konfirmojnë, zgjerojnë ose rinovojnë ndonjë nga dokumentat e përmendur, ose ndonjë term apo kusht në to, ose që pranojnë amendimin apo ndryshimin e një termi apo kushti në ndonjë prej dokumentave të



referuar më sipër, duke përfshirë dhe marrëveshjet, instrumentat, veprimet ose dokumenta të tjera të cilat PËRFAQËSUESI mund ti konsiderojë të nevojshme apo të këshillueshme përsa i përket blerjes nga ana e Shoqërisë të aksioneve të zotëruara tek shoqëria Përparimi dhe/ose të nënshkruajë ose zbatojë çdo regjistrim të dokumentave të përmendura këtu ose në dokumentat e autorizuar që duhen zbatuar në emër të Shoqërisë si PËRFAQËSUES i shoqërisë, ose të gjitha bashkë, të cilat do të konsiderohen të përshtatshme nën diskrecionin absolut dhe lirë të tij.

- 2- Të paraqitet dhe të përfaqësojë Shoqërisë përpara çdo organi qeveritar, të lartë, gjyqësor ose autoriteteve lokale, enteve publike, departamenteve qeveritare, shoqatave, personave juridik shtetëror ose privat, dhe në përgjithësi të veprojë për interesin më të mirë të Shoqërisë, brenda kufijve të përcaktuar në këtë Prokurë, me qëllim kryerjen dhe realizimin e të drejtave të veçanta të përcaktuara këtu dhe të kryejë çdo veprim të cilat lidhen me të drejtat e dhëna këtu dhe që synojnë përfundimin e tij, edhe pse ky veprim nuk është përmendur në mënyrë specifike dhe nuk është përfshirë në këtë Prokurë;

DHE AJO ME ANË TË KËSAJ PROKURE DEKLARON SE:

Shoqëria nëpërmjet kësaj miraton, ratifikon dhe konfirmon si të vlefshme dhe me forcë të plotë ligjore dhe të efektshme të gjitha veprimet që PËRFAQËSUESIT e përmendur kryejnë ose konsiderojnë që duhet të kryet sipas kësaj Prokure.

Vërtetohet se kjo PROKURË është ekzekutuar rregullisht në datën e mëposhtme.

(firmë)
Georgia Solonos
Drejtore

(firmë)
Christos Patsalides
Sekretare

Apostille	
Konventa e Hages e 5 Tetorit 1961	
6. Shteti i Qipros	
Ky dokument publik	
7. është nënshkruar nga Maria Voskou	
8. i cili veprim në cilësinë e nënpunësit të distriktit	
9. mban vulën dhe pullën e nënpunësit të distriktit	
vërtetuar	
10. në Nicosia	6. më datë 02.02.2006
10. nga D XENOPHONTOS	
11. me nr. 15171/06	
12. Pulla	10 Nënshkrimi
Sekretari i Përhershëm	
Ministria e Rendit dhe Drejtësisë	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Notere *Neriman Marika*

Nr. 1046 rep.

Nr. - kol.

V Ë R T E T I M

Vertetoj se njesia bashkengjitur eshte perkthim besnik ne shqip i kopjes origjinale ne gjuhen angleze.

Originali i perket Prokures te dates 8.2.06 leshuar nga shoqeria Feltex Holdings Limited me ane te se ciles emerone si perfaqesues te saj Znj. Aikaterini Donta per te kryer te gjitha veprimet e nevojshme per shoqerine per te vepruar ne Shqiperi.

Tirane me 09.03.06

Neriman Marika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1032 Rep.

Nr. 108 Kol.

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 03/03/2006, para meje noteres Neriman MARIKA, Anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë u paraqitën Shitësi dhe Blerësi, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit-Blerje Kuotash, me termat si më poshtë vijon:

1. "FELMONT TRADING LTD", një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar rregullisht dhe regjistruar në Republikën e Qipros me numër regjistrimi 79955, që ekziston në mënyrë të vlefshme dhe funksionon sipas ligjeve të Qipros, me seli të regjistruar në adresën Rruga 31 Evagorou, Ndërtesa Evagoras, apartamenti 41 – 42, Nicosia, Qipro, e përfaqësuar ligjërisht për qëllimin e realizimit të kësaj kontrate dhe sipas prokurës së posaçme të datës 2 Shkurt 2006 nga **Z. Artan Hajdari**, avokat, mbajtës i licensës nr. 745, me qëndrim në Tiranë, Shqipëri, Bl. Dëshmorët e Kombit, Twin Tower, Nr. 2, Ap. 9.1, shtetas shqiptar, identiteti i të cilit provohet nga pasaporta Nr 0012166 e lëshuar nga Republika e Shqipërisë, **Znj. Eris Hysi**, avokate, mbajtëse e licensës nr. 1612, me qëndrim në Tiranë, Shqipëri, Bl. Dëshmorët e Kombit, Twin Tower, Nr. 2, Ap. 9.1, shtetase shqiptare, identiteti i të cilës provohet nga pasaporta Nr. Z 0777869 e lëshuar nga Republika e Shqipërisë më 20.11.2003 dhe **Znj. Aikaterini Donta**, e bija e Anastasios, rezidente në Stamata, Attika Greqi, Rruga 24 Trapezountos, shtetase greke, identiteti i të cilës provohet nga pasaporta Nr O 359263, lëshuar nga Republika e Greqisë, këtej e tutje quajtur "Shitësi";

DHE

2. "FELTEX HOLDINGS LIMITED", një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar private, e themeluar rregullisht dhe regjistruar në Republikën e Qipros me numër regjistrimi 140713, që ekziston në mënyrë të vlefshme dhe funksionon sipas ligjeve të Qipros, me seli të regjistruar në adresën Rruga 31 Evagorou, Ndërtesa Evagoras, kati 4-rt, Nicosia, Qipro, e përfaqësuar ligjërisht për qëllimin e realizimit të kësaj kontrate dhe sipas prokurës së posaçme të datës 2 Shkurt 2006 nga **Znj. Aikaterini Donta**, e bija e Anastasios, rezidente në Stamata, Attika Greqi, Rruga 24 Trapezountos, shtetase greke, identiteti i të cilës provohet nga pasaporta Nr O 359263, lëshuar nga Republika e Greqisë, këtej e tutje quajtur "Blerësi";

1. DUKE PATUR PARASYSH SE :

i. Blerësi është në procesin e fitimit të kontrollit të aksioneve në shoqërinë me emërtim tregtar "PERPARIMI SH.A.", një Shoqëri e organizuar rregullisht dhe themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 6657, datë 05.10.1994, me seli të regjistruar në Shkozë, Durrës, Shqipëri, këtej e tutje quajtur "Shoqëria", dhe në këtë mënyrë do të bëhet aksioneri kryesor i Shoqërisë.

ii. Shitësi është zotëruesi dhe poseduesi i vetëm dhe i padiskutueshëm i dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë (2.595) aksioneve të regjistruara me të drejtë vote dhe me vlerë nominale të një aksioni prej tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind (37.500) Lekë, që përfaqësojnë 51% të të gjithë kapitali aksioner të Shoqërisë (këtej e tutje quajtur "Aksione");

iii. Shoqëria ka një kapital prej njëqind e nëntëdhjetë milion e tetëqindmijë (190.800.000) Lekë, të ndarë në pesëmijë e tetëdhjetë e tetë (5.088) aksione të regjistruara me të drejtë vote dhe me vlerë nominale të një aksioni prej tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind (37.500) Lekë, të cilat janë nënshkruar dhe derdhur rregullisht dhe në mënyrë të vlefshme.

2. PËRSA ME SIPËR, dhe duke marrë parasysh kushtet paraprake dhe marrëveshjet reciproke si dhe kushtet që përmbahen në këtë kontratë, Shitësi shet, transferon dhe dorëzon tek Blerësi dhe Blerësi ble, pranon dhe merr në dorëzim nga ana e Shitësit, masën prej dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë (2.595) të aksioneve të regjistruara, që përfaqësojnë 51% të kapitalit aksioner aktual të Shoqërisë, sipas kushteve dhe termave të mëposhtme për të cilat palët kanë rënë dakort:

3. ÇMIMI I SHITJES DHE TERMAT E PAGESËS

Çmimi i shitjes së dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë (2.595) të aksioneve të përmendura më sipër nga Shitësi tek Blerësi është në total në vlerën pesëdhjetë mijë (50.000) EURO. E gjitha shuma, për të cilën palët bien dakort të jetë e drejtë, është paguar nga ana e Blerësin në favor të Shitësit jashtë kësaj zyre noterie.

4. PËRFAQËSIMI DHE GARANCITË E SHITËSIT

4.1. Shitësi përfaqëson dhe garanton shprehimisht dhe pa kushte, në lidhje me Shoqërinë, sa më poshtë vijon:

4.2. Shitësi është zotëruesi dhe poseduesi i vetëm dhe i padiskutueshëm i aksioneve të përshkruara më sipër, të cilat përjbëjnë dhe objektin e kësaj Kontrate. Të gjitha aksionet që përfaqësojnë 51% të kapitalit aksioner aktual të shoqërisë, janë të lira dhe nuk kanë asnjë barrë, peng, pretendim apo kontroll të çdo lloji apo natyre, kufizime për transferimin, taksa, interesa të letrave më vlerë, të drejta alternative, garanci, të drejta blerje, kontrata, premtime, kërkesa dhe barazie. Të gjitha aksionet në shoqëri që ekzistojnë aktualisht (p.sh. aksionet të cilat janë objekti i kësaj kontrate dhe mbetja e aksioneve që nuk janë objekt) janë të autorizuar rregullisht dhe të nënshkruar dhe emetuara rregullisht dhe vlera e tyre është paguar tërësisht.

4.3. Nuk ka asnjë preferencë ekzistuese ose të autorizuar, alternative, garancie, të drejta blerje, të drejta nënshkrimi, të drejta kthimi, të drejta shkëmbimi, marrëveshje, kontrata ose premtime, të cilat e detyrojnë Shitësin dhe/ose Shoqërinë të emetojnë ose shesin, transferojnë ose të disponojnë në një mënyrë tjetër ndonjë aksione në kapitalin aksioner të shoqërisë apo ndonjë letër me vlerë të kthyeshme ose shkëmbyeshme për ndonjë nga aksionet, ose të riblejë ndonjë aksion që është emetuar dhe nuk është dhënë asnjë

autorizim i cili kërkohet ose duhet të kërkohet nga Shitësi dhe/ose Shoqëria për emetimin, shitjen, ose të shkaktojë mospagimin e ndonjë aksioni në kapitalin e Shoqërisë.

4.4. Shoqëria është një person juridik i organizuar rregullisht dhe ekzistues në mënyrë të vlefshme dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar dhe ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat për të ushtruar aktivitet tregtar në të cilin është angazhuar dhe të zotërojë e përdorë pasuritë në pronësi dhe në përdorim prej saj. Shoqëria nuk ka shkelur andonjë akt themelimi, statut, rregullore, norma, vendim, urdhër, dekret, urdhëresë, ose kufizime nga qeveria, agjensi qeveritare, gjykatë nën juridiksionin e të së cilave është shoqëria, ose ndonjë dispozitë apo dokumenta organizative të shoqërisë.

4.5. Të gjitha librat e llogarisë dhe bilanci të Shoqërisë që janë të detyrueshme sipas ligjit në fuqi dhe të gjitha raportet financiare të Shoqërisë janë hartuar dhe mbajtur nga ana e kësaj që nga themelimi i saj, në përputhje me ligjet në fuqi dhe praktika, si dhe janë korrekte dhe të vërtetata të aspektin material sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikës.

5. MËNYRA E TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, Shitësi nuk ka asnjë të drejtë pronësie mbi 51% të aksioneve të zotëruara në kapitalin themeltar të Shoqërisë "PERPARIMI" Sh.a., dhe deklaron se nuk do të ketë në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi to. Ndërsa Blerësi bëhet pronar i 51% të aksioneve të shitura, duke fituar në këtë mënyrë dhe cilësinë e aksionerit të Shoqërisë.

Kapitali i Shoqërisë "PERPARIMI" Sh.a. pas realizimit të kësaj Kontrate Shit-Blerje Aksionesh do të posedohet në këtë mënyrë:

- FELTEX HOLDINGS LIMITED, në cilësinë e aksionerit zotëron 51% të kapitalit, të barabartë me dymijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë (2.595) aksione të regjistruara.
- Z. Kristo Delijorgji në cilësinë e aksionerit zotëron 49% të kapitalit, të barabarta me dymijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre (2.493) aksione të regjistruara.

Blerësi merr përsipër pa asnjë rezervë të gjitha të drejtat dhe detyrimet të çdo natyre që ka shoqëria dhe që rrjedhin nga zotërimi e posedimi i 51% të aksioneve të transferuara.

6. NDRYSHIME, DORËHEQJE, ETJ.

Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshje nuk mund të ndryshohet, fshihet ose përfundohet, me përjashtim të rastit kur ka një instrument shkruar dhe të nënshkruar nga palët, kundër të cilit bëhet i njohur zbatimi ndryshimi, fshirja ose përfundimi. Asnjë lloj dorëheqje nga ndonjë prej termave të kësaj Kontrate nuk do të shtrihet ose nuk do të prekë ndonjë term tjetër prej të cilit është dhënë dorëheqja në mënyrë të shprehur, dhe as do të dëmtojë ndonjë të drejtë që rrjedh prej saj. Asnjë vonesë ose tërheqje e ndonjë prej palëve kontraktuese në ushtrimin e të drejtave të saj, nuk do të quhet si dorëheqje dhe nuk do të paragjykohet si e tillë. Nëse kjo Kontratë do të ndryshohet, shprehja "kjo Kontratë" dhe fjalët "prej kësaj", "në këtë" dhe të ngjashme me to, do ti referohen kësaj Kontrate sipas ndryshimit përkatës dhe në kohën e realizimit të ndryshimit.

7. KONTRATA E PLOTË

Kjo Kontratë, përfshin të gjithë kontratën dhe mirëkuptimin e palëve sipas të drejtave përkatëse dhe detyrimeve të parashikuara në të dhe qëndron mbi të gjitha komunikimet e mëparshme gojore dhe me shkrim ndërmjet palëve kontraktuese që i përkasin objektit të kësaj kontrate. Palët në këtë kontratë bien dakort dhe njohin se ndonjë, çdo dhe të gjitha termat dhe dispozitat e kësaj Kontrate janë thelbësore dhe të domosdoshme. Përsa më sipër, secila palë në kontratë premtan dhe garanton palës tjetër shkarkimin me mirëbesim të të gjithë detyrimeve të tyre në përputhje me ndonjë, çdo dhe të gjitha termat dhe dispozitat e saj. Për më tepër, palët deklarojnë shprehimisht se gjatë zbatimit të kësaj kontrate, ata kanë marrë parasysh ndonjë dhe të gjitha ndryshimet e paparashikuara të rrethanave. Më tej, palët në këtë kontratë bien dakort të përmbushin çdo akt tjetër, të zbatojnë ato dhe të nënshkruajnë ato, në rast se ato mund të jenë të nevojshme ose të përshtatshme për të plotësuar qëllimin dhe synimin e kësaj Kontrate.

8. ZGJEDHJA E LEGJISLACIONIT DHE JURIDIKSIONIT

Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet nga Gjykata e Tiranës.

9. DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj.

Kjo kontratë hartohet në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast të mospërputhjeve në interpretim dhe zbatim të kësaj kontrate, përparësi do të ketë varianti në Shqip.

Kontrata hartohet në pesë 5 (pesë) kopje të njëjta në gjuhën angleze dhe shqipe, nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje do të depozitohet në Regjistrin Tregtar, një kopje do të depozitohet në aktet e Shoqërisë dhe kopja e fundit do të depozitohet në zyrën noteriale në të cilën është redaktuar.

Unë noterja, pasi redaktova termat e kësaj kontrate, jua bëra të ditur palëve kontraktuese të cilat e nënshkruajnë në praninë time me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

Për llogari të Shitësit

Emri: Z. Artan HAJDARI

Znj. Eris HYSI

Znj. Aikaterini DONTA

AIKATERINI DONTA

FELMONT TRADING LTD

Për llogari të Blerësit

Emri: Aikaterini DONTA

AIKATERINI DONTA

FELTEX HOLDINGS LIMITED

NOTERJA

Neriman MARIKA

Neriman Marika

KËRKESË

23.03.2006
23 MARS 2006

KËRKUES: Shoqëria Tregtare "PËRPARIMI" sh.a., përfaqësuar nga Drejtori i Shoqërisë Z.Mihal Delijorgji, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1257797.

OBJEKTI: Depozitimi i vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të datës 03.03.2006, për miratimin e transferimit të aksioneve.

PËRPARA GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

I nderuar Zoti Kryetar,

Shoqëria Tregtare "PËRPARIMI" sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin 6657, datë 05.10.1994 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Me cilësinë e Drejtorit të shoqërisë, paraqes këtë kërkesë përpara kësaj gjykate për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të datës 03.03.2006. Me anë të këtij vendimi, Asambleja e Aksionerëve, ka vendosur të miratojë transferimin e aksioneve të shoqërisë në masën 51% të kapitalit të shoqërisë.

Ky vendim është marrë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të shoqërisë. Për këto arsye kërkojmë depozitimin e vendimit të mësipërm të Asamblesë së Aksionerëve, datë 03.03.2006.

KËRKUES
DREJTORI

Mihal DELIJORGJI

Mihal Delijorgji

8/ Kontrolat nr 1032/10842
3/3/2006 Wenera chelo.

19-04-2006
Evis Hysa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1105 Rep.

Nr. - Kol.

V Ë R T E T I M

Sot më datë 20/03/2006, para meje noteres Neriman MARIKA, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Mihal Delijorgji, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1257797, me cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë Tregtare "PËRPARIMI" sh.a., i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTERE

Neriman MARIKA

Neriman Marika

*Taksa e Pulles
e pagua*

Shoqeria "Perparimi" Sh.a
Shkozet/Durres

INVENTARI
31.12.2004

Subjekti Preparimi Sh.A
NIPT J 819 065 04 A
Adresa e Veprimtarise Tregti e Pergjithshme

[illegible]


KOMISIONI

1. Petrit Hasani
2. Niko Zeneli
3. Zef Preka

Per Shogrine « Perparimi Sh.A

Drejtor i Pergjithshem

MIHAL DELIJORGI



SHOQERIA "PERPARIMI-SA "
SHKOZET-DURRES

NIPTI J81906504A

INVENTARI TOKA + TERRENE		VITI	2004
NR	EMERTIMI I A.Q.	NUMATJ	VLERA NE LEK
1	TOKA + TERRENE	m2	2395000 M.P 151 DT.01.01.2000
2	TOKA + TERRENE	m2	10440000 M.A 0359495 DT.12.06.00 BANK KUR.DURRES
3	TOKA + TERRENE	m2	5508500 MA 0359495 DT 12.06.2000
4	PARKU INDUSTRISE	m2	8118000 BANKA TIRANA DT 21.05.2000
5	PARKU INDUSTRISE	m2	8118000 BANKA TIRANA DT 21.05.2000
6	PAG.TROLLIN P.INDU	m2	5044320 M.P 157 DT 30.04.2002
GJENDJE ME 31.12.2003			39623820

KOMISIONI

Per Shoqerine "Perparimi" Sh.A

- 1.FLAMUR CAUSHI KRYETAR
- 2.XHEMIL SPAHIJA ANETAR
- 3.PETRIT HASANI ANETAR

Drejtor i Pergjithshem
MIHAL DELIJORGJI



Shoqeria "Perparimi" Sh.a
NIPTI J81906504A
KODI FISKAL 551617

INVENTARI I NDERTESAVE VITI 2004

Nr	Emertimi	Vlera	Gjenalitet
1	Oficina e Automjeteve		
2	Oficina e Automjeteve	2032982	ma-03592235 dt25.05.2000
1	Sheshet	8081928	ma-035996 dt01.06.2000
2	Rruga e betonit	13862921	Punime te kryera nga Shtatori 2000
3	Kanale betonit	981645	deri ne 30.03.2003
4	Rakordim me beton	1891989	30.03.2003
5	Hidroizolimi i shesheve	132135	30.03.2003
6	Peshorja	3308738	30.03.2003
7	Gropa e rampes	1175295	30.03.2003
8	Plintat qafa e plintave	156720	30.03.2003
9	Kapanoni ne form L	2160547	30.03.2003
10	Avllija	7261218	30.03.2003
11	Kabina e mpeshores	195222	30.03.2003
12	Muri ndares repa.Rrje	468272	30.03.2003
13	Sovat. I jashtem maga	321189	30.03.2003
14	P magazines ekzist	1113118	30.03.2003
15	Murindares I reparti gozhdes	214740	30.03.2003
16	P parafabrikeve	495070	30.03.2003
17	Porta e hyrjes kryesore	62490	30.03.2003
18	Gabina e rojes	280155	30.03.2003
19	BunkieretP	212112	30.03.2003
20	Vaska e ujit(H2O	70184	30.03.2003
21	Kabina e transformatorit	2115280	30.03.2003
22	Vv c	1467988	30.03.2003
23	Gropa septike	1237246	30.03.2003
24	Porta e re	175615	30.03.2003
25	Porta e vjeter	15120	30.03.2003
26	Lulishte	96343	30.03.2003
27	Punime god.dy kateshe	71811	30.03.2003
1	Punime te kryera ne zyra	686080	30.03.2003
2	Punime te kryera ne zyra	811474	31.10.2003
3	Punime te kryera ne zyra	260344	31.10.2003
4	Punime te kryera ne zyra	796295	31.10.2003
5	Punime te kryera ne zyra	822058	31.10.2003
6	Punime te kryera ne zyra	704558	31.11.2003
7	Punime te kryera ne zyra	791700	31.11.2003
		784056	31.11.2003
TOTALI		55314608	

KOMISIONI

1.FLAMUR CAUSHI
2.XHEMIL SPAHIJA
3.PETRIT HASANI

KRYETAR
ANETAR
ANETAR

Per Shoqe Per Shoqerine "Perparimi"SH.A

Drejtor I P.Drejtor I Pergjithshem

Mihal DEI MIHAL DELIJORGJI

Shogeria "Perparimi" Sh.a

NIPTI J81906504A				
KODI FISKAL 551617				
	INVENTARI I PAISJEVE	DDT	31.12.2004	
Nr	EMERTIMI	N/ mat.	VLERA	GJENALITETE
1	Printer	cop 1(nje)	140420	FD.10K"KONFIN" DURES23.05.2000
2	Komputer	cop 1(nje)	138417	MP.29DT.15.06.2000"CANON"DURES
3	Komputer Printer	cop 1(nje)	212662	MP279 DT.10.05.1999"UNIVERSAL"COMPUTER,DR
4	Tavolina zyre	cop 1(nje)	21000	FD.10DT.10.04.1998"PRODRURI MOBILJE,PJEZ
5	Etazher	cop 1(nje)	24000	FD.10DT.10.04.1998"PRODRURI MOBILJE,PJEZ
6	Tavolin Komputeri	cop 1(nje)	9000	FD.10DT.10.04.1998"PRODRURI MOBILJE,PJEZ
7	Karrige stol	cop 1(nje)	12500	FD.10DT.10.04.1998"PRODRURI MOBILJE,PJEZ
8	Tavolin solloni	cop 1(nje)	6500	FD.10DT.10.04.1998"PRODRURI MOBILJE,PJEZ
9	Fotokopje	cop 1(nje)	149012	2001"INFO SOFT" TIRANE
10	Printer komputeri	cop 1(nje)	58170	2001"CANON" DURES
11	Fotokopje	cop 1(nje)	174250	FAT.NR566 DT.04.11.2003"CANON" DURES
Shuma			945931	

INVENTARI I MJETEVE TRANSPORTIT

1	Makin"Lond Rover"TR582	cop 1(nje)	2020500	
2	Makin "Jep"TR 7850A	cop 1(nje)	2074000	2000
3	Makin "Bens"	cop 1(nje)	1200000	2000
4	Makin" Volvo"TR 0593A	cop 1(nje)	1571400	2000
5	Maakin "Daf"GJ0374A	cop 1(nje)	2010000	2000
6	Makin "Volvo e zeze"Gj44	cop 1(nje)	2052000	2000
7	Makin"Volvo" Gj 0254A	cop 1(nje)	1080000	2000
8	Rimorkio	cop 2(dy)	2513021	2000
9	Kamion"Bens Mercedes	cop 1(nje)	427670	dekI.Dog. nr15349 DT.15.10.2001
10	Autovetur"Mitsubishi"	cop 1(nje)	3992304	DekI.Dog. nr1324 dt.23.03.2003

SHUMA

KOMISIONI

- 1.FLAMUR CAUSHI
- 2.XHEMIL SPAHIA
- 3.PETRIT HASANI

[Signature]

18940895

Per"Shogeriine "Perparimi "Sh.a

MIHAN BELUORJLI



SHOQERIA "PERPARIMI"SH.A.
SHKOZET/DURRES

INVENTARI MAKINERI-PAJISJE ME DAT. 31.12.2004

N r	EMERTIMI	NJ/MAT	VLERA	GJENALITETE
1	Makineri per perpunim teli	Cop 3(tre)	1555345	Dek.Dog. nr5648 date25.05.1999
2	Makineri per perpunim hekuri	Cop 1(nje)	314684	Dek.Dog. nr8499 -//- 21.07.1999
3	Makineri perpunim teli	Cop 3(tre)	1068003	Dek.Dog. nr 13251 -//- 26.10.1999
4	Vinc piru I perdorur	Cop (1 nje)	290808	Dek.Dog. nr 2m/8 -//-29.02.2000
5	Makineri pe4r drejtim hekuri	Cop(2 dy)	1162778	Dek.Dog. nr.2788 -//-11.03.2000
6	Kompresor	Cop (1nje)	25466	Dek.Dog. nr.4629 -//- 9.04.2000
7	Makineri ngjitje teli	Cop(2 dy)	50932	Dek.Dog. nr. 4620 -//-9.04.2000
8	Makineri perpunim teli	Cop(1 nje)	1103925	Dek.Dog. nr.5268 -//-22.04.2000
9	Makineri per prodhim rrjete	Cop(1nje)	810071	Dek.Dog. nr.14464-//-7.12.1999
10	Grup elektrogjen	Cop(1nje)	711720	Dek,Dog. nr.2m/024-//-21.12.1999
11	Makineri terheqe teli	Cop(1nje)	366788	Dek.Dog. nr.7662 -//- 26.07.1999
12	Makineri	Cop(1 nje)	119872	1999
13	Radiator	Cop(1 nje)	171636	Dek.Dog. nr.939 -//-20.03.2001
14	Makineri heqe oksidi	Cop (1nje)	8745355	Dek.Dog. nr.2924 -//- 22.09.2001
15	Pjes per linje terheqe teli	Cop(1 nje)	20654597	Dek.Dog. nr.2922 -//- 22.09.2001
16	Pjes per rrjeta	Cop(1 nje)	4742255	Dek.Dog. nr.2923 -//-22.09.2001
17	Pjes per linje rrjete	Cop(1 nje)	735147	Dek.Dog. nr. 2885 -//-19.09 .2001
18	Pjes per linje rrjete	Cop(1 nje)	3942467	Dek.Dog. nr.2887 -//-19.09.2001
19	Pjes per linje rrjete	Cop(1 nje)	3067964	Dek.Dog. nr.2886 -//- 22.09.2001
20	Pjes per linje rrjete	Cop(1 nje)	1459807	Dek.Dog. nr.2888 -//- 20.09.2001
21	Pjes per linje rrjete	Cop(1 nje)	7806551	Dek.Dog. nr.2925 -//- 22.09.2001
22	Pomp	Cop(1 nje)	31001	Dek.Dog. nr.2955 -//- 24.09.2001
23	Pomp	Cop(1 nje)	34445	Dek.Dog. nr. 2955 -//- 24.09.2001
24	Pjes per linje rrjete	Cop(1 nje)	500981	Dek.Dog. nr.2955 -//- 24.09.2001
25	Gjenerator	Cop(1 nje)	218683	Dek.Dog. nr.2m/73 -//-25.09.2001
26	Makineri prerje hekuri	Cop(1 nje)	229176	Dek.Dog. nr.2m/74 -//-25.09.2001
27	Pjes impiant telezimi	Cop(1 nje)	46843	Dek.Dog. nr.3519 -//- 16.11.2001
28	Makineri perpunim metali	Cop(1 nje)	22495199	Dek.Dog. nr 2m/76 -//- 14.03.2001
29	Makineri perpunim metali	Cop(1 nje)	2480666	Dek.Dog. nr. 2m/77 -//- 25.09.2001
30	Pjes hidraulike	Cop(1nje)	1777704	Dek.Dog. nr. 2m/79 -//- 25.09.2001
31	Peshore e cmontuar	Cop(1 nje)	1858330	Dek.Dog. nr. 2m/80 -//- 25.09.2001
32	Makineri prodhim rrjete	Cop(1 nje)	395396	Dek.Dog. nr. 2m/82 -//- 25.09.2001
33	Koke saldatrice	Cop(1 nje)	599088	Dek.Dog. nr. 2m/02 -//- 08.01.2001
34	Pjese e impiantit te telezimit	Cop(1 nje)	4357302	Dek.Dog. nr. 3818 -//- 12.12.2001

35	Pjes linje rrjete	Cop(1 nje)	5356736	Dek.Dog. nr. 1201 -//- 20.09.20
36	Vinc portual	Cop (1nje)	1184890	Dek.Dog. nr. 2m/75 -//- 20.09.20
37	Pjes vinci	Cop(1 nje)	2287586	Dek. Dog. nr. 2544 -//- 11.08.2001
38	Pjes vinci	Cop (1 nje)	157985	Dek.Dog nr. 2m/75 -//- 25.09.200
39	Vinc I levizshem	Cop (1 nje)	1983132	Dek.Dog. nr. 2m/78 -//-25.09.2001
40	Vinc	Cop(1 nje)	1974972	Dek.Dog. nr. 2m/81 -//-25.09.2001
41	Vinc urre	Cop (1nje)	776369	Dek.Dog nr. 3229 -//- 07.10.200
42	Pjes vinci	Cop (1 nje)	140107	Dek.Dog nr. 1712 -//- 21.05.200
43	Makineri Omega paket,gozhde	Cop(1 nje)	8308294	Dek.Dog. nr. 2078 -//- 10.07.2002
44	Pjes linje zgare	Cop(1 nje)	9129175	Dek.Dog. nr. 2377 -//- 01.08.2002
45	Pjes makineri petezimi metali	Cop(1 nje)	559494	Dek.Dog. nr . 27-P -//- 27.01.2003
46	Pjes per makineri perpu. zgare	Cop(1 nje)	265940	Dek.Dog. nr. 4048 -//- 10.09.2003
47	Skrep I perdorur	Cop (1 nje)	1524409	Dek.Dog nr. A/1823 dt.09.02.2004
48	Koke makine telezimi	Cop(1 nje)	623128	Dek Dog nr. A/14250 dt 26.07.200

SHUMA

133.017.210

KOMISIONI

1.FLAMUR CAUSHI

2.XHEMIL SPAHIA

3.PETRIT HASANI

RAPORT
PER VLERESIMIN E ZMADHIMIT TE KAPITALIT TE SHOQERISE
“PERPARIMI”SH.A.

Ne zbatim te Vendimit date 24.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise “PERPARIMI”SH.A. “Per miratimin e ekspertit kontabel znj.Leze Abazi per hartimin e raportit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nga fitimet e realizuara gjate vitit 2004, kam pranuar misionin per hartimin e raportit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise “Perparimi”Sh.a. Durres.

Per verifikimin dhe vertetimin e dokumentacionit te vleresimit te fitimeve (kontributeve) per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise “Perparimi”Sh.a. realizohet nga znj.Leze Abazi.

Per realizimin e vleresimit te ketij kapitali (zmadhim kapitali) jam mbështetur ne aktet ligjore e nenligjore perkatese, në dokumentacionet qe dispononte drejtimi i shoqerise, si dhe në dokumentacionet e tjera dhe pikerisht:

1-Ne Bilancin Kontabel te vitit ushtrimor 2004 ku jane percaktuar dhe treguesit ekonomiko-financiare.

2-Ne Vendimin e dates 24.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise “Perparimi”Sh.a. per zmadhimin e kapitalit nga fitimet e realizuara gjate ushtrimit 2004.

3-Ne proces-verbalin e mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise “Perparimi”Sh.a.

4-Ne Vendimin Nr.6657/7, date 28.06.2005 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, per miratimin e ekspertes Leze Abazi per hartimin e raportit te vleresimit te kapitalit qe do te shtohet nga fitimet.

5-Ligji nr 7661 datë 19.01.93 “Per Kontabilitetin” dhe Plani Kontabel I Pergjithshem i Shqiperise.

6-Ligji nr. 7638 i dates 19.11.1992 “Per shoqeritë tregtare” .

7-Statuti I shoqerise “Perparimi”Sh.a.

8-Ligji Nr.8438, date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat”.





Dokumentacioni baze qe mu paraqit nga drejtimi I shoqerise "Perparimi" Sh.a. verteton egzistencen, pronesinë të kapitalit qe zotërohet nga ortakët, që shprehet dhe në zbatimin e procedurave te sakta per pregatitjen e ketij dokumentacioni per zmadhimin e kapitalit.

Të dhëna per Shoqerinë "Perparimi" Sh.a. per ortakët dhe kapitalin e saj.

Si shoqeri tregtare në formën e sh.a. eshte regjistruar me Vendimin nr.6657, date 05.10.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane me emertimin "Perparimi" Sh.a.

Perberja e ortakeve, selia, nga koha e themelimit deri ne vitin 2000, ka pesuar ndryshime sipas vendimeve te asamblese se ortakeve dhe depozitimit te tyre prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Sipas Vendimit Nr.6657/2, date 22.12.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte bere ndryshimi I selise nga fshati Dhuvjan Gjirokaster ne rrugen «Adria» Ish Oficina e Automjeteve Shkozet Durres.

Sipas Vendimit Nr.6657/4, date 28.04.2000 te Gjykates se Rrethit Tirane kapitali I shoqerise zotërohet nga ortakët:

- 1- Shoqeria «Felmont Trading Limited» me pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerise prej 51%,
- 2- Z.Kristo Delijorgji me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 49%.

Kapitali themeltar i shoqërisë deri me 31.12.2004 sipas Vendimit nr.6320/6 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane eshte prej 165.862.500 lekë, dhe zotërohet nga dy ortake sipas perqindjeve te pjesemarrjes se mesiperme.

Me Vendimin e dates 24.06.2005 kërkohet zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë "Perparimi" Sh.a. Durres nga fitimet e realizuara gjate ushtrimit 2004.

Meqenese shoqeria fitimet e realizuara gjate vitit 2004 nuk I shperndan ne forme dividenti por I kapitalizon ne shoqeri ne formen e aktiveve te qendrueshme dhe aktiveve qarkulluese te pasqyruara ne aktivin real te shoqerise do te beje shtese kapitali, si dhe do te kryeje procedurat per depozitimin e vendimeve te asamblese se ortakeve dhe te raportit te zmadhimit te kapitalit ne gjykate nga fitimet e vitit 2004.

Per cdo vit financiar shoqeria hartonte bilanc ku pasqyroheshin gjendjet e te gjitha llogarive e pasurive qe dispononte shoqeria.

Përbërja e zmadhimit të kapitalit të shoqerisë .

1 -Mbështetja ligjore per zmadhimin e kapitalit

- a) Ligji nr.7638 I dates 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"





- b) Ligji 7661 date 19.01.1993 "Per Kontabilitetin" dhe Plani Kontabel I Pergjithshem I Shqiperise
- c) Statuti I shoqerise "Perparimi"Sh.a.
- d) Vendimi I dates 24.06.2005 i Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "Perparimi"Sh.a.

2 - Realizimi i zmadhimit te kapitalit.

Ne perputhje me Vendimin e dates 24.06.2005 te marre nga Asambleja e Jashtezakonshme te shoqerise, zmadhimi I kapitalit konsistonte ne kalimin e fitimeve te realizuara nga shoqeria gjate ushtrimit 2004 ne kapitalin e shoqerise. Per caktimin me saktesi te vleres se zmadhimit te kapitalit qe do te shtohet ne kapitalin themeltar te shoqerise nga fitimet e realizuara te shoqerise "Perparimi"Sh.a. une vertetova:

- a) Saktesine dhe plotesine e dokumentacionit origjinal justifikues te llogaritjeve per fitimet sipas kerkesave te ligjit per shoqerite.
- b) Saktesine ligjore te ketij dokumentacioni. U vertetua se mbartja e tepricave te llogarive te vitit paraardhes ne llogarite e vitit pasardhes eshte bere me saktesi.
- c) Perputhjen e realizimit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise sipas kerkesave te e percaktuara ne Vendimin e dates 24.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise.

Puna ime analizuese, kontrolluese dhe vertetimi i kujdesshem i dokumentacionit qe u paraqit nga drejtimi I shoqerise "Perparimi"Sh.a. konkludoj se u perqendrua ne:

- a) Saktesine dhe plotesine e dokumentacionit origjinal justifikues te kryerjes se shpenzimeve ne formen e blerjes se aktiveve te qendrueshme dhe krijimit te aktiveve qarkulluese si dhe te drejtave ndaj te treteve qe pasqyrohen ne aktivin real te shoqerise.
- b) Saktesine ligjore te ketij dokumentacioni. U vertetua se dokumentat kishin te gjitha ekstremet ligjore te duhura ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me kerkesat e statutit te shoqerise.
- c) Perputhjen e llojit dhe natyres se shpenzimeve te bera nga shoqeria per





investimet dhe krijimin e aktiveve qarkulluese.

Ne vijim te kontrollit dhe vertetimit te kujdesshem te dokumentacionit qe u paraqit, dhe nga vertetimi fizik i bërë pranë qendres se veprimtarise konkludoj qe perberja, vlefte dhe lloji i dokumentave justifikues per secilin lloj te investimit te bere nga ortaket e shoqerise "Perparimi"Sh.a. per shtimin e kapitalit te shoqerise nga kontributet e ortakeve me burim fitimet e realizuara nga aktiviteti gjate vitit 2004 e te pa shperndara duke rritur numrin e aksioneve te kapitalit te shoqerise.

Aktivitet e qëndrueshme të trupezuara deri me 31.12.2004 janë inventarizuar nga komisioni I ngritur per kete qellim ne fund te vitit dhe vlefte e tyre eshte gjithsej prej 282.100.427 leke.

- Toka,troje, terrene, ndertime e instalime te pergjithshme prej 129.196.391 leke,
- Instalime teknike,makineri e paisje prej 133.017.210 leke,
- Te tjera ne shfrytezim prej 19.886.826 leke.

Aktivitet qarkulluese ne fund te vitit 2004 jane ne vlefte prej 363.068.696 leke si vijon:

-Gjendje te inventarit prej 106.364.967 leke ku jane perfshire gjendja e mallrave prej 70.760.733 leke, si dhe gjendja e materialeve te para prej 35.604.234 leke sipas inventarit fizik me 31.12.2004.

-Gjendja e kerkesave prej 256.164.215 leke qe perbejne te drejtat e shoqerise ndaj te treteve.

-Gjendja e likuiditeteve prej 539.514 leke qe perben gjendjen e parave ne fund te vitit ne arke prej 273.463 leke, gjendja e parave ne llogarine bankare prej 266.051 leke.

Fitimet e realizuara dhe dokumentacioni baze.

Sipas dokumentave baze, pra te bilancit kontabel te ushtrimit 2004 per shoqerine "Perparimi"Sh.a. dhe pasqyres se humbjeve e fitimeve, rezulton se:

Ne vitin 2004 shoqeria "Perparimi"Sh.a. ka realizuar nje fitim prej 24.958.932 leke.

Duke qene se ne bilancin e llogarive vjetore te mbyllur me 31.12.2004 shuma e fitimeve te realizuara gjate ushtrimit 2004 eshte prej **24.958.932** leke. Ne shtese te kapitalit do te perfshihet shuma prej **24.937.500** leke qe perbehet nga fitimet e





në përputhje me dokumentacionin bazë si: bilanceve kontabël, pasqyrave financiare dhe raportit të auditimit të ekspertit kontabël.

Për sa më lart në mbështetje të Statutit të Shoqërisë Lgjit Nr.7638, dt 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare", Asambleja e Jashtëzakonshme e Shoqërisë

VENDOSI

1. Miratimin e raportit të ekspertit kontabël, për zmadhimin e kapitalit themeltar nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara me 156.862.500 lekë, konkretisht kapitali themeltar që ishte në shumën 9.000.000 lekë, do të bëhet në shumën 165.862.500 lekë.

2. I gjithë dokumentacioni i përgatitur për zmadhimin e kapitalit themeltar nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri më 31.12.2003, të shoqërisë "Përparimi" sh.a., të depozitohet në Regjistrin Tregtar sipas kërkesave të Ligjit "Mbi Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të shoqërisë.

Ky vendim u miratua unanimisht nga aksionerët.

AKSIONERIN/ DONTAS AKSIONERËT

Për: "Felmont Trading Limited"

FELMONT TRADING LTD.
NICOSIA - CYPRUS



Kristo Deliborgji
Kristo DELIBORGJI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE Durrës

Nr. 0169 Rep. 045 Kol.



V Ë R T E T I M

Në Durrës sot më datën 21.Janar.2005, (dymijë e pesë), para meje Noter Bastri Meçaj, me zyrë noteriale në Rrugën "A. Goga", banesa Nr.385, Durrës, u paraqitën personalisht Z.Kristo Delijorgji, I biri I Pandeliut, lindur më 1972, me banim në Lagjen 1 Durrës, me Dok. Identiteti, Pasaportë Nr.1020249, dhe shoqëria "Felmont Trading Limited, shoqëri e huaj e krijuar sipas legjislacionit të Republikës së Qipros, regjistruar me vendimin Nr. 79955 , datë 28.06.1996, e cila përfaqësohet nga Znj. Aikaterini Donta, e ija e Anastasiut, me banim në Athinë, Rr. Trapezudos 24, me Dok. Identiteti, Pasaportë, me Nr. 799192, lindur më 1950, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij **Vendimi të Asamblesë** të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

Sa sipër unë noteri Vërtetoj, sipas ligjit 7829 datë 01.06.1994, "Për Noterinë"

NOTERI
Bastri Meçaj

SHOQËRIA "PËRPARIMI" SH.A.
SHKOZET-DURRËS

PROCES - VERBAL

I mbajtur sot më datën 14.01.2005, nga juristja e shoqërisë, znj. Dorina Asllanaj, lidhur me zhvillimin e mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të Shoqërisë Anonime "Përparimi" sh.a..

Kjo mbledhje zhvillohet në datën 14.01.2005, në orën 11.30', pranë selisë së shoqërisë në Shkozet, Durrës, drejtohet nga z.**Mihal Delijorgji**, sipas njoftimit të bërë në përputhje me rregullat ligjore (jo më pak se 15 ditë më parë), në datën 29.12.2004 nga ana e drejtorit të shoqërisë. Rendi i ditës i cili i është njoftuar paraprakisht aksionerëve të shoqërisë së bashku me njoftmin për pjesëmarrje është si më poshtë:

1. Miratimi I raportit të ekspertës kontabël, znj. **Leze Abazi**, për zmadhimin e kapitalit themeltar me fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri më 31.12.2003, nga shoqëria "Përparimi" sh.a..

Në mbledhjen e Jashtëzakonshme të Asamblesë së shoqërisë "Përparimi" sh.a., të datës 14.01.2005, ishin të pranishëm:

1. Shoqëria "**Felmont Trading Limited**", e cila zotëron 51% të aksioneve dhe si rrjedhojë 51% të votave, e përfaqësuar me autorizim të posaçëm nga znj. **Alkaterini Dontas**.
2. Z. **Kristo Delijorgji**, I cili zotëron 49% të aksioneve, dhe si rezultat 49% të votave, I pranishëm drejtpërsëdrejti.
3. Z. **Mihal Delijorgji**, Drejtor I Përgjithshëm I shoqërisë, pa të drejtë vote.
4. Znj. **Leze Abazi**, eksperte kontabël e shoqërisë, pa të drejtë vote.
5. Znj. **Dorina Asllanaj**, juriste e shoqërisë, pa të drejtë vote, mbajtësja e këtij proces-verbali.

Pasi u aprovua nga ana e aksionerëve rendi I ditës dhe pasi nuk pati asnjë ankesë në lidhje me njoftimet e bëra, mbledhja kaloi në shqyrtimin e rendit të ditës.

Nga ana e aksionerëve u shqyrtua hollësisht raporti I paraqitur nga ana e ekspertit kontabël si dhe dokumentacioni bashkangjitur këtij raporti, për zmadhimin e kapitalit themeltar. Zmadhimi I kapitalit bëhet pa ndryshuar kuotat e pjesëmarrjes në kapital të aksionerëve, por me rritjen e numrit të pjesëve të kapitalit në proporcion me rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Aksionerët u shprehën që në përputhje me raportin e ekspertës, zmadhimi I kapitalit do të jetë në shumën 156.862.500 leke.

Në mbledhje u vendos që shoqëria "Përparimi" sh.a. të rrisi kapitalin themeltar të saj nga 9.000.000 leke, në 165.862.500 leke pa ndryshuar përqindjen e pjesëmarrjes në kuotat e aksioneve të shoqërisë.

Numri I aksioneve të shoqërisë do të rritet nga 240 aksione në 4423, pra do të shtohen me 4183 aksione.

1. Shoqëria "**Felmont Trading Limited**", zotëron 51% të kapitalit themeltar ose 2.256 aksione me vlefte gjithsej prej 84.600.000 leke,


2. Z. **Kristo Delijorgji**, zotëron 49% të kapitalit themeltar, ose 2.167 aksione me vlefte gjithsej prej 81.262.500 leke.

Vendimi për të zgjeruar kapitalin e shoqërisë si më lart u miratua nga aksionerët unanimisht.

Durrës më 14.01.2005

DERJTUESI I MBLEDHJES

MIHAL DELIJORGJI



JURISTE

DORINA ASLLANAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES



Nr. 0170 Rep.

VERTETIMI



Në Durrës, sot më datën 21.01.2005, (Njëzet e një Janar Dymijë e pesë), para meje noter **Bastri Meçaj**, me zyrë noteriale në Rr."A.Goga", Banesa 385 për bri gjykatës në Durrës, pasi u sigurova për cilësitë e identitetet, e Z.-Mihal DELIJORGJI; me banim në Tiranë, Vtl.1966, me Pasaportë Nr.1257797, me cilësi të drejtorit të përgjithshëm për Shoqërinë "Përparimi" Sh.a.filiali Shkozet, Durrës; dhe Juristia Dorina Asllanaj, me banim në Tiranë e njohur prej meje noterit; rezulton se janë madhorë, me zotësi të plot juridike për të vepruar, të cilët deklarojnë se janë dakort me Proces-Verbalin e mbajtur prej tyre të dates 14.01.2005, rreth rendit të ditës të mbledhjes së jashtëzakonëshme të Asamblesë të kësaj Shoqërie; të hartuar, jashtë kësaj zyre dhe nënshkruan atë me dëshirë dhe vullnetin e tyre të lirë.

Unë noteri, vërtetoj, nënshkrimin e Saj sipas të drejtës që më njeh, ligji 7829 datë 01.06.94, "Për Noterinë".-----:

N O T E R I
Bastri Meçaj



POWER OF ATTORNEY

BY

FELMONT TRADING LIMITED

BY THIS POWER OF ATTORNEY given on the 10th day of January 2005
By

FELMONT TRADING LIMITED

a company incorporated and registered in the Republic of Cyprus, under registration No 79955 having its registered office at 31, Evagoras Building, 4th floor, Flat/Office 43, 1066 Nicosia, Cyprus, represented by its Board of Directors ie the sole director Ms Georgia Solonos, in the presence of its Secretary Mr Christos Patsalides (hereinafter called the "Company"), hereby appoints and authorises as special representative of the Company with full powers:

Mrs Aikaterini Dontas, daughter of Anastasios and Chrysanthi, of 24, Trapezountos ave., Stamata Attikis, Greece, holder of identity card Φ089078/28.9.2000, A.T. Ayios Stephanos, Attikis, (hereinafter the Special Representative)

to whom the Company gives the power and the right to act on behalf of and for the Company in relation with the Company's shareholding of 51% in the social capital of the company "Perparimi" S.A., an Albanian juridical person, on the following aspects:

- to present herself and represent the Company in the Extraordinary Assembly of "Perparimi" S.A which will take place on 14.01.2005 exercising

[Handwritten signature]





right on behalf of the Company related with the increase of capital of "Perparimi" S.A, with the profits and reserves made by "Perparimi" S.A. until the 31st of December of 2003.


The Special Representative has the power and the right to sign the respective minutes and all necessary and appropriate documents in relation to the above.


The Special Representative of the Company be and is hereby authorized to appear before any competent notary public and by virtue of proxy, grant the notarial power of attorney to any third person for the execution of part or all the above acts and to revoke the same at her sole discretion.

The Company by this authorisation since now recognises and accepts all the actions of the Special Representative, related with the above rights given to her as legal, well done, and with full legal power. The Company hereby recognizes all the actions and deeds of the Special Representative or any third person she might indicate as binding, invulnerable and valid for the Company.


IN WITNESS whereof this power of attorney has been executed this 10th day of January, year two thousand and five.

The common seal of **FELMONT TRADING LIMITED** was affixed hereto in the presence of:


Georgia Solonos
Sole Director


Christos Patsalides
Secretary

For **FELMONT TRADING LIMITED.**





**PROKURE
NGA**

FELMONT TRADING LIMITED

Prokure e leshuar me date 10 janar 2005

Nga

FELMONT TRADING LIMITED

Nje kompani e inkorporuar dhe e regjistruar ne Republiken e Qipros, me numer regjistrimi 79955, me zyre ne adresen: 31, Evagoras Building, kati i katert, zyra nr. 43, 1066 Nikozi, Qipro, e perfaqesuar nga Bordi i Drejtoreve, me drejtor te vetem znj. Georgia Solonos, ne prani te sekretarit Christos Patsalides (kete e tutje e quajtur "Kompani"), autorizon dhe cakton si perfaqesues te posacem me te drejta te plota:

Znj. Aikaterini Dontas, e bija e Anastasios dhe Crysanthi, ne adresen 24 Trapezountos ave., Stamata Attikis, Greqi, mbajtes i kartes se identitetit Ø089078/28.9.2000, A.T. Ayios Stephanos, Attikis (ketej e tutje i quajtur perfaqesuesi i posacem)

Kompania i jep te fuqi dhe te drejta te veproje per dhe ne emer te kompanise me lidhje me aksionet prej 51% te kompanise ne kapitalin social te kompanise "Perparimi S.A.", person juridik shqiptar, ne aspektet e meposhtme;

- te prezantohet dhe te perfaqesoje kompanine ne asamblene e jashtezakonshme te shoqerise "Perparimi S.A.", e cila do te zhvillohet me date 14.01.2005 duke ushtruar te drejten e votes ne emer te kompanise ne lidhje me cdo ceshtje te axhendes se kesaj assembleje duke nenshkruar procesverbalin perkates.

Perfaqesuesi i posacem ka fuqi dhe te drejta te nenshkruaje te gjitha dokumentat e duhura dhe te nevojshme ne lidhje per sa me siper.




Perfaqesuesi posacem i kompanise te jete dhe eshte i autorizuar te paraqitet para cdo noteri publik kompetent duke u mbështetur ne prokure, t'i jape prokure noteriale cdo personi te trete per ekzekutimin e pjesshem ose teresor te akteve te mesiperme dhe ta revokoj sipas gjykimit te tij.

Ne momentin e ketij autorizimi, kompania njeh dhe pranon te gjitha veprimet e perfaqesuesit te posacem, ne lidhje me te drejtat e mesiperme, si te ligjshme, te sakta dhe me fuqi te plote ligjore. Kompania njeh te gjitha veprimet dhe punet e perfaqesuesit te posacem ose te personit te trete qe cakton ajo si detyruese, te pacenueshme dhe te vlefshme per kompanine.

DESHMOHET se kjo prokure u ekzekutua me date 10 janar 2005.

Vula e zakonshme e FELMONT TRADING LIMITED u fiksua ne prani te:

Georgia Solonos

Drejtor i vetem

Firma, vula

Christos Patsalides

sekretar

firma

U firmos dhe u vulos sot ne pranine time nga Georgia Solonos dhe Christos Patsalides, te njohur personalisht prej meje. Ne pranine e deshmitareve vendosa me doren time firmen dhe vulen zyrtare.

10 janar 2005


Nenpunesi vertetues

Philippos A. Yiapatos

Nikozi, Qipro

Firma, vula

Perktheu LOELA XHAFI



RAPORT
PËR VLERËSIMIN E ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË
"PËRPARIMI"SH.A.

Në zbatim të Vendimit date 25.06.2004 të Asamblese së Aksionerëve të shoqërisë **"PËRPARIMI"SH.A.** "Për miratimin e ekspertit kontabël znj.**Leze Abazi** për hartimin e raportit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri më 31.12.2003, kam pranuar misionin për hartimin e raportit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë së mësipërme **"Përparimi"Sh.a.** Durrës.

Verifikimi dhe vertetimi i dokumentacionit të fitimeve të realizuara dhe të rezervave të krijuara nga shoqëria deri më 31.12.2003 dhe të vlerësimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese reale në aktivin e shoqërisë të krijuara nga këto fitime e rezerva të shoqërisë **"Përparimi"Sh.a.** realizohet nga znj.**Leze Abazi**.

Për realizimin e vlerësimit të këtij kapitali (zmadhim kapitali) jam mbështetur në aktet ligjore e nënligjore perkatese, në dokumentacionet që dispononte drejtimi i shoqërisë, si dhe në dokumentacionet e tjera dhe pikerisht:

1-Në Bilancet Kontabël të viteve ku janë percaktuar dhe treguesit ekonomiko-financiarë.

2-Në Vendimin date 25.06.2004 të Asamblese së Jashtëzakonshme të shoqërisë **"Përparimi"sh.a.** për miratimin e ekspertit për hartimin e raportit për zmadhimin e kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri më 31.12.2003 nga shoqëria.

3-Në proces-verbalin e mbledhjes së asamblesë së jashtëzakonshme të shoqërisë **"Përparimi"Sh.a.**

4-Në Vendimin Nr.6657/5 date 29.12.2004 I Gjykatës së rrethit Tirane, për miratimin e ekspertës **Leze Abazi** për hartimin e raportit të zmadhimit të kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat krijuara deri më 31.12.2003.

5-Ligji nr 7661 datë 19.01.93 "Për Kontabilitetin" dhe Plani Kontabel I Përgjithshëm i Shqipërisë.

6-Ligji nr. 7638 i dates 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

7-Statuti I shoqërisë **"Përparimi"Sh.a.**





8-Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të ardhurat".

Dokumentacioni bazë që m'u paraqit nga drejtimi I shoqërisë "Përparimi"Sh.a. vërteton egzistencën e pronsëisë së kapitalit që zotërohet nga ortakët, që shprehet dhe në zbatimin e procedurave të sakta për përgatitjen e këtij dokumentacioni për zmadhimin e kapitalit.

Të dhëna për Shoqërinë "Përparimi"Sh.a. për ortakët dhe kapitalin e saj.

Si shoqëri tregtare në formën e shoqërisë anonime është regjistruar me Vendimin nr.6657, datë 05.10.1994 të Gjykatës së rrethit Tiranë me emërtimin "Përparimi"Sh.a.

Përbërja e ortakëve, selia, dhe objekti I veprimtarisë së shoqërisë nga koha e themelimit deri në vitin 2004, ka pësuar ndryshime sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve dhe depozitimit të tyre pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Sipas Vendimit Nr.6657/2, datë 22.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë është bërë ndryshimi I selisë nga fshati Dhuvjan Gjirokastrë në rrugën "Adria", Ish Ofiçina e Automjeteve Shkozë Durres.

Sipas Vendimit Nr.6657/4, datë 28.04.2000 të Gjykatës së Rrethit Tirane kapitali I shoqërisë zotërohet nga ortakët:

- 1- Shoqëria **"Felmont Trading Limited"** me pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërisë prej 51%,
- 2- **Z.Kristo Delijorgji** me pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë prej 49%.

Me Vendimin e datës 25.06.2004 të Asamblesë së jashtëzakonshme të shoqërisë kërkohet zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë "Përparimi"Sh.a. Durres nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2003, si rezultat I krijimit të aktiveve të qëndrueshme dhe aktiveve qarkulluese të pasqyruara në aktivin real të shoqërisë.

Meqenëse shoqëria të gjitha fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara nga ushtrimi I aktivitetit që nga momenti i krijimit dhe deri më 31.12.2003 I ka riinvestuar në shoqëri sipas miratimit të llogarive vjetore për çdo ushtrim nga asambleja e ortakëve të shoqërisë "Përparimi"Sh.a. për të cilat nuk ka bërë ndryshimet në Regjistrin Tregtar.

Për çdo vit financiar shoqëria hartonte bilanc ku pasqyroheshin gjendjet e të gjitha llogarive e pasurive që dispononte shoqëria.

Përbërja e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.

1 -Mbështetja ligjore për zmadhimin e kapitalit

a) Ligji nr.7638 i datës 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare"





Ligji 7661 date 19.01.1993 "Për Kontabilitetin" dhe Planin Kontabel I
Përgjithshëm I Shqiperise

- c) Statuti I shoqerise "Perparimi" Sh.a.
- d) Vendimi I datës 25.06.2004 te Asamblese se Jashtezakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "Përparimi" Sh.a.
- e) Vendimi nr. 6657/5, date 29.12.2004 I Gjykatës se Shkallës së Parë Tiranë "Miratim eksperti kontabel".

2 - Realizimi i zmadhimit te kapitalit.

Në përputhje me Vendimin e datës 25.06.2004 të marrë nga Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të shoqërisë, zmadhimi I kapitalit konsistonte në kalimin e fitimeve të realizuara dhe të rezervave të krijuara të shoqerise deri me 31.12.2003 ne kapitalin e shoqerisë.

Për caktimin me saktësi të vlerës së zmadhimit të kapitalit që do të shtohet ne kapitalin themeltar te shoqerise nga fitimet të shoqërisë "Përparimi" Sh.a. unë vërtetova:

- a) Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit origjinal justifikues te llogaritjeve per fitimet.
- b) Saktësinë ligjore të këtij dokumentacioni dhe vërtetova se mbartja e tepriceve te llogarive të vitit paraardhës në llogaritë e vitit pasardhës është bërë me saktësi.
- c) Përputhjen e realizimit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë sipas kërkesave të përcaktuara në Vendimin e datës 25.06.2004 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë.

Puna ime analizuese, kontrolluese dhe vertetimi i kujdesshem i dokumentacionit qe u paraqit nga drejtimi I shoqerise "Perparimi" Sh.a, Shkozet, Durrës, konkludoj se u perqendrua ne:

- a) Saktesine dhe plotesine e dokumentacionit origjinal justifikues te kryerjes se shpenzimeve ne formen e blerjes dhe krijimit te aktiveve te qendrueshme te trupezuara, te aktiveve qarkulluese, si dhe te drejtave ndaj te treteve te cilat pasqyrohen ne aktivin e shoqerise.



b) Saktësinë ligjore të këtij dokumentacioni. U vërtetua se dokumentat kishin të gjitha ekstremet ligjore të duhura në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kërkesat e statutit të shoqërisë.

Në vijim të kontrollit dhe vërtetimit të kujdesshem të dokumentacionit që u paraqit, dhe nga vërtetimi fizik i bërë pranë qendres së veprimtarisë konkludoj që perberja, vlefë dhe lloji i dokumentave justifikues për secilin lloj të aktiveve reale të shoqërisë "Perparimi" sh.a. për shtimin e kapitalit të shoqërisë nga kontributet e ortakëve me burim fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara nga aktiviteti të krijuara deri më 31.12.2003 të shoqërisë "Perparimi" sh.a. Durrës paraqitet si më poshtë:

Aktivet e qëndrueshme të trupezuara deri më 31.12.2003 janë inventarizuar nga komisioni I ngritur për këtë qëllim në fund të vitit 2003 dhe vlefë e tyre është gjithsej prej 274.100.456 leke, të pasqyruara në grupet:

- Toka, troje, terrene, ndertime e inst. të përgjithshme prej 123.343.957 leke,
- Instalime teknike, makineri e pajisje prej 130.869.673 leke,
- Të tjera në shfrytëzim prej 19.886.826 leke.

Aktivet qarkulluese në fund të vitit 2003 janë në vlefë prej 574.989.548 leke përbehen si vijon:

- Gjendje të inventarit prej 104.566.230 leke ku janë përfshirë gjendja e mallrave, materialeve e lendeve të para dhe produkteve të gatshme sipas inventarit fizik më 31.12.2003,
- Gjendja e kërkesave prej 237.331.150 leke që përbejnë të drejtat e shoqërisë ndaj të tjerëve,
- Gjendja e likuiditeteve prej 233.092.168 leke që përben gjendjen e parave në fund të vitit në arke prej 222.853 leke, si dhe gjendja e parave në llogarite bankare prej 232.869.315 leke.

Nga verifikimi i dokumentacionit bazë që dispononte shoqëria rezulton se aktivet e qëndrueshme dhe aktivet qarkulluese janë krijuar nga kontributet e ortakëve në formën e financimit të shoqërisë, nga blerjet e bëra e të pa likuiduara, nga huatë e marra nga banka, si dhe nga fitimet e realizuara e rezervat e krijuara deri më 31.12.2003. Kështu që shtesa e kapitalit do të bëhet në përputhje me vendimin e asamblese së Jashtëzakonshme të shoqërisë të datës 25.06.2004 ku është përcaktuar dhe burimi I shtesës së kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri më 31.12.2003, ndërsa për burimet e tjera të krijimit të



aktivitet të shoqërisë I përket shqyrtimeve e vendimeve të asamblesë së ortakëve të shoqërisë në të ardhmen.

Fitimet dhe rezervat e krijuara gjate viteve sipas dokumentacionit.

Sipas dokumentave baze, pra te bilanceve kontabel per cdo vit ushtrimor dhe pasqyrës së humbjeve e fitimeve ajo ka realizuar deri me 31.12.2003 fitime gjithsej për një shumë prej 156.692.991 lekë, si dhe ka krijuar rezerva per nje shumë prej 189.684 leke.

Theksoj se Asambleja e Aksionerëve të shoqërisë "Përparimi" Sh.a. deri me 31.12.2003 ka vendosur të rrise kapitalin nga fitimet prej 156.692.991 lekë të pasqyruar në llogarinë e fitimeve te ushtrimit 2003 dhe nga rezervat e krijuara deri me 31.12.2003 për shumën prej 189.684 leke. Ne shtese te kapitalit do te perfshihet shuma gjithsej prej 156.862.500 leke, ndersa diferenca 20.175 leke do te mbartet si rezerva, pasi nuk ploteson vlerën e plotë të një aksioni.

Në shtesë të kapitalit do të përfshihet shuma prej 156.862.500 lekë, që ka kundërparti reale (aktive të qëndrueshme e aktive qarkulluese) në aktivin e shoqërisë "Përparimi" Sh.a. sipas dokumentacionit të shoqërisë dhe treguesve të pasqyruar ne bilancet te verifikuara, si dhe raportit te hartuar per shtese të kapitalit të shoqërisë. Treguesit e pasqyruar në bilancin e ushtrimit 2003 japin një pamje të sinqertë dhe besnike te pasurise se shoqërisë "Përparimi" Sh.a.

Vlefte prej 156.692.991 lekë, do të kalojë në kredi të llogarisë kapitali I nënshkruar. Gjithashtu në kredi të kapitalit të nënshkruar do të kaloje dhe shuma e rezervave te krijuara prej 169.509 leke dhe diferenca prej 20.175 leke (189.684 leke - 69.509 lekë) do të kalojë në mbartje të rezervave, pasi nuk plotëson vleften e nje aksioni.

Në shumën e kapitalit të nënshkruar është përfshirë dhe shuma prej 6.205.208 lekë për blerje aktivesh te qendrueshme te pa regjistruara ne gjykate, te cilat duhet të sistemohen në kontabilitet, pasi nuk janë objekt I shtesës së kapitalit sipas Vendimit te Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksoonerëve datë 25.06.2004.

Pra madhësia e shtesës së kapitalit të shoqërisë, bërë nga kontributet e aksionereve (fitime te realizuara deri me 31.12.2003 dhe rezervat e krijuara) në kapitalin e shoqërisë "Përparimi" Sh.a. do te jete shuma totale e fitimeve te realizuara dhe të rezervave të krijuara prej 156.862.500 leke.

Dokumentacioni original justifikues I kapitalit themeltar ne momentin e krijimit si dhe për shtimin e kapitalit qendron prane shoqërisë "Perparimi" Sh.a.





përfundim të aktit të ekspertimit të shtimit(zmadhimit) të kapitalit rezultoi se ky shtim (zmadhim) kapitali është bërë me përfshirje të fitimeve të realizuara dhe rezervave të krijuara nga shoqëria deri me 31.12.2003 në shumen prej 156.862.500 leke sipas shpjegimeve të mësipërme.

Duke shtuar kapitalin është rritur dhe numri I aksioneve, ndersa vlera e një aksioni egzistues nuk ka ndryshuar. Numri I aksioneve është rritur prej 4.183 me vlere secila prej 37.500 lekë.

Numri I aksioneve të rritura eshte prej 4.183 aksione.
Llogaritja është bërë sipas formulës:

Shuma e kapitalit themeltar : vlerën nominale për një aksion.

Shtesa e kapitalit themeltar të rritur = 156.862.500 lekë .
Vlera nominale e një aksioni = 37.500 lekë.

Shtesa e kapitalit prej 156.862.500 leke : 37.500 leke = 4.183 aksione.

Nga analizimi, kontrolli dhe vërtetimi I kujdesshëm që iu bë dokumentacionit, që u paraqit, si dhe verifikimit në vend të kontributeve në natyrë dhe përgatitjes së dokumentacionit sipas kërkesave të Statutit të Shoqërisë, dhe neneve 61, 63, të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe Vendimit të nr.2, datë 26.10.2004 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë "Përparimi" Sh.a. bashkangjitur këtij akti(raporti) konkludoj se vlefë e kapitalit themeltar që do të shtohet në formën e shtimit (zmadhimit) të kapitalit nga fitimet e rezervat është prej 156.862.500leke (njëqintepesëdhjetëgjashtë- m ljonetëqintëgjashtëdhjetëedymijëepesëqindlekë).

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë së bashku me shtesën e kapitalit nga kontributet (fitime + rezerva) është prej 165.862.500 lekë (njëqindëgjashtëdhjetepesëmiljonetëqintëgjashtë dhjetëedymijëepesëqintlekë) (kapitali themeltar ishte 9.000.000 lekë bëhet 165.862.500 lekë).

Tiranë më, 31.12. 2004

EKSPERTE KONTABËL E AUTORIZUAR

Eksperte Kontabël e Autorizuar

LEZE ABAZI

Leze ABAZI

Eksperte Kontabël e Autorizuar

LEZE ABAZI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES



Nr. 0171 Rep.

VERTETIMI

Në Durrës, sot më datën 21.01.2005, (Njëzet e një Janar Dymijë e pesë), para meje noter **Bastri Meçaj**, me zyrë noteriale në Rr."A.Goga", Banesa 385 për bri gjykatës në Durrës, pasi u sigurova për cilësitë dhe identitetet, e znj. Leze Tom Abazi; me banim në Tiranë, dtl. 26.01.1963, me letërnjoftimi QH Nr. 402825, me cilësi të Ekspertes Kontabël e Autorizuar për Shoqërinë "Përparimi" Sh.a. filiali Shkozë, Durrës; rezulton se janë madhorë, me zotësi të plot juridike për të vepruar, të cilët deklarojnë se janë dakort me Raportin për zmadhimin e kapitalit të Shqoërisë "Përparimi" Sh.a. të hartuar, jashtë kësaj zyre dhe nënshkruan atë me dëshirë dhe vullnetin e saj të lire. Unë noter, vërtetoj, nënshkruan e Saj sipas të drejtës që më njeh, ligji 7829 datë 01.06.94, "Për Noterinë".

N O T E R I
Bastri Meçaj

[Handwritten signature]

KĚRKUES:

“Përparimi” sh.a., person juridik i regjistruar pranë Regjistrat Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr.6657, dt.05.10.1994, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z.Mihal Delijorgji, i biri i Pandeliut, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, dl. 1966, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

OBJEKTI:

Kërkoj depozitimin në Regjistrin Tregtar pranë kësaj gjykate të Proces-Verbalit dhe të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "Përparimi" sh.a., datë 14.01.2005.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 7638, dt. 28.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligji Nr. 7667, dt. 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

Për kompetencë

Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
Seksionit Tregtar

Shoqëria "Përparimi" sh.a., është një person juridik shoqëtar I regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 6657, dt.05.10.1994.

Objekti I shoqërisë është :

- Tregtimi I mallrave dhe produkteve nga Shqipëria jashtë shtetit dhe e kundërta;
 - Tregtimi I çdo produkti, materialeve, të ndërtimit, produkteve industriale, ilaçeve dhe çdo lloj produkti që lejohet nga ana e ligjeve shqiptare;
 - Kodifikimi I çdo lënde të parë të përpunuar ose të papërpunuar për prodhimin e produkteve si p.sh. në mënyrë regulesh prodhimi I produkteve prej druri dhe alumini nëpërmjet lëndëve të para të importuara apo jo, prodhimin gëlqerës, të skeletëve metalik të gatshëm, të blloqeve të betonit dhe të çdo lloj materiali ndërtimi;
 - Ndërtimi, riparimi, apo rikonstruksioni dhe tregtimi I tuneleve, ndërtesave, apartamenteve, zyrave, dyqaneve, monumenteve si dhe ndërtesave të veçanta për përdorim shtetëror, kishtar apo turistik;
 - Kryerja e tregtisë së përgjithshme jashtë shtetit për llogari të shoqërisë dhe për llogari të të tretëve dhe përfaqësimi në Shqipëri I zyrave të vendeve të tjera, si dhe blerja dhe shitja e aksioneve të Shoqërive që funksionojnë në Shqipëri dhe jashtë saj;

Shkruar për Ymeriun
e Shqipërisë Felmont Radiop
dt 10.01.05

Inventar dt 30.12.09
 (7 fletë)
 Kompani e Bank
 rikase dt 05.01.05
 dhe e Bankës t'ne
 dt 07.12.05



Investime në prodhimin e llamarinës së valëzuar, prodhim të rrjetave të telit, prodhim të gozhdëve, prodhim të profileve të hekurit, si dhe përpunim të hekurit nëpërmjet drejtimit, prerjes dhe kryerjes së proceseve të tjera. Grumbullimi, mbledhja, shitblerja, përpunimi dhe import-eksporti i skrapit.

Më datën 14.01.2005, me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të kësaj shoqërie është vendosur:

1. Miratimi i raportit të ekspertit kontabël për zmadhimin e kapitalit me 156.862.500 lekë pra nga 9.000.000 lekë, do të bëhet 165.862.500 lekë. Në këtë mënyrë do të rritet edhe numri i aksioneve nga 240 në 4423, pra numri i aksioneve rritet me 4183 aksione, pa i ndyshuar kuotat e pjesëmarrjes së aksionerëve në kapitalin e shoqërisë të cilat janë:

- Shoqëria "Felmont Trading Limited" zotëron 51% të aksioneve ose 2.256 aksione;
- Z. Kristo Deliojrgji, zotëron 49% të aksioneve ose 2.167 aksione.

2. I gjithë dokumentacioni i paraqitur për zmadhimin e kapitalit themeltar nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri më 31.12.2003 të shoqërisë "Përparimi" sh.a., të depozitohet në Regjistrin Tregtar sipas kërkesave të Ligjit "Mbi Shoqëritë Tregtare" dhe statutit të shoqërisë.

Për sa më sipër unë Mihal Delijorgji, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë "Përparimi" sh.a., në bazë të ligjit Nr. 7638, dt.28.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit Nr. 7667, dt.28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", kërkoj që të bëhet depozitimi i Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë "Përparimi" sh.a., datë 14.01.2005, në Zyrën e Regjistratit Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Durrës më 20.01.2005

KËRKUES
SHOQËRIA "PËRPARIMI" SH.A.
PËRFAQËSUAR NGA DREJTORI

Mihal DELIJORGJI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE Durrës
Nr 0168 Rep. 044 Kol.



V Ë R T E T I M

Në Durrës sot më datën 21.01.05 (Njëzet e një Janar) (dy mijë e pesë), para meje noter Bastri Meçaj, me zyrë noteriale në Rrugën "A.Goga", banesa 385, Durrës, u paraqit personalisht Z. Mihal Delijorgji, I biri I Pandeliut, I dl. 1966, me banim në Tiranë, me Dok. Identiteti, Pasaportë Nr. 1257797, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë "Përparimi" sh.a., I cili më deklaroi përmbajtjen e kësaj **Kërkese** për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë.

Sa sipër unë noter, **Vërtetoj**, sipas ligjit 7829, datë 01.06.1994, "**Për noterinë**"

NOTER
Bastri Meçaj



POWER OF ATTORNEY

BY

FELMONT TRADING LIMITED

BY THIS POWER OF ATTORNEY given on the 24th day of June 2004

By

FELMONT TRADING LIMITED

a company incorporated and registered in the Republic of Cyprus, under registration No 79955 having its registered office at 31, Evagoras Building, 4th floor, Flat/Office 43, 1066 Nicosia, Cyprus, represented by its Board of Directors ie the sole director Ms Georgia Solonos, in the presence of its Secretary Mr Christos Patsalides (hereinafter called the "Company"), hereby appoints and authorises as special representative of the Company with full powers:

Mrs Aikaterini Dontas, daughter of Anastasios and Chrysanthi, of 24, Trapezountos ave., Stamata Attikis, Greece, holder of identity card Φ089078/28.9.2000, A.T. Ayios Stephanos, Attikis, (hereinafter the Special Representative)

to whom the Company gives the power and the right to act on behalf of and for the Company in relation with the Company's shareholding of 51% in the social capital of the company "Perparimi" S.A., an Albanian juridical person, on the following aspects:

- to present herself and represent the Company in the Extraordinary Assembly of "Perparimi" S.A which will take place on 25/6/2004 exercising the voting





right on behalf of the Company related with any matter of the agenda of such assembly signing also the respective minutes.


The Special Representative has the power and the right to sign all necessary and appropriate documents in relation to the above.


The Special Representative of the Company be and is hereby authorized to appear before any competent notary public and by virtue of proxy, grant the notarial power of attorney to any third person for the execution of part or all the above acts and to revoke the same at her sole discretion.

The Company by this authorisation since now recognises and accepts all the actions of the Special Representative, related with the above rights given to her as legal, well done, and with full legal power. The Company hereby recognizes all the actions and deeds of the Special Representative or any third person she might indicate as binding, invulnerable and valid for the Company.

IN WITNESS whereof this power of attorney has been executed this 24th day of June, year two thousand and four.

The common seal of **FELMONT TRADING LIMITED** was affixed hereto in the presence of:



 Georgia Solonos
 Sole Director



 Christos Patsalides
 Secretary

For **FELMONT TRADING LIMITED**.



Signed and sealed this day in my presence
 by Georgia Solonos
Christos Patsalides
 who is/are personally known to me. In testimony
 Whereof I have hereto set my hand and official
 seal this 24th day of June 2004
 PHILIPPOS A. YIAPATOS
 CERTIFYING OFFICER Nicosia Cyprus





**PROKURE
NGA**



FELMONT TRADING LIMITED

Prokure e leshuar me date 24 qershor 2004

Nga

FELMONT TRADING LIMITED

Nje kompani e inkorporuar dhe e regjistruar ne Republiken e Qipros, me numer regjistrimi 79955, me zyre ne adresen: 31, Evagoras Building, kati i katert, zyra nr. 43, 1066 Nikozi, Qipro, e perfaqesuar nga Bordi i Drejtoreve, me drejtor te vetem znj. Georgia Solonos, ne prani te sekretarit Christos Patsalides (kete e tutje e quajtur "Kompani"), autorizon dhe cakton si perfaqesues te posacem me te drejta te plota:

Znj. Aikaterini Dontas, e bija e Anastasios dhe Crysanthi, ne adresen 24 Trapezountos ave., Stamata Attikis, Greqi, mbajtes i kartes se identitetit Ø089078/28.9.2000, A.T. Ayios Stephanos, Attikis (ketej e tutje i quajtur perfaqesuesi i posacem)

Kompania i jep te fuqi dhe te drejta te veproje per dhe ne emer te kompanise me lidhje me aksionet prej 51% te kompanise ne kapitalin social te kompanise "Perparimi S.A.", person juridik shqiptar, ne aspektet e meposhtme;

- te prezantohet dhe te perfaqesoje kompanine te asamblene e jashtezakonshme te shoqerise "Perparimi S.A.", e cila do te zhvillohet me date 25.06.2004 duke ushtruar te drejten e votes ne emer te kompanise ne lidhje me cdo ceshtje te axhendes se kesaj asambleje duke nenshkruar procesverbalin perkates.

Perfaqesuesi i posacem ka fuqi dhe te drejta te nenshkruaje te gjitha dokumentat e duhura dhe te nevojshme ne lidhje per sa me siper.

Perfaqesuesi i posacem i kompanise te jete dhe eshte i autorizuar te paraqitet para cdo noteri publik kompetent duke u mbeshtetur ne prokure, t'i jape prokure noteriale cdo personi te trete per ekzekutimin e pjesshem ose teresor te akteve te mesiperme dhe ta revokojë sipas gjykimit te tij.



Ne momentin e ketij autorizimi, kompania njeh dhe pranon te gjitha veprimet e perfaqesuesit te posacem, ne lidhje me te drejtat e mesiperme, si te ligjshme, te sakta dhe me fuqi te plote ligjore. Kompania njeh te gjitha veprimet dhe punet e perfaqesuesit te posacem ose te personit te trete qe cakton ajo si detyruese, te pacenueshme dhe te vlefshme per kompanine.

DESHMOHET se kjo prokure u ekzekutua me date 24 qershor 2004.

Vula e zakonshme e FELMONT TRADING LIMITED u fiksua ne prani te:

Georgia Solonos

Drejtor i vetem

Firma, vula

Christos Patsalides

sekretar

firma

U firmos dhe u vulos sot ne pranine time nga Georgia Solonos dhe Christos Patsalides, te njohur personalisht prej meje. Ne pranine e deshmitareve vendosa me doren time firmen dhe vulen zyrtare.

24 qershor 2004

Nenpunesi vertetues

Philippos A. Yiapatos

Nikozi, Qipro

Firma, vula

Perktheu LOELA



3 A Calo
28.12.2004
28 DHETOR 2004

KËRKESË

KËRKUES: "Përparimi" sh.a., person juridik i regjistruar pranë Regjistrit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vndimin Nr.6657, dt.05.10.1994, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z.Mihal Delijorgji, I biri i Handelut, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, dl. 1966, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

OBJEKTI: Kërkoj depozitim të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "Përparimi" sh.a., datë 25.06.2004.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7638, dt. 28.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligji Nr. 7667, dt. 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

Për kompetencë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
Seksionit Tregtar

Shoqëria "Përparimi" sh.a., është një person juridik shqiptar i regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 6657, dt.05.10.1994.

Objekti i shoqërisë është :

- Tregtimi i mallrave dhe produkteve nga Shqipëria jashtë shtetit dhe e kundërta;
- Tregtimi i çdo produkti, materialeve të ndërtimit, produkteve industriale, ilaçeve dhe çdo lloj produkti që lejohet nga ana e ligjeve shqiptare;
- Kodifikimi i çdo lënde të parë të përpunuar ose të papërpunuar për prodhimin e produkteve si p.sh. në mënyrë treguese: prodhimi i produkteve prej druri dhe alumini nëpërmjet lëndëve të para të importuara apo jo, prodhimi i gëlqeres, të skeletëve metalik të gatshëm, të blloqeve të betonit dhe të çdo lloj materiali ndërtimi;
- Ndërtimi, riparimi, apo rikonstruksioni dhe tregtimi i tuneleve, ndërtesave, apartamenteve, zyrave, dyqaneve, monumenteve si dhe ndërtesave të veçanta për përdorim shtetëror, kishtar apo turistik;
- Kryerja e tregtisë së përgjithshme jashtë shtetit për llogari të shoqërisë dhe për llogari të të tretëve dhe përfaqësimi në Shqipëri i zyrave të vendeve të tjera, si dhe blerja dhe shitja e aksioneve të Shoqërive që funksionojnë në Shqipëri dhe jashtë saj;



- Investime në prodhimin e llamarinës së valëzuar, prodhim të rrjetave të telit, prodhim të gozhdëve, prodhim të profileve të hekurit, si dhe përpunim të hekurit nëpërmjet drejtimit, prerjes dhe kryerjes së proceseve të tjera.
- Grumbullimi, mbledhja, shitblerja, përpunimi dhe import-eksporti i skrapit.



Më datën 25.06.2004, me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionerëve të kësaj shoqërie është vendosur:

1. Të bëhet zmadhimi i kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat, sipas llogarisë së fitimeve dhe rezervave të pasqyruara në bilancet kontabël, deri në 31.12.2003, dhe të përqindjeve të pjesëmarrjes së aksionerëve në kapitalin themeltar të shoqërisë ku:

- Shoqëria "Felmont Trading Limited" zotëron 51% të aksioneve;
- Z. Kristo Deliojrgji, zotëron 49% të aksioneve.

2. Për miratimin e Znj. Leze Abazi si eksperte kontabël, me Liçencë me Nr. 24., dt. 11.02.2000, për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për shtesën e kapitalit të shoqërisë nga fitimet e realizuara dhe nga rezervat e krijuara deri në dt. 31.12.2003,.

Për sa më sipër unë Mihal Delijorgji, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë "Përparimi" sh.a., në bazë të ligjit Nr. 7638, dt. 28.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit Nr. 7667, dt. 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", kërkoj që të bëhet depozitimi i Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë "Përparimi" sh.a., datë 25.06.2004, në Zyrën e regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Durrës më 26.11.2004

**KËRKUES
SHOQËRIA "PËRPARIMI" SH.A.
PËRFAQËSUAR NGA DREJTORI**

Mihal DELIJORGJI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE Durrës
Nr 2615 Rep. 6.23 Kol.**





V Ë R T E T I M

Në Durrës sot më datën 13. dhjetor. 2004 (dy mijë e katër),
para meje noter Batri Meçaj, me zyrë noteriale në Rrugën "A.Goga", banesa 385, Durrës,
u paraqit personalisht Z. Mihal Delijorgji, I biri I Pandeliut, I dl. 1966, me banim në
Tiranë, me Dok. Identiteti, Pasaportë Nr. 1257797, me zotësi të plotë juridike dhe për të
vepruar, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë "Përparimi"sh.a., I cili më
deklaroi përmbajtjen e kësaj **Kërkese** për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, të hartuar
jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë.

Sa sipër unë noteri, **Vërtetoj**, sipas ligjit 7829, datë 01.06.1994, "**Për noterinë**"



NOTER
Batri Meçaj

SHOQËRIA "PËRPARIMI" SH.A.
SHOZET – DURRËS

V E N D I M

I ASAMBLESE SË JASHTËZAKONSHME TË AKSIONERËVE

SHOQËRISË "PËRPARIMI" SH.A.

Sot më datën 25.06.2004, në selinë e shoqërisë "Përparimi"sh.a., në Shozet, Durrës, u mbledh Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të Shoqërisë, në të cilën ishin të pranishëm.

-Shoqëria "**Felmont Trading Limited**", e cila zotëron 51% të aksioneve të shoqërisë, e përfaqësuar me autorizim të posaçëm nga Znj.Alkaterini Dontas.

- **Z. Kristo Delijorgji**, I cili zotëron 49 % të aksioneve, I pranishëm drejtpërsëdrejti.

- **Znj. Leze Abazi**, eksperte kontabël, pa të drejtë vote.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të Shoqërisë "Përparimi"sh.a. e mbledhur sot më datën 25.06.2004, në selinë e shoqërisë, në Shkozet Durrës, pasi mori në shqyrtim rendin e ditës të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **Z. Mihal Delijorgji**, si më poshtë:

1.Të bëhet zmadhiimi I kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri në 31.12.2003.

2.Miratimi I znj. Leze Abazi si eksperte kontabël, me licencë me Nr.24, dt.11.02.2000, për përgatitjen e dokumentacionit ligjor dhe të raportit të auditimit në lidhje me shtesën e kapitalit të shoqërisë, nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri në 31.12.2003.

K O N S T A T O I S E :

Shoqëria "Përparimi"sh.a., është një person juridik shqiptar, I regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare, me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 6657, dt.05.10.1994.

Në diskutimet e bëra ortakët e shoqërisë u shprehën për miratimin e zmadhimit të kapitalit nga fitimet e realizuara deri në 31.12.2003, në përputhje me dokumentacionin bazë si: bilanceve kontabël, pasqyrave financiare dhe raportit të auditimit të ekspertit kontabël.

Për sa më lasrt në mbështetje të Statutit të Shoqërisë dhe nenit 150,152,215 të Lgjit Nr. 7638, dt 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare", Asambleja e Jashtëzakonshme e shoqërisë





VENDOSI

1. Të bëhet zmadhimi i kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri në 31.12.2003, sipas llogarisë së fitimeve dhe rezervave të pasqyruara në bilancet kontabël si dhe të përqindjeve të pjesëmarrjes së aksionerëve në kapitalin themeltar të shoqërisë ku:

- Shoqëria **"Felmont Trading Limited"**, zotëron 51 % të aksioneve të kapitalit të shoqërisë.
- Z. **Kristo Delijorgji**, zotëron 49 % të aksioneve të kapitalit të shoqërisë.

2. Miratimin e znj. **Leze Abazi** si eksperte kontabël, me Liçencë me Nr. 24, dt. 11.02.2000, për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për shtesën e kapitalit të shoqërisë nga fitimet e realizuara dhe rezervat deri në 31.12.2003.

Këto vendime u miratuan unanimisht nga ortakët.

AKSIONERËT THEMELUES

AKATERINI DONTA

Për: **"Felmont Trading Limited"**

FELMONT TRADING LTD
NICOSIA CYPRUS

Kristo DELIJORGJI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE DURRES
Nr. 2614 Rep. 622 Kol.

VËRTETIM

Në Durrës sot më datën 13. Dhjetor. 2004 (dymijë e katër), para meje Noter Bastri Meçaj, me zyrë noteriale në Rrugën "A. Goga", banesa Nr.385, Durrës, u paraqitën personalisht Z.Kristo Delijorgji, I biri I Pandeliut, lindur më 1972, me banim në Lagjen 1 Durrës, me Dok. Identiteti, Pasaportë Nr.1020249, dhe shoqëria



“Felmont Trading Limited, shoqëri e huaj e krijuar sipas legjislacionit të Republikës së Qipros, regjistruar me vendimin Nr. 79955 , datë 28.06.1996, e cila përfaqësohet nga Znj. Alkaterini Donta, e ija e Anastasiut, me banim në Athinë, Rr. Trapezudos 24, me Dok. Identiteti, Pasaportë, me Nr. 799192, lindur më 1950, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij **Vendimi të Asamblesëtë** hartuare jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

Sa sipër unë noteri **Vërtetoj**, sipas ligjit 7829 datë 01.06.1994, “**Për Noterinë**”



NOTERI
Bastri Meçaj

FELMONT TRADING LIMITED
("Shoqeria")

Nr. Rregj. 79955

**Proces-verbal i Mbledhjes se Keshillit Drejtues mbajtur ne Nicosia,
Qipro me 25 Janar 2000, ne oren 11.00.**

Te Pranishem: STELLA APSEROU dhe KOULLA MESARITOU,
Drejtores C.S.M. SECRETARIAL LIMITED, Sekretarja



Qellimi i Mbledhjes:

Qellimi i kesaj mbledhje ishte:

- a) per te shqyrtuar dhe vendosur per blerjen e 51% te kapitalit aksioner te Shoqerise PERPARIMI Sh.a., me zyre te rregjistruar ne Tirane, Shqiperi;
- b) per te autorizuar nje person per lidhjen e marreveshjes se blerjes se aksioneve ne emer te Shoqerise.

BLERJA E AKSIONEVE

- a) shoqeria vendos te bleje 51% te kapitalit aksioner te Shoqerise PERPARIMI Sh.a.;
- b) personi me kompetencen per te nenshkruar transferimin e 51% te aksioneve tek Shoqeria do te jete Ms. AIKATERINI DONTA ("nenshkruesja e autorizuar") ose ndonje person tjeter qe mund te caktoj nenshkruesja e autorizuar me vendim te vetem te saj;
- c) cdo nenshkrues i autorizuar me ane te ketij vendimi autorizohet te ekzekutoje cdo dokument sic mund te kerkohet per te vazhduar transaksionin e blerjes se aksioneve ne emer te Shoqerise; dhe
- d) cdo nenshkrues i autorizuar me ane te ketij vendimi autorizohet te paraqitet ne Dhomen e Tregtise, ne cdo Autoritet Tatimor ose Administrativ, ne Noteri dhe gjithashtu ne cdo Autoritet tjeter

kompetent sic mund te kerkohet here pas here per plotesimin e transaksionit te mesiperm te blerjes se aksioneve.

(Firmat)

Drejtore

(Firma dhe vula)

Sekretare

Nenshkruar dhe vulosur sot ne prezencen time nga S. Apserou, K. Mesaritou dhe G. Michaelidis njohur personalisht nga une. Ne deshmi te sa me siper une nenshkruaj dhe vulos zyrtarisht sot me 8 Shkurt 2000.



PHILIPPOS A. YIAPATOS
Noter Nicosia, Qipro


(Firma, vula, pulla)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr...1269...Rep

Tirane, me...14-03-2000

VERTETIM

Vertetoj firmen e perkthyeses Gerta Skenderi, banuese ne Tiarane, e njohur prej meje personalisht, e cila perktheu njelloj me origjinalin nga anglishtja ne shqip dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.



NOTERE

